



Manual

për Vëzhgimin e Teknologjive
të Reja të Votimit

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)
Prezenca në Shqipëri
Sheraton Hotel
Kati i I-rë, Sheshi “Italia”
1010 Tiranë, Shqipëri
www.osce.org/albania

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2017

Ky botim është përkthim në shqip i *“Handbook for the Observation of New Voting Technologies”*, i botuar në origjinal në anglisht në vitin 2014 nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR). Ky manual është përkthyer dhe botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe kopjohet lirisht për mësimdhënie dhe qëllime të tjera jotregtare, me kusht që një riprodhim i tillë të shoqërohet me citimin e OSBE/ODIHR-it dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri si burime.

ISBN 978-9928-4472-0-3

Dizajni nga Nona Reuter

Fotografia e kopertinës nga Agnieszka Rembowska. *Një zgjedhës që hedh fletën e tij të votimit në një pajisje skanimi të fletëve të votimit, qyteti Erdenet, zgjedhjet presidenciale të 26 qershorit 2013 në Mongoli.*

Shtypur në Shqipëri nga: Graphic Line-01

Përmbajtja

Hyrje	1
Si ta Përdorim Këtë Manual	2
1 Informacion Shpjegues mbi Vëzhgimin e Teknologjive të Reja të Votimit	4
1.1 Vështrim i Përgjithshëm	4
1.2 Përparësitë dhe Sfidat që Paraqesin TRV-të	5
1.3 Llojet e TRV-ve	5
1.4 Angazhimet e OSBE-së dhe Praktikat e Mira Ndërkombëtare	8
1.5 Parimet Kyçe të Vëzhgimit të Përdorimit të TRV-ve në një Proces Zgjedhor	9
1.5.1 Fshehtësia e Votës	9
1.5.2 Integriteti i Rezultateve	10
1.5.3 Barazia e Votës	10
1.5.4 Universaliteti i Votës	11
1.5.5 Transparenca	11
1.5.6 Llogaridhënia	12
1.5.7 Besimi i Publikut	12
2 Roli i Analistëve të MVZ-ve në Vëzhgimin e TRV-ve	14
2.1 Roli i MVN-së	15
2.2 Detyrat Specifike të MVZ-së	15
2.3 Roli i Analistëve të Ndryshëm të MVZ-së	16
2.3.1 Analisti i TRV-ve	17
2.3.2 Analisti Ligjor	17
2.3.3 Analisti për Zgjedhjet	17
2.3.4 Analisti Politik	18
2.3.5 Analisti i Medias	18
2.3.6 Koordinatori i VAGJ-ve	18
2.4 Kodi i Sjelljes së Vëzhguesve Zgjedhorë të OSBE/ODIHR-it	18
3 Analizimi i Kontekstit për Teknologjitë e Reja të Votimit: Vëzhgimi nga Ekipi Bazë i MVZ-së	19
3.1 Vendimmarrja Nëse dhe Si do të Përdoret TRV-ja	19
3.2 Konteksti Ligjor	22
3.3 TRV-ja dhe Sistemi Zgjedhor	26
3.4 Partitë Politike, Shoqëria Civile dhe Media	27

4	Vlerësimi i Teknologjive të Reja të Votimit:	
	Puna e Analistit të TRV-së	29
4.1	Prokurimi dhe Blerja e TRV-së	29
4.2	Roli i Administratës Zgjedhore në Përdorimin e TRV-së	31
4.2.1	Ristrukturimi i Procesit të Votimit	31
4.2.2	Kanale të Shumëfishta Votimi: Integrimi i Proceseve të Votimit Elektronik dhe me Letër	32
4.2.3	Mbikëqyrja	32
4.2.4	Administrimi i Rrezikut	33
4.2.5	Roli i Ofruesve të Teknologjisë	33
4.2.6	Trajnimi i Komisionerëve Zgjedhorë	34
4.2.7	Edukimi i Zgjedhësve	34
4.3	Siguria dhe Fshehtësia e Votës dhe Integriteti i Rezultateve	36
4.4	Lehtësia në Përdorim, Dizajni i Fletës së Votimit, Qasja e Zgjedhësit dhe Besueshmëria	39
4.4.1	Lehtësia në Përdorim	40
4.4.2	Dizajni i Fletës së Votimit	41
4.4.3	Qasja nga Zgjedhësi	41
4.4.4	Besueshmëria	42
4.5	Testimi Publik	43
4.6	Vlerësimi dhe Certifikimi	45
4.7	Metodat e Verifikimit	47
4.7.1	Auditimet	48
4.7.2	Gjurmë Kontrolli e Votës në Letër e Verifikuar nga Zgjedhësi dhe Fletët e Votimit të Skanuara	48
4.7.3	Verifikimi dhe Votimi me Anë të Internetit	50
4.8	Qasja e Vëzhguesve, Dokumentacioni dhe Masa të Tjera për Transparencën	51
5	Këndvështrimi Rajonal: Roli i Vëzhguesve Afatgjatë dhe i Analistëve Rajonalë	54
6	Roli i Vëzhguesve Afatshkurtër	57
7	Raportimi: Përgatitja e Vlerësimeve dhe Rekomandimeve	62
8	Ndjekja në Vazhdim	65
	Shtojcat	69
	Shtojca A: Terma të Dobishëm	70
	Shtojca B: Listë Kontrolli e Përgjithshme	72
	Shtojca C: Kodi i Sjelljes së Vëzhguesve Zgjedhorë të OSBE/ODIHR-it	74
	Shtojca D: Përzgjedhje të Angazhimeve të OSBE-së, Dokumenteve të Praktikave të Mira, dhe Rasteve Gjyqësore Përkatëse	75

Hyrje

Rreth Manualit për Vëzhgimin e Teknologjive të Reja të Votimit

Përdorimi i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në zgjedhje është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të fundit. Sot, pothuajse të gjitha proceset zgjedhore përdorin, në një mënyrë apo në një tjetër, teknologjitë e reja (që nga regjistrimi i zgjedhësve deri tek plotësimi i tabelave të rezultateve). Teknologjitë e reja janë përdorur gjithashtu për votimin dhe numërimin e votave në disa vende, çka ka ngritur pyetje në lidhje me shkallën e përputhshmërisë së këtyre teknologjive me angazhimet e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, si dhe me praktika të tjera të mira ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë përdorur apo testuar teknologji të reja të votimit (TRV) në zgjedhje, përfshirë aparate për votim elektronik, skanues të fletëve të votimit, votim nëpërmjet internetit apo mjete të tjera elektronike. Disa prej këtyre shteteve vazhdojnë t'i përdorin TRV-të, ndërsa disa të tjerë nuk i përdorin më dhe u janë rikthyer metodave zgjedhore që bazohen në letër. Duke pasur parasysh diskutimet e shumta që zhvillohen aktualisht në lidhje me përparësitë e mundshme, por edhe me sfidat që paraqet përdorimi i TRV-ve në zgjedhje, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) i ka kushtuar më shumë vëmendje kësaj çështjeje në kontekstin e mandatit të saj për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Ndërkohë, përdorimi i TRV-ve paraqet sfida për vëzhgimin e zgjedhjeve. Shpesh përdorimi i TRV-ve e bën të vështirë vëzhgimin e drejtpërdrejtë fizik të disa procedurave të rëndësishme. Një vështirësi tjetër lidhet me faktin se vëzhguesi tipik e ka të vështirë t'i kuptojë mirë TRV-të. Për rrjedhojë, duhet që metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve të ketë më shumë parasysh zhvillimet teknologjike në fushën e zgjedhjeve.

Ky manual synon t'u japë të gjitha Misionet të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të ODIHR-it disa udhëzime kryesore se si të vëzhgojnë përdorimin e TRV-ve në proceset zgjedhore.¹ Manuali është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të ODIHR-it për të përmirësuar metodologjinë e tij dhe për të rritur profesionalizmin në vëzhgimin e

¹ Në të gjithë tekstin, nëse nuk përkrahë ndryshe, termi "MVZ" përfshin edhe lloje të tjera të formateve të misionet të ODIHR-it për zgjedhjet, përfshirë Misionet e Kufizuara të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Misionet e Vlerësimit të Zgjedhjeve dhe Ekipet e Ekspertëve për Zgjedhjet.

disa aspekteve më specifike të zgjedhjeve. Manuali përmban udhëzime praktike mbi mënyrën se si MVZ-të mund ta përfshijnë vëzhgimin e TRV-ve në punën e tyre. Ai plotëson Manualin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (botimin e gjashtë), si dhe botime të tjera të ODIHR-it, dhe për rrjedhojë duhet të lexohet së bashku me to.²

Shumë prej çështjeve që kanë të bëjnë me TRV-të shpesh kërkojnë ekspertizë të posaçme teknike dhe duhet të jenë përgjegjësi parësore e Analistit të TRV-së në një MVZ. Gjithsesi, çështjet që kanë të bëjnë me TRV-të janë të lidhura ngushtë edhe me aspektet ligjore, politike dhe administrative të procesit zgjedhor. Ndaj, për të nxjerrë përfundime të sakta kërkohet ndërgjegjësim dhe kontribut nga të gjithë anëtarët e MVZ-së. Vëzhgimi i përdorimit të TRV-ve në një proces zgjedhor është, pra, përgjegjësi e Analistit të TRV-së, në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të MVZ-së, përfshirë ekipin bazë, vëzhguesit afatgjatë (VAGJ) dhe ata afatshkurtër (VASH).

Si ta Përdorim Këtë Manual

Ky manual është hartuar për t'u përdorur si një mjet pune. Ai duhet të ndihmojë çdo MVZ të identifikojë dhe të vlerësojë ato elementë të TRV-ve që mund të ndikojnë në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Struktura e manualit i mundëson anëtarët e MVZ-ve ta drejtojnë vëmendjen shpejt tek materialet që kanë rëndësi më të madhe për fushën e tyre të përgjegjësisë.


- Kapitulli i parë bën një prezantim të përgjithshëm dhe historik të TRV-ve dhe jep një informacion paraprak mbi teknologjitë që përdoren më shpesh për të votuar, numëruar dhe përlogaritur rezultatet.
- Kapitulli i dytë flet mbi rolin e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve në vëzhgimin e TRV-ve dhe rolet e analistëve të ndryshëm të Misionit. Ai përshkruan gjithashtu aspekte të rëndësishme, si objekti i punës së një Misioni për Vlerësimin e Nevojave në këtë fushë dhe Kodi i Sjelljes.
- Kapitulli i tretë shqyrton kontekstin në të cilin përdoren TRV-të dhe identifikon çështje që duhet të merren parasysh dhe të analizohen nga analistë të ndryshëm të ekipit bazë të MVZ-së në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Çështje të tilla janë, p.sh., vendimmarrja për përdorimin e TRV-ve, kuadri ligjor, ndikimi që mund të kenë TRV-të në sistemin zgjedhor në përgjithësi, dhe diskutimi publik nga partitë politike, shoqëria civile dhe media rreth përdorimit të TRV-ve.
- Kapitulli i katërt trajton rolin e Analistit të TRV-ve në një MVZ, si dhe elementet që duhet të vëzhgohen, të analizohen sistematikisht dhe të vlerësohen.
- Kapitulli i pestë dhe i gjashtë evidentojnë ato aspekte të TRV-ve që VAGJ-të dhe VASH-të kanë mundësi të vëzhgojnë, duke kontribuar kështu në mbledhjen nga MVZ-ja të informacionit për zbatimin e TRV-ve në nivel qarku dhe qendre votimi.
- Kapitulli i shtatë trajton raportimin e MVZ-së dhe disa faktorë që misionet duhet t'i kenë parasysh kur bëjnë vlerësime, nxjerrin përfundime dhe japin rekomandime mbi përdorimin e TRV-ve në zgjedhje.

2 Shih edhe: <<http://www.osce.org/odihr/elections/75352>>. Në vitin 2008, ODIHR-i nxori një material diskutimi mbi temën e TRV-ve (shih <<http://www.osce.org/odihr/elections/34725>>). Ky manual trajton çështjet e ngritura në këtë material diskutimi dhe e zëvendëson atë.

- Kapitulli i fundit paraqet mënyrat se si ODIHR-i mund t'i mbështesë shtetet pjesëmarrëse që të zbatojnë rekomandimet mbi përdorimin e TRV-ve.
- Shtojcat ofrojnë një fjalorth të terminologji të dobishme, një listë kontrolli, Kodin e Sjelljes së Vëzhguesve të ODIHR-it, tekstin e angazhimeve kryesore të OSBE-së, si dhe sjell referenca mbi disa praktika të mira ndërkombëtare, përfshirë disa çështje të përzgjedhura gjyqësore që kanë të bëjnë me përdorimin e TRV-ve në zgjedhje.

Manuali përmban disa lista kontrolli për t'i ndihmuar vëzhguesit e niveleve të ndryshme që të nisin sa më shpejt shqyrtimin e çështjeve për t'u ndjekur mbi përdorimin e TRV-ve. Ato shërbejnë edhe si një listë kujtese për çështjet që duhet të ketë parasysh çdo anëtar i ekipit gjatë kohëzgjatjes së misionit. Larmia e praktikave të TRV-ve, siç diskutohet në kapitullin në vijim, nënkupton që jo çdo çështje duhet shqyrtuar domosdoshmërisht nga çdo MVZ.

Duke qenë se zgjedhjet janë unike, jo të gjitha çështjet e shqyrtuara në këtë manual janë të rëndësishme për t'u shqyrtuar në çdo rast përdorimi të TRV-ve. TRV-të mund të përdoren gjerësisht në disa zgjedhje, ose mund të testohen në mënyrë të kufizuar në zgjedhje. Po ashtu, MVZ të ndryshme mund ta vënë theksin më shumë ose më pak tek çështjet që kanë lidhje me TRV-të, në varësi të numrit të anëtarëve, të kohëzgjatjes së misionit dhe të burimeve. Brenda mundësive dhe sa herë është e nevojshme, MVZ-të duhet t'i marrin në shqyrtim TRV-të dhe, sipas rastit, të trajtojnë gjetjet ose problemet në raportet dhe rekomandimet e tyre.



Vëzhgues që diskutojnë me zyrtarë në Norvegji rreth proceseve të votimit nëpërmjet internetit dhe mënyrën e monitorimit të tyre, 2013.

1

Informacion Shpjegues mbi Vëzhgimin e Teknologjive të Reja të Votimit

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Në këtë manual, “teknologjitë e reja të votimit” (TRV) përkufizohen si përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) për hedhjen dhe numërimin e votave. Kjo përfshin përdorimin e sistemeve elektronike të votimit, skanuesve të fletëve të votimit dhe votimin nëpërmjet internetit. Në këtë manual përdoret gjithashtu termi “votim elektronik”. Përveç rasteve kur shënohet ndryshe, ky term duhet të shihet si sinonim i “teknologjive të reja të votimit”.

Ka raste kur analiza e TRV-ve kërkon që të merren në shqyrtim edhe teknologjitë mbështetëse si, p.sh., sistemet elektronike të administrimit të zgjedhjeve dhe teknologji të tjera të reja që mund të përdoren në proceset zgjedhore si, sistemet e regjistrimit të zgjedhësve apo identifikimi (biometrik) i zgjedhësve. Megjithatë, analiza e këtyre sistemeve nuk trajtohet në këtë manual.

1.2 Përparësitë dhe Sfidat që Paraqesin TRV-të

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë dhënë arsye të ndryshme për të shpjeguar futjen e TRV-ve në proceset e tyre zgjedhore. Një nga përparësitë e përmendura të TRV-ve është se ato kanë mundësi të rrisin pjesëmarrjen në votim, të lehtësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve që jetojnë jashtë vendit, të ulin kostot e administrimit të zgjedhjeve, të lehtësojnë zhvillimin e disa zgjedhjeve njëkohësisht, të ulin numrin e gabimeve njerëzore (p.sh. numrin e fletëve të votimit të pavlefshme), të rrisin saktësinë e numërimit, dhe të përshpejtojnë nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve. TRV-të mund, gjithashtu, të përmirësojnë mundësitë e pjesëmarrjes në zgjedhje të zgjedhësve me aftësi të kufizuara dhe të atyre që flasin gjuhën e një pakice.

Në të njëjtën kohë, TRV-të paraqesin një numër sfidash të mundshme. Njëra prej tyre është nevoja për të ruajtur fshehtësinë e votës dhe, në të njëjtën kohë, për të siguruar integritetin e rezultateve. Deri më tani ka qenë e vështirë që votimi elektronik, sidomos votimi nëpërmjet internetit, t'i respektojë të dyja këto parime themelore demokratike në të njëjtën kohë. Një sfidë tjetër është se TRV-të sjellin ndërlikime të reja në procesin zgjedhor si, p.sh.,nevoja për të ndryshuar legjislacionin, për të planifikuar se si do të blihet, testohet, vlerësohet, certifikohet dhe sigurohet TRV-ja, nevoja për të edukuar zgjedhësit dhe për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, si dhe shqetësime të tjera të përgjithshme lidhur me transparencën e procesit dhe mundësitë e vëzhgimit. Pra, përdorimi i TRV-ve nuk krijon domosdoshmërisht besim. Përkundrazi, duket se kërkohet besim ekzistues në mirëadministrimin e zgjedhjeve si kusht për përdorimin e suksesshëm të TRV-ve. Nëse këto sfida nuk trajtohen në mënyrë të plotë, atëherë besimi i publikut të procesi zgjedhor ka gjasa të dobësohet.

1.3 Llojet e TRV-ve

Sikurse edhe me votimin tradicional me fletë votimi, TRV-të mund të përdoren në mjedise të kontrolluara siç janë qendrat e votimit, apo për të votuar në distancë nga mjedise të pakontrolluara si, p.sh., votimi nga kompjuteri në shtëpi apo nga telefoni celular. Ndonëse ka shumë lloje pajisjesh në përdorim, TRV-të që përdoren aktualisht në hapësirën e OSBE-së mund të ndahen në katër kategori kryesore:

1. Teknologjia e skanimit të fletës së votimit nënkupton përdorimin e fletës së votimit (letër) që plotësohet me dorë nga zgjedhësi ose të cilën zgjedhësi e plotëson me ndihmën e një pajisjeje, e cila shënon fletën e votimit dhe gjendet tek qendra e votimit. Më pas, fleta e votimit futet tek pajisja, e cila e skanon dhe e numëron elektronikisht duke "lexuar" votën e zgjedhësit në fletën e votimit. Këto pajisje mund të vendosen në

qendrat e votimit si dhe në ato të numërimit të votave, të cilat konsiderohen si mjedise të kontrolluara.³

2. Sisteme votimi elektronike me regjistrim të drejtpërdrejtë (DRE) regjistrojnë zgjedhjen e votuesit në qendrën e votimit, zakonisht nëpërmjet pajisjeve me ekran me prekje apo me butona, dhe i numërojnë votat elektronikisht. Ashtu si skanerat e fletëve të votimit, edhe sistemet DRE vendosen zakonisht në mjedise të kontrolluara.

3. Votimi nëpërmjet internetit i mundëson zgjedhësit të votojë kudo ku ndodhet, në një mjedis të pakontrolluar. Votat mbledhen dhe ruhen në mënyrë elektronike në një vend të centralizuar. Aktualisht, interneti është kanali i votimit më i përdorur nga sistemet e votimit elektronik nga larg.

4. Format hibride të TRV-ve ndërthurin mjedisin e kontrolluar të qendrës së votimit me regjistrimin dhe numërimin e centralizuar të votimit përmes internetit. Në këto sisteme, zgjedhësit votojnë në një kompjuter që ndodhet në qendrën e votimit. Votat transmetohen elektronikisht tek një server qendror.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të teknologjive të votimit që përdoren aktualisht në hapësirën e OSBE-së, sipas mjedisit ku hidhet vota dhe mjetit të përdorur për ta hedhur atë. Ajo ndihmon për të kuptuar më mirë veçoritë e teknologjive të reja të votimit dhe lidhjen e tyre me ato tradicionale.

Mjeti	Përdorimi në Mjedis të Kontrolluar	Përdorimi në Mjedis të Pakontrolluar	Përdorimi në Mjedis të Përzier
Votimi me fletë votimi letër	Votimi me fletë votimi letër në qendra votimi	Votimi me postë	Votimi me kuti votimi të lëvizshme
Votimi me TRV	Sisteme votimi elektronike me regjistrim të drejtpërdrejtë (DRE)	Votimi nëpërmjet internetit	TRV hibride:: Sisteme DRE që përdorin teknologjinë e votimit me anë të internetit
Fletë votimi letër dhe numërim elektronik	Skaner i fletëve të votimit		Numërim i centralizuar i votave të dërguara me postë duke përdorur skaner të fletëve të votimit

Tabela 1: Format e Votimit në Hapësirën e OSBE-së

Një element i rëndësishëm për çdo TRV është që ajo të ofrojë mundësi verifikimi të shumës së votave, duke ruajtur në të njëjtën kohë fshehtësinë e votës së çdo zgjedhësi.

3 Në disa raste, teknologjia e skanimit të fletës së votimit përdoret edhe për të numëruar fletë votimi të postuara, që janë shënuar në shtëpi dhe u janë dërguar me postë autoriteteve.

Praktika standarde e rinumërimit manual të një sasive votash të përzgjedhura rastësisht, mund të jetë një mënyrë e efektshme verifikimi. Megjithatë, rinumërimi manual nënkupton që sistemi përdor fletë votimi letër. Kjo është e mundur vetëm për TRV-të e instaluar në mjedise të kontrolluara.

Teknologjia e skanimit të fletës së votimit ofron mundësinë e rinumërimit manual. Aftësia e këtyre pajisjeve për të skanuar zgjedhjen e votuesit varet nga shënimi i duhur i fletës së votimit dhe nga marzhi i gabimit të pajisjes, si dhe mbështetet te përkufizimi ligjor i një flete votimi të vlefshme.

Disa sisteme DRE përfshijnë dhe një kopje të votës në letër. Kjo kopje, e cila ruhet nga sistemi, i lejon zgjedhësit të verifikojnë votën në letër, në mënyrë ideale para se të hidhet vota. Ky variant quhet “gjurmë kontrolli e votës në letër që verifikohet nga zgjedhësi” (VVPAT). Sistemet DRE me VVPAT ofrojnë mundësinë e rinumërimit manual. Teknologjitë DRE, që ruajnë një variant në letër që nuk verifikohet nga zgjedhësi, mundet gjithashtu të ofrojnë mundësinë për rinumërim manual, por ky rinumërim do të tregonte vetëm atë që vetë sistemi ka regjistruar, çka mund të mos pasqyrojë domosdoshmërisht përzgjedhjen e votuesit.

Pajisje të tjera DRE i regjistrojnë votat vetëm elektronikisht dhe nuk ofrojnë mundësinë e rinumërimit manual. Këto sisteme, që nuk përdorin letër, mbështeten në memorie elektronike për të regjistruar votat e hedhura, në një pajisje *hardware* më vete, si për shembull në një hard disk apo kartë memorie, dhe shumë prej tyre mbajnë një regjistër të veprimeve të njohur si “*audit log*”. Inspektimi i këtyre të dhënave mund të hedhë dritë nëse lindin probleme, por kërkon ndërhyrjen e një eksperti dhe mund të mos jetë i suksesshëm në rastet e mosfunksionimit të pajisjes *hardware*.

Votimi me anë të internetit, për shkak të natyrës së tij, nuk mundëson rinumërimin manual të votave. Sistemet e votimit me anë të internetit, për rrjedhojë, mbështeten te masat e sigurisë kompjuterike, certifikimi dhe, në fund të fundit kërkojnë një shkallë besimi te programuesit dhe operatorët e sistemit. Disa teknologji të votimit me anë të internetit tentojnë t’u krijojnë mundësinë zgjedhësve të verifikojnë faktin që votat e tyre janë regjistruar siç i kanë hedhur. Sistemet hibride mund të ofrojnë mundësinë e një rinumërimi manual në rast se përmbajnë VVPAT. Në të kundërt, këto sisteme mbështeten tek të njëjtat mekanizma garantues të integritetit të rezultateve si dhe sistemet e votimit me anë të internetit.

Aktualisht, po testohen metoda të reja elektronike që përdorin kriptografinë⁴ dhe që synojnë të ofrojnë verifikueshmërinë ‘nga fillimi në fund’.⁵ Këto sisteme nuk përmbajnë gjurmë në letër dhe synohet të përdoren kryesisht në votimin nga mjedise të

4 Kriptografia është teknikë për ruajtjen e sigurisë së të dhënave të komunikimit nga palët e treta.

5 Verifikueshmëria sipas parimit ‘nga fillimi në fund’ është një funksionalitet i sistemeve TRV që mundëson përcaktimin e vlefshmërisë së rezultateve në mënyrë tërësore dhe/ose individuale. Sistemet me verifikueshmëri universale ofrojnë njete që e mundësojnë një palë të tretë të pavarur të përcaktojë, nëpërmjet kontrolleve manuale ose matematikore, që rezultati i zgjedhjeve është raportuar në mënyrë të ndershme dhe pa manipulime. Në nivel individual, zgjedhësve u jepet mundësia të verifikojnë që vota e tyre është hedhur siç ata synonin, që është ruajtur siç është hedhur, dhe (idealisht) numëruar siç është regjistruar.

pakontrolluara si, për shembull, nëpërmjet internetit. Disa prej tyre, si kontrolli nëpërmjet telefonit celular, do t'i lejonte individët të verifikonin votën e tyre nëpërmjet një kanali tjetër elektronik, ndonëse nuk është verifikim universal. Ashtu si për të gjitha sistemet TRV, edhe këto duhet t'i nënshtrohen një kuadri ligjor cilësor dhe duhet të zhvillohen brenda një mjedisi të duhur organizativ, i cili siguron integritetin e votimit elektronik.

Së fundi, është e rëndësishme të vihet në dukje se, prirja aktuale e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së që kanë futur zbatimin e TRV-ve, është përdorimi i votimit elektronik të shoqëruar me forma të caktuara të gjurmëve në letër të votës.⁶ Në disa raste, votimi elektronik ofrohet si një mënyrë alternative votimi për të gjithë apo për disa zgjedhës. Në raste të tjera, TRV-të përdoren ekskluzivisht në zona të caktuara gjeografike, në mënyrë tipike për qytetarët jashtë vendit, ndërsa fletët e votimit përdoren në disa zona të tjera.

1.4 Angazhimet e OSBE-së dhe Praktikave e Mira Ndërkombëtare

Sistemet e votimit TRV përmbushin të njëjtat funksione si sistemet që bazohen në letër ose ato mekanike. Për rrjedhojë, duhet të përmbushin të njëjtat standarde të cilave i nënshtrohen këto sisteme. Angazhimet e OSBE-së përkufizojnë parimet për zgjedhje demokratike, pavarësisht nga teknologjia e përdorur. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë rënë dakord për këto parime në Dokumentin e Kopenhagenit të vitit 1990 dhe në dokumentet vijuese të OSBE-së.⁷ Në veçanti, procesi i votimit siguron ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë universale, të drejtpërdrejtë, të barabartë dhe të fshehtë, gjatë hedhjes, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit në mënyrë të ndershme, transparente dhe llogaridhënëse.

Deri më sot nuk është hartuar asnjë dokument i veçantë për TRV-të nga ana e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Megjithatë, gjatë dekadës së fundit ka pasur përpjekje të bashkërenduara brenda Këshillit të Evropës për të formuluar standarde për TRV-të.⁸ Në vitin 2004, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës nxori Rekomandimin për Standardet Ligjore, Operacionale dhe Teknike për Votimin Elektronik, i cili përbën të vetmin dokument të specializuar ligjor në rrafsh ndërkombëtar në këtë drejtim.⁹ Ky rekomandim erdhi në vijim të një raporti nga Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias) për përputhshmërinë e votimit në distancë dhe votimit elektronik me kërkesat e dokumenteve të Këshillit të Evropës.¹⁰ Në vitin 2011 u miratuan dokumente më të hollësishme në lidhje me transparencën dhe

6 Duke përdorur ose VVPAT-në ose skanerat për fletët e votimit.

7 Për një listë të plotë, shih: OSCE Human Dimension Commitments, Volumi 1, botimi i tretë (Varshavë: Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, 2011), Kapitulli 2.2 mbi Zgjedhjet, <<http://www.osce.org/odihr/76894>>.

8 Dyzetë e pesë nga 57 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë edhe anëtare të Këshillit të Evropës.

9 Këshilli i Evropës, Rec(2004)11, "Rekomandimi Rec(2004)11 i Komitetit të Ministrave ndaj vendeve anëtare mbi standardet ligjore, operacionale dhe teknike për votimin elektronik", Strasburg, 30 shtator 2004, <<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=778189>>.

10 "Raport mbi Përputhshmërinë e Votimit në Distancë dhe Votimit Elektronik me Standardet e Këshillit të Evropës", Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias), 12-13 mars 2004, <<http://www.venice.coe.int/WebForms/documents/?pdf=CDL-AD%282004%29012-e>>.

certifikimin e sistemeve elektronike të votimit, në plotësim të Rekomandimit të vitit 2004.¹¹ Në nivel kombëtar, disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë ndërmarrë nisma për të përpiluar kërkesat e tyre.

Së bashku me angazhimet e OSBE-së për zgjedhje demokratike, këto standarde përbëjnë bazën e vlerësimit të TRV-ve. Në veçanti, Rekomandimi i Këshillit të Evropës i vitit 2004 thekson se është e rëndësishme që proceset e votimit elektronik të jenë të vëzhgueshme. Standardet e Këshillit janë shpesh të një natyre teknike dhe theksojnë disa aspekte të votimit elektronik që mund të kalojnë përtej objektivit të një misioni vëzhgimi të zgjedhjeve apo të një misioni vlerësues. Gjithsesi, ato ofrojnë disa standarde referuese për autoritetet vendore, vëzhguesit dhe akademikët. Analistët e MVZ-ve, në veçanti Analistët e TRV-ve, duhet t'i njohin këto dokumente.

1.5 Parimet Kyçe të Vëzhgimit të Përdorimit të TRV-ve në një Proces Zgjedhor

Çdo proces zgjedhor në hapësirën e OSBE-së, përfshirë proceset që përdorin TRV-të, duhet të sigurojë respektim të plotë të të gjitha angazhimeve të OSBE-së, që mund të përmbliken në shtatë parime kyçe të renditura më poshtë që zbatohen gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit të përdorimit të TRV-ve. Ndaj ia vlen t'i shqyrtojmë më me hollësi këto parime dhe rrjedhojat e tyre për TRV-të.

1.5.1 Fshehtësia e Votës

Paragrafi 7.4 i Dokumentit të Kopenhagenit i vitit 1990 u kërkon shteteve pjesëmarrëse të "sigurojnë që votat të hidhen përmes votimit të fshehtë ose sipas një procedure të barasvlershme votimi të lirë". Kjo kërkesë qëndron në thelb të një procesi zgjedhor demokratik, dhe çdo proces votimi dhe numërimi që nuk e përmbush këtë angazhim nuk mund të konsiderohet demokratik.

Fshehtësia e votës do të thotë që nuk duhet të jetë e mundur të bëhet lidhja mes një vote dhe një zgjedhësi të caktuar. Kjo fshehtësi e lejon zgjedhësin ta ushtrojë zgjedhjen e tij lirisht, pa rrezik për presion, frikësim, apo blerje të votës. Sistemet TRV duhet të jenë në përputhje me këtë parim. Zgjedhësit nuk duhet të jenë në gjendje t'i provojnë askujt se si kanë votuar, dhe vetë sistemi nuk duhet të lejojë identifikimin e një zgjedhësi me votën e tij apo të saj. Kur sistemet TRV u japin zgjedhësve një biletë ose kod për të verifikuar nëse vota e tyre është regjistruar ashtu siç është hedhur, duhet të zbatohen masa shtesë për të mbrojtur fshehtësinë e votës në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Po ashtu, një sistem që ruan të dhëna elektronike (electronic log), që mund të përdoren për të bërë lidhjen e zgjedhësit me votën e tij, nuk siguron fshehtësinë e votës.

11 "Udhëzime mbi Certifikimin e Sistemeve të Votimit Elektronik", Këshilli i Evropës, nëntor 2011, <http://www.coe.int/t/dgap/democracy/activities/GGIS/E-voting/E-voting%202010/Biennial_Nov_meeting/Guidelines_certification_EN.pdf>; dhe "Udhëzimet mbi Transparencën e Zgjedhjeve të Mundësuar me Mjete Elektronike", Këshilli i Evropës, nëntor 2011, <http://www.coe.int/t/dgap/democracy/activities/GGIS/E-voting/E-voting%202010/Biennial_Nov_meeting/Guidelines_transparency_EN.pdf>.

1.5.2 Integriteti i Rezultateve

Integriteti i rezultateve - numërimi i votave dhe raportimi i rezultateve me ndershmëri sipas kërkesës së paragrafit 7.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 - vjen nga një sërë masash. Të gjitha votat duhet të hidhen në kutinë e votimit ashtu sikurse zgjedhësit i kanë shënuar, të gjitha votat duhet të numërohen ashtu siç janë hedhur, dhe asnjë votë nuk duhet të shtohet apo të zbritet në mënyrë të paligjshme nga rezultati. Nuk duhet të ekzistojë asnjë mundësi për mashtrime apo gabime të pazbuluara që ndryshojnë rezultatin. Në proceset që përdorin fletë votimi letër, integriteti i këtij zinxhiri mund të sigurohet nëpërmjet vëzhgimit të secilit hap në proces dhe të verifikohet, nëse është e nevojshme, nëpërmjet mundësisë së rinumërimit manual.

Si për fshehtësinë e votës, sistemet TRV duhet të ofrojnë garanci edhe për integritetin e rezultateve me qëllim respektimin e angazhimeve të OSBE-së për numërimin dhe raportimin e rezultateve. Duhet të ekzistojë mundësia për verifikim domethënës të votave të hedhura në mënyrë elektronike, të tilla si ajo e ofruar nga rinumërimi manual apo verifikueshmëria 'nga fillimi në fund'. TRV-të që mbështeten vetëm tek besimi që ka publiku në ndershmërinë e komisionerëve zgjedhorë, ofruesve të teknologjisë, programuesve apo teknikëve, nuk ofrojnë një mjet të efektshëm për verifikimin e integritetit zgjedhor. Mekanizmi i verifikimit duhet të garantojë plotësisht integritetin e rezultateve pa komprometuar fshehtësinë e votës.

Në të gjitha rastet, verifikimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur nga ai që zhvillon zgjedhjet dhe, së bashku me verifikimin e votave individuale, duhet të jetë në gjendje të kryhet për të gjitha votat e numëruara. Sistemet që i lejojnë zgjedhësit të verifikojnë që vota e tyre është regjistruar siç duhet nuk janë domosdoshmërisht të efektshëm në garantimin e integritetit të rezultateve të përgjithshme, përveçse kur verifikimi mund të bëhet edhe në një bazë më të gjerë.

1.5.3 Barazia e Votës

Paragrafi 7.3 i Dokumentit të Kopenhagenit thotë se shtetet pjesëmarrëse do të sigurojnë "të drejtë të barabartë vote për shtetasit në moshë madhore". Ndonëse kjo kërkesë merr kuptime të tjera shtesë, një prej aspekteve të parimit të barazisë është se asnjë zgjedhës nuk do të ketë mundësi të hedhë më shumë vota se një tjetër, dhe se qytetarët nuk do të pengohen të marrin pjesë në votim. Kjo do të thotë se sistemet TRV nuk duhet të lejojnë që një person të hedhë më shumë vota se sa parashikohet në ligj dhe nuk duhet të lejojnë që votat të zbriten nga sistemi. Disa sisteme votimi përmes internetit i lejojnë zgjedhësit ta hedhin votën më shumë se një herë, me kusht që të llogaritet vetëm vota e fundit. Kjo ndihmon në uljen e rrezikut të presionit mbi zgjedhësit dhe të blerjes së votës. Rrjedhimisht, duhet të jetë e mundur që të verifikohet se nuk kanë ndodhur shkelje të parimit të barazisë. Në të njëjtën kohë, parimi i barazisë do të thotë që të gjithë zgjedhësit kanë mundësi të votojnë, veçanërisht zgjedhësit që jetojnë brenda vendit. Përdorimi në procesin e votimit i teknologjisë që diskriminon grupe të caktuara zgjedhësish apo i shkurajon nga pjesëmarrja në zgjedhje nuk do të ishte në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Sistemet TRV shpesh i ndihmojnë zgjedhësit të votojnë siç synojnë, për shembull duke i ndihmuar të shmangin

votimin në mënyrë të paqëllimshme mbi maksimumin ose nën minimumin e lejuar të alternativave.¹² Sistemet TRV duhet të përcaktojnë nëse një votë e pavlefshme është hedhur me ose pa qëllim. Ndonëse duhet të jetë e mundshme hedhja me qëllim e një vote të pavlefshme, sistemet TRV duhet t'i këshillojnë zgjedhësit si të shmangin hedhjen e një vote të pavlefshme, nëse nuk e kanë këtë qëllim. Nëse sistemet TRV përdoren së bashku me mjete votimi tradicionale që përdorin letrën, atëherë të gjitha mjetet e votimit duhet të jenë të barasvlershme dhe votuesit që zgjedhin secilën prej tyre duhet të marrin trajtim të barabartë. Në të kundërt, barazia e votës mund të vihet në rrezik.

1.5.4 Universaliteti i Votës

E drejta universale e votës është e përcaktuar në paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagenit. Ky angazhim do të thotë se të gjithë qytetarët në moshë madhore me të drejtë vote duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në zgjedhje dhe duhet t'u sigurohen mjete të efektshme për pjesëmarrjen e tyre. Nëse përdoren TRV-të në qendra votimi, ato nuk duhet të jenë metoda ekskluzive e votimit, pasi zgjedhës me më pak njohuri kompjuterike mund të kenë probleme me përdorimin e sistemeve TRV. Në këto raste, qytetarëve duhet t'u jepet mundësia të përdorin fletë votimi letër nëse dëshirojnë. Votimi nëpërmjet internetit ka potencialin të ofrojë qasje më të lehtë dhe më shumë alternativa për pjesëmarrje në zgjedhje, sidomos për zgjedhësit që kanë pengesa për të shkuar te qendrat e votimit, përfshirë ata që jetojnë jashtë vendit apo zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Si në rastin e të gjitha formave të votimit në distancë, përfshirë votimin me anë të postës, edhe kjo alternativë mbart një rrezik më të madh për presion mbi zgjedhësit apo blerje të votës.

1.5.5 Transparenca

Transparenca është gur themeli i angazhimeve të OSBE-së për zgjedhjet, duke pasur parasysh se është e domosdoshme të verifikohet që zgjedhjet zhvillohen në përputhje me ligjin dhe me parimet demokratike. Vëzhgimi i zgjedhjeve është një aspekt kyç i transparencës, i njohur nga paragrafi 8 i Dokumentit të Kopenhagenit. Partitë politike, kandidatët dhe vëzhguesit duhet të kenë mundësi të vëzhgojnë punën e autoriteteve zgjedhore në të gjitha nivelet, sidomos në proceset e votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.

Ky vëzhgim duhet të jetë kuptimplotë.¹³ Mundësia e vëzhgimit kuptimplotë bëhet veçanërisht e rëndësishme kur në procesin zgjedhor futen ndryshime domethënëse, si ai i TRV-ve. Në rastin e votimit elektronik dhe teknologjive të numërimit, thjesht vëzhgimi i zgjedhësve dhe zyrtarëve teksa përdorin pajisjet nuk ka të ngjarë të jetë kuptimplotë. Vëzhguesit duhet të kenë akses shtesë në mënyrë që të sigurohen se zgjedhjet janë

¹² Për më tepër në lidhje me votimin mbi maksimumin ose nën minimumin e lejuar të alternativave, shikoni nëndarjen 4.4 mbi Lehtësinë në Përdorim dhe Dizajnin e Fletës së Votimit.

¹³ Për shembull, në sistemet që përdorin fletë votimi, numërimi nuk mund të konsiderohet transparent nëse vëzhguesit janë të pranishëm gjatë numërimit, por mbahen në një largësi të tillë që nuk i lejon të shohin përmbajtjen e fletës së votimit dhe nuk mund të verifikojnë që votat po numërohen me ndershmëri.

në përputhje të plotë me ligjin dhe me parimet demokratike. Vëzhguesit nuk duhet të ndërhyjnë në proces. Megjithatë, ata duhet të kenë akses të plotë në dokumentacionin që ka të bëjë me sistemin, përfshirë raportet e testimi dhe të certifikimit. Vëzhguesit nuk duhet të detyrohen të nënshkruajnë marrëveshje për ruajtjen e informacionit në mënyrë që të kenë qasje në informacion apo të mund të vëzhgojnë procesin, pasi kjo mund të rrezikojë aftësinë e MVZ-së për të raportuar mbi gjetjet. Legjislacioni dhe praktikatat që nuk lejojnë qasje të mjaftueshme për vëzhguesit nuk mund të vlerësohen se përmbushin plotësisht angazhimet e OSBE-së.

Transparenca përfshin edhe detyrimin që të gjithë aktorëve në zgjedhje, përfshirë zgjedhësit, t'u jepen mjetet e nevojshme për të mësuar me hollësi se si funksionojnë sistemet TRV.

1.5.6 Llogaridhënia

Vendimi Nr. 5/03 i Këshillit Ministerial të Mاستrihtit nënvizoi rëndësinë e llogaridhënies ndaj elektoratit nga ana e personave të përfshirë në proceset zgjedhore.¹⁴ Për TRV-të, kjo përfshin komisionerët zgjedhorë, ofruesit e teknologjisë, organet certifikuese dhe struktura të tjera të përfshira në prokurim, administrim dhe përdorim. Komisionerët zgjedhorë duhet të jenë përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm të zgjedhjeve, përfshirë mbikëqyrjen e TRV-ve. Nëse TRV-të përfshijnë teknologji të ofruara nga kompani private, roli dhe përgjegjësitë e këtyre ofruesve duhet të përkufizohen në mënyrë të qartë. Po ashtu, agjencitë e certifikimit dhe organet e tjera duhet të japin rreptësisht llogari me qëllim që të sigurohet se ato i përmbushin përgjegjësitë e tyre përkatëse.

Llogaridhënie do të thotë edhe që të mbahen procesverbale të hollësishme, të cilat përshkruajnë mënyrën se si administrata zgjedhore apo zyrtarë të tjerë të përfshirë në proces ndërveprojnë me sistemin, kur ndodh kjo dhe se kush e kryen punën. Procedurat e përshkruara në këto procesverbale duhet që, idealisht, të certifikohen nga një auditues i pavarur ose me anë të ndarjes së detyrave.¹⁵

1.5.7 Besimi i Publikut

Besimi i publikut është një element i rëndësishëm në një proces zgjedhor demokratik dhe është shprehur si i tillë në dokumente të OSBE-së, përfshirë Vendimin Nr. 5/03 të Këshillit Ministerial të Mاستrihtit të vitit 2003. Besimi i publikut merret gjithmonë parasysh në veprimtaritë e vëzhgimit të zgjedhjeve nga ana e ODIHR-it. Besimi i publikut mbështetet pjesërisht në masën në të cilën autoritetet politike, zyrtarët e zgjedhjeve dhe gjykatat respektojnë dhe zbatojnë parimet e evidentuara më lart. Besimi i publikut të zgjedhjet mund të dëmtohet nga perceptimi se zgjedhjet keqadministrohen apo mund të mos pasqyrojnë plotësisht vullnetin e popullit.

14 Vendimi Nr. 5/03 i Këshillit Ministerial të OSBE-së "Zgjedhjet", Mاستriht, 2 dhjetor 2003, <<http://www.osce.org/mc/40533>>.

15 Ndarje e detyrave do të thotë që kërkohen të paktën dy persona për të operuar me një sistem në të njëjtën kohë, duke siguruar në këtë mënyrë kontrolle dhe balancë për sjelljen e njëri-tjetrit, në përpjekje për të ulur abuzimet në detyrë.

Besimi i publikut është themelor për përdorimin e TRV-ve. Në rastet kur ka nivel të lartë mosbesimi dhe pakënaqësie me administrimin e zgjedhjeve, vendosja e TRV-ve mund të jetë problematike dhe mund ta ulë më tej besimin e publikut të zgjedhjet. Një qasje graduale për futjen e tyre, së bashku me testimin e kujdesshëm, verifikueshmërinë dhe transparencën e plotë, mund të ndihmojnë për forcimin e besimit të publikut të TRV-të.



Komisionerë zgjedhorë që u tregojnë teknologjinë e re të votimit zgjedhësve në Kazakistan, 2004.

2

Roli i Analistëve të MVZ-ve në Vëzhgimin e TRV-ve

Kur një vend përdor teknologjinë për të automatizuar votimin dhe numërimin e votave, kjo mund të ketë ndikim në drejtime të ndryshme të procesit zgjedhor dhe nuk mund të shihet si element i izoluar. Prandaj, analiza e TRV-ve duhet të jetë një pjesë përbërëse e punës së MVZ-ve dhe vëzhgimi i tyre duhet të jetë në të njëjtën linjë në secilën MVZ.

Ashtu si elementet e tjera në një MVZ, vëzhgimi i TRV-ve synon analizimin e informacionit të marrë, me qëllim vlerësimin e shkallës në të cilën ligjet dhe praktikat përmbushin angazhimet e OSBE-së, praktikat e tjera të mira ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar, dhe më pas dhënie të rekomandimeve ndërtuese për shtetin pjesëmarrës, që t'i marrë në konsideratë për t'i zbatuar në vazhdim.

2.1 Roli i MVN-së

Për zbatimin e TRV-ve nevojiten përgatitje komplekse dhe intensive, të cilat paraqesin sfida jo vetëm për aktorët vendas, por edhe për MVZ-të. Një pjesë e mirë e përgatitjeve për përdorimin e TRV-ve bëhet para arritjes së misionit të plotë MVZ, që zakonisht ndodh gjashtë deri në tetë javë para ditës së zgjedhjeve. Kjo u jep një rol të rëndësishëm Misioneve të Vlerësimit të Nevojave (MVN) kur përdoren TRV-të, misione që dërgohen te shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së sa herë që organizohen zgjedhje për të vlerësuar nevojën për veprimtari të ODIHR-it të lidhura me zgjedhjet. MVN-të duhet të shqyrtojnë planet për TRV-të për të vlerësuar nëse do të ketë zhvillime të rëndësishme para apo pas ardhjes së skuadrës bazë të MVZ-së. Këto ngjarje të rëndësishme mund të përfshijnë prodhimin e kredencialeve të zgjedhësit,¹⁶ testimet publike të pajisjes TRV, krijimin e çelësave elektronikë,¹⁷ sigurimin e integritetit të zgjedhjeve apo fshirjen e të dhënave nga pajisjet kryesore TRV.¹⁸ Mbështetur në këtë informacion, MVN-ja mund të rekomandojë që ekspertët të mbërrijnë para apo pas datës së mbërritjes së skuadrës bazë. Ekipi i ekspertëve mund të përbëhet nga dy ose më shumë analistë, si për shembull analistë të TRV-ve, ndonjëherë së bashku me analistët zgjedhorë, ligjorë, apo politikë, me qëllim ndjekjen e këtyre momenteve kyç.

2.2 Detyrat Specifike të MVZ-së

Për të analizuar në mënyrë të efektshme përdorimin e TRV-ve në zgjedhje në lidhje me shtatë parimet e përmendura më lart, secila MVZ do duhet të mbledhë dhe të vlerësojë disa informacione rreth teknologjive në përdorim, përfshirë:

- llojin e TRV-së së përdorur;
- arsyet e dhëna për përdorimin e TRV-së dhe përparësitë që mendohet të ofrojë në krahasim me proceset tradicionale të votimit dhe numërimit;
- procesin e përzgjedhjes, prokurimit dhe vënies në punë të sistemit TRV;
- nëse vendimi për futjen e TRV-së ka dakordësi me bazë të gjerë nga partitë politike, zgjedhësit dhe aktorët e tjerë zgjedhorë, apo, përkundrazi, është i polemizuar;
- rregullimet ligjore në fuqi për përdorimin e TRV-ve, përfshirë aksesin e vëzhguesve, si dhe diskutime të tjera në lidhje me prezantimin apo dispozitat për përdorimin e tyre;

16 Kredencialet e zgjedhësit mund të jenë karta e identitetit, fjalëkalime unike të përdorshme një herë, karta *smart*, ose mjete të tjera për ta identifikuar me saktësi përdoruesin si zgjedhës që gëzon të drejtën e votimit.

17 Takimi për krijimin e çelësve elektronikë është një takim (kryesisht për votimin me anë të internetit) në të cilin anëtarë kryesorë të organit të administrimit të zgjedhjeve krijojnë një "çelës" elektronik të fshehtë, i cili përdoret për të mbrojtur integritetin e votimit elektronik. Ky çelës ndahet shpesh në disa pjesë, të ruajtura në karta të veçanta *smart*, të cilat më pas mbahen nga anëtarë të caktuar të organit të administrimit të zgjedhjeve deri pas mbarimit të zgjedhjeve. Më pas, anëtarët mblidhen për t'i bashkuar pjesët e çelësit, hapin rutinë elektronike të votimit dhe fillojnë dekriptimin e votave elektronike, në mënyrë të ngjashme me procesin e mbylljes dhe numërimit të fletëve të votimit.

18 Shkatërrimi i të dhënave është metodë për t'i bërë të papërdorshme në mënyrë të parikuperueshme të dhënat që nuk nevojiten më. Kjo mund të bëhet në shumë mënyra, ku më e zakonshme është shkatërrimi i mjetit të ruajtjes së të dhënave nëpërmjet metodës magnetike, fizike apo termale.

- ❑ dokumentacionin mbi TRV-të që është i disponueshëm për publikun dhe dokumentacionin që është i disponueshëm vetëm për një publik të kufizuar;
- ❑ përdorueshmërinë¹⁹ e sistemit TRV;
- ❑ përpjekjet për trajnimin dhe edukimin e zgjedhësve rreth përdorimit të një sistemi TRV.

MVZ-të që kanë një Analist të TRV-ve do jenë në gjendje ta marrin dhe analizojnë informacionin më në thellësi, duke shqyrtuar çështje të tilla si kryerja e studimeve të fizibilitetit para vendimmarrjes, përzgjedhja dhe prokurimi i sistemit, certifikimi dhe testimi, përdorueshmëria, siguria e *software*-it dhe *hardware*-it, mbrojtja e të dhënave, transparenca, administrimi i sistemit nga administruesit e zgjedhjeve, llogaridhënia e ofruesve të teknologjisë dhe komisionerëve zgjedhorë, verifikimi i rezultateve dhe auditimet.²⁰ Megjithatë, analistë të tjerë të MVZ-së do të luajnë rol të rëndësishëm, sidomos në rastet kur Analisti i TRV-ve nuk është i pranishëm përgjatë gjithë kohëzgjatjes së misionit.

Pavarësisht nga teknologjia e përdorur, një detyrë me rëndësi kyçe për MVZ-në është të kuptojë nëse TRV-ja respekton parimet e paraqitura më lart, përfshirë fshehtësinë e votës dhe garancinë se rezultati pasqyron plotësisht përzgjedhjen e votuesit, apo nëse ka mangësi që mund të komprometojnë respektimin e tyre.

Përveç vlerësimit të teknologjisë, MVZ-ja duhet të marrë edhe informacione të tjera për përdorimin e TRV-ve me anë të takimeve me zyrtarë të shtetit, kandidatë, përfaqësues të partive politike, organizata të shoqërisë civile, ofrues të teknologjisë, përfaqësues të medias, gjyqtarë, akademikë, specialistë të fushës, e të tjerë. Informacioni, përfundimet dhe rekomandimet që dalin nga vëzhgimi duhet të përfshihen në raportimin e MVZ-së. Pjesët në vazhdim të këtij manuali i paraqesin më me hollësi të gjitha këto aspekte të vëzhgimit dhe vlerësimit të përdorimit të TRV-ve në zgjedhje.

2.3 Roli i Analistëve të Ndryshëm të MVZ-së

Aty ku është me vend dhe e mundur, të rekrutohet një Analist TRV-je për të qenë pjesë e MVZ-së. Analisti i TRV-ve duhet të jetë në gjendje të informojë anëtarët e misionit dhe të japë udhëzime shtesë për rrethanat që mund të kërkojnë vëmendje të veçantë. Të gjithë anëtarët e MVZ-së duhet të jenë të vetëdijshëm mbi lidhjen që kanë çështjet e TRV-ve me fushën e tyre të posaçme, dhe të punojnë së bashku për të analizuar kontekstin në të cilin përdoret TRV-ja.

Rolet e analistëve të ndryshëm të MVZ-së, që kanë gjasa të përpunojnë informacion që lidhet me TRV-të në kuadrin e misionit, përshkruhen në paragrafët e mëposhtëm.

¹⁹ "Përdorueshmëria" përkufizohet si një analizë e lehtësisë së përdorimit dhe të mësuarit të një teknologjie.

²⁰ Auditimi është vlerësimi nëse një sistem i plotëson ose jo kriteret e përcaktuara. Rezultati i këtij vlerësimi mund të jetë një raport auditimi ose një certifikatë.

2.3.1 Analisti i TRV-ve

Analisti i TRV-ve luan rol udhëheqës për vëzhgimin dhe dhënien e një vlerësimi për përdorimin e TRV-ve në zgjedhje dhe pasojat që ato sjellin në procesin në tërësi. Detyra kryesore e këtij personi është të kuptojë se si mendohet të funksionojnë TRV-të dhe se si funksionojnë ato në praktikë, si dhe t'i analizojë TRV-të sistematikisht në prizmin e shtatë parimeve të përmendura më lart. Kjo analizë përfshin procesin e votimit, të numërimit të votave si dhe të transmetimit të votave apo të rezultateve të votimit në nivel qendror për llogaritjen e rezultatit. Në disa raste, mund të përfshijë edhe identifikimin elektronik të zgjedhësve. Po ashtu, është e nevojshme të dihet se çfarë pajisjesh *hardware* dhe programesh *software* përdoren në secilën fazë të procesit. Prandaj, ky pozicion kërkon ekspertizë të gjerë mbi teknologjinë e informacionit, përvojë në sigurinë kompjuterike të sistemeve zgjedhore dhe përvojë me politikat e TRV-ve, me qëllim analizimin e duhur të të gjitha aspekteve të TRV-ve, si dhe aftësi të mira raportimi. Në rastet kur nevojat e MVZ-së kërkojnë njohuri të specializuara në aspekte teknike apo të politikave të TRV-ve, MVZ-ja mund të punësojë më shumë se një Analist TRV, me qëllim mbulimin e të gjitha aspekteve.

Analisti i TRV-së duhet të jetë i përgatitur të informojë dhe sqarojë anëtarët e tjerë të ekipit bazë të MVZ-së, si dhe vëzhguesit afatgjatë dhe afatshkurtër në lidhje me sistemin, si dhe të identifikojë çështjet kritike për vëzhgim. Gjithashtu, Analisti duhet të punojë ngushtësisht me anëtarët e ekipit bazë të renditur më poshtë, për të bërë një analizë të kontekstit në të cilin përdoret TRV-ja, si dhe të japë kontribut për hartimin e formularëve të vëzhgimit.

2.3.2 Analisti Ligjor

Analisti Ligjor është përgjegjës për analizimin dhe vlerësimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me përdorimin e TRV-ve. Kjo duhet të jetë pjesë integrale e vlerësimit më të përgjithshëm të kuadrit ligjor të ndërmarrë nga çdo MVZ. Metodologjia për vlerësimin e kuadrit ligjor zgjedhor si një i tërë parashtrohet në Udhëzuesin e ODIHR-it për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Zgjedhjet.²¹

Puna e Analistit Ligjor prek çështje të ndryshme që shqyrtohen në këtë manual, meqë shumë prej çështjeve që dalin në praktike, për shembull, certifikimi, auditimet dhe transparenca, duhet gjithashtu të rregullohen me ligj. Pra, Analisti Ligjor duhet të punojë ngushtë me Analistin e TRV-ve.

2.3.3 Analisti për Zgjedhjet

Përgjegjësia parësore e Analistit për Zgjedhjet është vlerësimi i punës së organeve të administrimit të zgjedhjeve. Kjo përfshin përdorimin e TRV-ve në procesin zgjedhor. Ndonëse nuk pritet që Analisti për Zgjedhjet të ketë domosdoshmërisht ekspertizë teknike për TRV-të, ky person duhet të jetë i vetëdijshëm për çështje të posaçme në fjalë dhe se si këto çështje ndikojnë në organizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve.

21 "Udhëzuesi për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Zgjedhjet", Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), janar 2001, <<http://www.osce.org/odihr/elections/13960>>.

2.3.4 Analisti Politik

Analisti Politik është pika parësore e kontaktit të MVZ-së me partitë politike apo kandidatët, dhe mban gjithashtu kontakte me vëzhguesit vendorë dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky Analist është në gjendje të mbledhë informacion dhe të analizojë qëndrimet e aktorëve të ndryshëm politikë kundrejt TRV-ve, si dhe të vlerësojë besimin që ata kanë në këtë teknologji.

2.3.5 Analisti i Medias

Analisti i Medias bën monitorimin sasior dhe cilësor të medias për MVZ-në dhe mban kontakte të vazhdueshme me median elektronike dhe atë të shkruar. Ky analist, veçanërisht në Misionet më të vogla për Vlerësimin e Zgjedhjeve, është në gjendje të mbështesë punën e Analistit të TRV-së duke vëzhguar qëndrimin e publikut në lidhje me përdorimin e votimit elektronik. Në rastet ku TRV-ja prezantohet për herë të parë në një proces zgjedhor, monitorimi i medias mund të luajë rol të rëndësishëm në vlerësimin e vlerës së shtuar që sjell përdorimi i TRV-ve.


2.3.6 Koordinator i VAGJ-ve

Koordinatori i VAGJ-ve është anëtar i skuadrës bazë që mbledh dhe analizon informacionin rajonal që mbledhet nga VAGJ-të, përfshirë edhe informacionin që ka të bëjë me përdorimin e TRV-ve dhe qëndrimin kundrejt tyre. Koordinatori i VAGJ-ve mund t'i ngarkojë VAGJ-të të ndjekin aspekte specifike në nivel rajonal dhe lokal. Kjo mund të ndihmojë shumë, sidomos në vendet ku përdoren lloje të ndryshme të TRV-ve në rajone të ndryshme, për të njëjtat zgjedhje.

2.4 Kodi i Sjelljes së Vëzhguesve Zgjedhorë të OSBE/ODIHR-it

Është e rëndësishme të theksohet se sipas Kodit të Sjelljes së Vëzhguesve të ODIHR-it, të gjithë anëtarët e MVZ-së duhet të shmangin çdo lloj ndërhyrjeje në procesin zgjedhor. Në veçanti, kjo do të thotë se MVZ-ja nuk mund të certifikojë që një TRV funksionon si duhet, pasi ky rol u përket autoriteteve kombëtare. Mosndërhyrje do të thotë edhe që vëzhguesit nuk duhet t'u ofrojnë këshilla apo sugjerime zyrtarëve zgjedhorë apo kandidatëve, dhe se nuk duhet të shprehin asnjë pikëpamje personale për TRV-në e përdorur në zgjedhje. Vëzhguesit nuk duhet asnjëherë të prekin apo përdorin pajisjet TRV në mënyra që mund të keqinterpretohen si manipulim apo ndryshim i paautorizuar i pajisjes. Po ashtu, vëzhguesit nuk duhet të kryejnë testime të paautorizuara, nuk duhet të përpiqen të sulmojnë (*hack*) sistemin, apo të komprometojnë paanshmërinë dhe qasjen e paanshme të një MVZ-je.²² Gjithashtu, vëzhguesit duhet të tregojnë kujdes të mos shkelin parimin e fshehtësisë së votës ndërsa përpiqen të marrin informacion mbi TRV-në.

²² "Hack-erimi" është një veprim, i cili synon të gjejë dhe shfrytëzojë dobësitë e një *hardware-i*, *software-i*, apo rrjeti kompjuterik, që mund të lejojë përdorimin e paautorizuar të sistemit.



Hard disqe të shkatërruara, që më parë përmbanin vota të enkriptuara nga zgjedhjet në Estoni, 2011

3

Analizimi i Kontekstit për Teknologjitë e Reja të Votimit: Vëzhgimi nga Ekipi Bazë i MVZ-së

3.1 Vendimmarrja Nëse dhe Si do të Përdoret TRV-ja

Si çdo ndryshim tjetër në një proces zgjedhor, TRV-të nuk përfshihen dhe nuk përdoren pa marrë parasysh kontekstin. MVZ-ja duhet të marrë në konsideratë historikun dhe arsyet që çojnë në përdorimin e votimit elektronik. MVZ-ja duhet të evidentojë veçanërisht se cilat janë sfidat dhe problemet për zgjidhjen e të cilave përdoret TRV-ja. MVZ-ja nuk

duhet të kufizohet vetëm tek përparësitë e TRV-së që paraqesin bashkëbiseduesit, por duhet të hetojë nëse ka edhe arsye të tjera për përdorimin e teknologjive të reja.

MVZ-ja duhet gjithashtu të shqyrtojë procesin e vendimmarrjes për përdorimin e TRV-ve. Ndryshimet e mëdha në një proces zgjedhor mund të kenë ndikim mbi të drejtat e zgjedhësve, mund të shkaktojnë shpenzime të konsiderueshme dhe të kenë ndikim të madh në besimin e publikut te procesi zgjedhor. Ndaj, ndryshime të tilla normalisht bëhen pas studimeve të kujdesshme dhe diskutimeve publike, si dhe debateve brenda organeve kombëtare legjislative. MVZ-ja duhet t'i kushtojë vëmendje mënyrës se si organizohet diskutimi publik dhe deri në ç'masë ky diskutim lejon të shprehen pikëpamje të ndryshme. Është e rëndësishme të vërehet nëse janë bërë konsultime me të gjitha partitë politike, grupet e shoqërisë civile dhe me ekspertë në këtë fushë, dhe sa janë marrë parasysht shqetësimet e tyre, nëse ka pasur të tilla.

Një tjetër aspekt i vendimit për përdorimin e TRV-ve është shkalla e dakordësisë mes partive politike. Kundërshtimet për përdorimin e TRV-ve mund të jenë tregues i mungesës së besimit tek teknologjia apo te kapaciteti i zyrtarëve zgjedhorë për ta administruar atë. Një vendim i marrë pavarësisht kundërshtimeve nga disa parti apo sektorë të rëndësishëm të shoqërisë civile mund të dëmtojë besimin e publikut në procesin zgjedhor në tërësi.

Një tjetër aspekt që MVZ-ja duhet të marrë parasysht është mënyra se si zbatohen në praktikë TRV-të. Vendimi për të përdorur TRV-të mund të krijojë vështirësi për përmbushjen e afateve zgjedhore. Shpesh vendimet për të përdorur TRV-të merren pak para dekretimit të datës së zgjedhjeve, duke mos lënë shumë kohë për zbatimin siç duhet të një sipërmarrjeje kaq të ndërlikuar. Futja graduale e TRV-ve nëpërmjet projekteve të vogla pilot në nivel qarku, që përfshijnë testimin, si dhe shtrirja graduale e TRV-ve në disa zgjedhje të njëpasnjëshme, mund të shërbejë për të evidentuar dhe korrigjuar probleme dhe mund të ndihmojë për të ndërtuar besimin e publikut te teknologjia.

Kjo futje graduale mund të përfshijë, për shembull, votime test, rezultati i të cilave nuk është detyrues, në pak bashki gjatë zgjedhjeve vendore ose në një numër të kufizuar qendrash votimi gjatë zgjedhjeve të përgjithshme. Nga ana tjetër, përdorimi i TRV-ve në shkallë të gjerë gjatë një procesi zgjedhor paraqet rreziqe shtesë për procesin. MVZ-ja duhet të shqyrtojë me kujdes arsyet për përdorimin e TRV-ve në shkallë të gjerë dhe të vërejë nëse ky përdorim nxitet nga nevoja konkrete të zgjedhjeve, nga interesa të firmave që shesin teknologjinë apo nga arsye të tjera. Më tej, vendimet për përdorimin e TRV-ve nuk duhet të zbatohen menjëherë në zgjedhjet e radhës, me qëllim që të lejojnë kohë për studimet e fizibilitetit, prokurimin, planifikimin, testimin, vlerësimin, certifikimin, edukimin e zgjedhësve, ndërtimin e besimit të publikut dhe vënien në punë të TRV-ve.

Niveli i njohjes së teknologjive të reja nga ana e publikut në përgjithësi, dhe aftësia e tij për t'i përdorur ato pa vështirësi, janë faktorë të rëndësishëm që duhen marrë parasysht kur planifikohet futja e TRV-ve, aq më tepër nëse TRV-ja do jetë e vetmja mënyrë votimi dhe nuk do ketë alternativa votimi në letër. Për shembull, nëse bankomatet nuk përdoren

gjerësisht, ose janë të disponueshme vetëm në zonat urbane, atëherë teknologjia e votimit me prekje të ekranit ka gjasa t'i çorodisë zgjedhësit. Tregues të tjerë të nivelit të njohjes së teknologjive të informacionit nga publiku janë numri i kompjuterëve në zotërim dhe përhapja e internetit. Mungesa e njohurive kompjuterike mund të bëjë që shumë zgjedhës të kërkojnë ndihmë, çka mund të ketë ndikim negativ në fshehtësinë e votës ose në aftësinë e zgjedhësve për të zgjedhur lirisht. Një tjetër rrezik është se teknologjia mund të frenojë zgjedhës të caktuar dhe mund të bëjë që ata të mos dalin për të votuar.

MVZ-ja duhet të marrë parasysh edhe ndikimin e mundshëm të TRV-së së përzgjedhur mbi elektoratin në përgjithësi dhe grupe të veçanta zgjedhësish. TRV-ja mund të bëhet pengesë për të gjithë zgjedhësit në rastet e problemeve teknike dhe vështirësisë së përdorimit, kur sigurisë apo koston i jepet përparësi mbi dobishmërinë, ose thjesht kur caktohen më shumë zgjedhës për një pajisje votimi se ç'mund të përballojë ajo. Në këto raste, procesi i votimit mund të ndërlikohet, të zgjasë më tepër, apo të shoqërohet me radhë të gjata. Gjithashtu, nëse zgjedhësit besojnë se sistemi i lejon të tjerët të mësojnë se si kanë votuar, ose nëse sistemi sjell ndërlikime shtesë në procesin e votimit, mund të ketë më pak të ngjarë që ata ta ushtrojnë të drejtën e votës. Po ashtu, TRV-të ofrojnë mundësinë për të zgjeruar aksesin për zgjedhësit me aftësi të kufizuara apo ata që përdorin gjuhën e pakicave. Por, nëse nuk zbatohet me kujdes, teknologjia mund të kthehet në pengesë për pjesëmarrjen e tyre.

Pas shqyrtimit të këtyre çështjeve, MVZ-ja mund të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të vendimit për përdorimin e TRV-së. Ajo mund të vlerësojë se sa i pasqyron ky vendim nevojat e vërteta, nëse është i mbështetur në studime të hollësishme dhe diskutime publike, nëse është fryt i një marrëveshjeje të gjerë apo kishte kundërshtime të forta nga disa palë, nëse TRV-të janë futur gradualisht apo me ngutje, sa të sigurtë ndihen zgjedhësit me përdorimin e teknologjisë dhe ndikimin e saj mbi të drejtën për të votuar. Ky vlerësim do të jetë i dobishëm për të parë ndikimin e futjes së TRV-së tek besimi i publikut në procesin zgjedhor në tërësi, një çështje kjo që MVZ-ja duhet ta diskutojë me të gjithë bashkëbiseduesit.

Pyetje të mundshme:

- Cilat ishin arsytet për futjen e TRV-së? Cilat ishin problemet apo sfidat që teknologjia synon të trajtojë?
- A u mor vendimi për futjen e TRV-së pas kryerjes së një studimi për realizueshmërinë e saj? Nëse po, cili grup apo cilat grupe i bënë studimet? Cilat ishin çështjet që u studiuan? A u bë një analizë kosto-përfitim? A u bënë publikë raportet?
- Cila ishte shkalla e diskutimit publik? A ishin në gjendje grupet e shoqërisë civile dhe akademikët që të kontribuonin në mënyrë kuptimplote? Cilat janë qëndrimet e tyre në lidhje me futjen e TRV-së dhe sa janë marrë parasysh shqetësimet e tyre?

<p>➡ A pati marrëveshje të gjerë mes partive politike apo kishte kundërshtime thelbësore? A mendojnë të gjitha palët se shqetësimet e tyre janë marrë parasysh sa duhet?</p>
<p>➡ A u fut TRV-ja në mënyrë graduale, për shembull nëpërmjet projekteve pilot? Nëse po, sa projekte të tilla janë zbatuar? A u zbatuan në zgjedhje reale, rezultati i të cilave ka efekt ligjor detyrues? A ka informacion në lidhje me faktin se sa të vërteta dhe realiste ishin projektet pilote apo testimet? Nëse TRV-ja u fut në shkallë të gjerë, cila ishte arsyeja për këtë zgjedhje? Sa janë përdorur mësimet e nxjerra nga projektet pilot në zbatimet e mëvonshme të TRV-së në vend?</p>
<p>➡ Sa i njohin zgjedhësit teknologjitë e reja të informacionit në përgjithësi, si për shembull bankomatet, kompjuterët dhe internetin? A janë bërë studime për njohuritë që ka publiku i gjerë për teknologjinë e informacionit?</p>
<p>➡ Ç'ndikim ka sistemi në procesin e votimit për grupet potencialisht të cënueshme të zgjedhësve? Cilat janë pikëpamjet e zgjedhësve të moshuar, e grave, e pakicave kombëtare apo votuesve me aftësi të kufizuara? A ka më shumë apo më pak gjasa që ata të votojnë si pasojë e futjes së TRV-së?</p>
<p>➡ Cili është niveli i besimit të publikut të TRV-të? A gëzon TRV-ja të njëjtin nivel besimi me sistemin që ajo plotëson apo zëvendëson?</p>
<p>➡ Ç'masa ligjore janë marrë për të mos pasur konflikte të mundshme interesi mes ofruesve të teknologjisë, agjencive të certifikimit dhe zyrtarëve zgjedhorë? A ekziston një kod etike që parandalon vendimmarrjet e njëanshme apo shkëmbimin e çdo gjëje me vlerë financiare mes shitësve të teknologjisë dhe zyrtarëve?</p>

3.2 Konteksti Ligjor

Kjo pjesë vlerëson veçanërisht nëse kuadri ligjor siguron plotësisht që përdorimi i TRV-së është në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mira ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe nëse vënia në funksionim e TRV-së bëhet në përputhje me këto parime dhe me legjisllacionin e brendshëm.

Një nga detyrat kryesore të MVZ-së është të kuptojë kuadrin rregullator mbi TRV-të për zgjedhjet që po vëzhgon. Kjo kërkon shqyrtim të hollësishëm të dispozitave kushtetuese, ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Mund të kërkojë gjithashtu shqyrtimin e akteve të tjera ligjore, si për shembull ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave. Duhet marrë parasysh dhe çështje të mëparshme gjyqësore kundër përdorimit të TRV-ve dhe jurisprudenca përkatëse.

Ligjet zgjedhore mund të parashikojnë rregullime të hollësishme, ose kuadri ligjor mund të përcaktojë vetëm rregulla të përgjithshme, duke ia lënë hollësitë akteve nënligjore të nxjerra nga administrata zgjedhore. Ndonëse alternativa e fundit është më e përshtatshme për sa i takon fleksibilitetin, ajo mund të krijojë hapësirë të tepërt që procedurat zgjedhore t'u përshtaten nevojave të teknologjisë, në vend që të ndodhte e kundërta, dhe mund të anashkalohen masa mbrojtëse të rëndësishme, nëse koha

ngushtohet për shkak të vonesave në zbatimin e sistemit TRV. Gjithashtu, nuk duhet të ketë boshllëqe domethënëse në kuadrin ligjor. Për shembull, duhet të jetë e qartë se çfarë hapash merren nëse TRV-të nuk funksionojnë pjesërisht apo plotësisht në një apo më shumë qendra votimi.

Një tjetër detyrë e rëndësishme është shqyrtimi nëse legjislacioni zgjedhor përcakton qartë të paktën parimet e fshehtësisë, barazisë, universalitetit, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të rezultateve. Barazia dhe fshehtësia e votës parashikohen në kushtetutat e shumë shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Nëse kërkohen dispozita të posaçme për t'u siguruar që sistemet TRV i garantojnë këto parime, ato duhet që, në mënyrë ideale, të parashikohen në legjislacionin zgjedhor. Pra, MVZ-ja duhet të konfirmojë nëse kuadri ligjor parashikon detyrimin për barazi dhe fshehtësi të votës, dhe të vlerësojë nëse dispozitat për TRV-të janë në përputhje me këto kërkesa, si dhe nëse e rregullojnë përdorimin e TRV-ve në mënyrë të ngjashme me votimin me fletë votimi letër. Në këtë mënyrë, ligji duhet të parashikojë dhe rregullojë qartësisht të gjitha fazat e përdorimit të TRV-ve në procesin zgjedhor, përfshirë shpërndarjen, montimin, fillimin, funksionimin, ndalimin dhe mbylljen e sistemit, si dhe ruajtjen, numërimin dhe mbledhjen e votave. Sikurse në votimin me fletë votimi letër, ligji duhet të parashikojë kritere të qarta për të përcaktuar vlefshmërinë e votës elektronike, sidomos në rastet e keqfunksionimit të sistemit TRV.

Legjislacioni zgjedhor duhet gjithashtu të trajtojë mënyrën se si sistemi TRV mund të sigurojë që votat numërohen me ndershmeri. Kjo do të thotë që, në rastin e një ankimi ligjor apo kontrolli të rezultateve, sistemi TRV duhet të ofrojë mundësinë e një verifikimi real të votave të hedhura në mënyrë elektronike. Sikurse u vu në dukje më lart, mundësia e rinumërimit manual të kopjeve në letër mund të përbëjë një mjet verifikimi kur sistemet përdoren në mjedise të kontrolluara. Që kjo të ndodhë realisht, ligji duhet të parashikojë që kopja në letër të verifikohet nga zgjedhësi dhe të ruhet nga sistemi (VVPAT). Ligji duhet të përcaktojë se kush mund të kërkojë rinumërim dhe në cilat rrethana.

Një tjetër aspekt i rëndësishme për t'u marrë në konsideratë është mënyra si rregullohet parimi i llogaridhënies në aktet ligjore dhe nënligjore zgjedhore. Nëse TRV-ja përfshin teknologji të ofruar nga shitës privatë të teknologjisë, legjislacioni duhet të parashikojë përgjegjësinë e privatëve, që të sigurohet se nuk ka hapësira që i lejojnë ata të përvetësojnë përgjegjësitë që u përkasin autoriteteve publike. Kontraktorët apo shitësit privatë të teknologjisë nuk mund të zëvendësojnë funksione të rëndësishme të administratës zgjedhore, e cila duhet të mbetet në kontroll të plotë të procesit zgjedhor. Po ashtu, agjencitë e certifikimit duhet të japin rreptësisht llogari, për t'u siguruar se ato i përmbushin përgjegjësitë e tyre.

Ligji duhet të përcaktojë edhe shkallën e qasjes për vëzhguesit, partitë politike dhe zgjedhësit. MVZ-ja duhet të shqyrtojë nëse ligji e parashikon në mënyrë të kënaqshme dhe të duhur qasjen e vëzhguesve në sistem, në përputhje me parimin e transparencës. Një formë qasje është dhënia e mundësisë për ta "sulmuar" TRV-në (ku specialistët, pa parapërgatitje, përpiqen të evidentojnë mangësitë në siguri ose dobësi të tjera), mundësia për të shqyrtuar dokumente të tilla si studime fizibiliteti, materiale prokurimi,

manuale, raporte vlerësimi dhe certifikimi, kodi i burimit të sistemit²³ apo *log*-e elektronike të sistemit.

Në lidhje me sigurinë e TRV-së, është e rëndësishme të dihet nëse dhe çfarë dispozitash janë parashikuar në Kodin Penal për sulmet ndaj sistemeve informatike, si dhe nëse ekzistojnë dispozita të posaçme për sistemet informatike të përdorura në kuadrin e zgjedhjeve.

MVZ-ja duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë vlerësimit të kuadrit ligjor në lidhje me shqyrtimin e ankimeve dhe apelimeve, si dhe të vëzhgojë funksionimin e procesit të ankimeve dhe apelimeve në praktikë, përfshirë rastet e ankimit për çështje që kanë të bëjnë me TRV-në. Ankimet dhe apelimet mund të kenë të bëjnë me përdorimin e vetë sistemit gjatë procesit të votimit dhe numërimit, ose me elemente të tjera të procesit, si certifikimi i sistemit apo çfarë ndodh nëse sistemi TRV nuk funksionon. Megjithëse TRV-të mundësojnë raportim të shpejtë të rezultateve, kjo nuk duhet të përjashtojë mundësinë e ankimit ndaj vendimeve apo rezultateve. Afatet ligjore duhet ta reflektojnë si duhet këtë të drejtë. Në rast ankimi ligjor ndaj rezultateve, duhet të ketë përcaktime të qarta se mbi ç'bazë ligjore mund të bëhet rinumërimi dhe cili organ ka kompetencën të vendosë për rinumërimin. Rinumërimi mund të kërkohet nëse ka një ankim që pretendon se ka të dhëna për një anomali apo mosfunksionim që mund të ketë ndikuar te rezultatet.

Nëse sistemi TRV mban një kopje në letër, dispozitat ligjore duhet të parashikojnë një auditim të rezultateve në letër dhe atyre elektronike, të paktën në një përqindje statistikisht domethënëse të qendrave të numërimit të përzgjedhura rastësisht, si një mënyrë tjetër për verifikimin e rezultateve. Këto auditime duhet të jenë të hapura për vëzhguesit. Mangësitë e sistemit, mosfunksionimi i printerit apo prishjet e qëllimshme mund të çojnë në situata ku, nëse bëhet rinumërim manual apo auditim, të dhënat elektronike dhe ato në letër nuk rakordojnë dhe nuk përkojnë. Në rast mospërputhjes që nuk duket se vijnë nga gabime të thjeshta njerëzore të bëra gjatë rinumërimit manual, ligji duhet të përcaktojë qartë se si kjo mospërputhje cenon rezultatin dhe nëse ndonjë pjesë e rezultatit duhet të konsiderohet e pavlefshme. Kuadri ligjor që rregullon ankimin ndaj rezultateve zgjedhore duhet të parashikojë cili nga këta elementë mbizotëron: kopja e votës në letër apo vota elektronike.²⁴

Nëse ligji parashikon një mënyrë tjetër për verifikimin e integritetit të rezultateve, përveç rinumërimit manual ose auditimit manual të rezultateve, MVZ-ja duhet të vlerësojë me kujdes nëse mekanizmi garanton plotësisht integritetin e rezultateve pa cenuar fshehtësinë e votës.

²³ Kodi i burimit të sistemit është tekst i lexueshëm nga njeriu, i shkruar në një gjuhë të posaçme kompjuterike, që mund të përkthehet menjëherë në një sërë udhëzimesh kompjuterike, domethënë një program i zbatueshëm.

²⁴ Në përgjithësi, kopjet në letër duhet të kenë përparësi. Duhet bërë kujdes të sigurohet se si kopjet në letër dhe ato elektronike të dalin me rezultate krahasimisht të njëjta. Nëse ka ende dyshime, mund të konsiderohet përsëritja e zgjedhjeve.

Së fundi, MVZ-ja duhet të shqyrtojë çështjet e mbrojtjes së të dhënave. Paragrafi 24 i Dokumentit të Moskës i vitit 1990 njih të drejtën e privatësisë. Kjo vlen veçanërisht për zbatimet e teknologjisë ku identiteti i zgjedhësit mund të regjistrohet, siç është rasti i votimit përmes internetit. MVZ-ja duhet të evidentojë detyrimet ekzistuese ligjore për mbrojtjen e të dhënave dhe nëse sistemi TRV i përmbush këto detyrime, përfshirë detyrimet e posaçme që mund të ekzistojnë për sisteme që përpunojnë të dhëna personale me ndjeshmëri të lartë, të tilla si qëndrimi politik i zgjedhësit. Më tej, MVZ-ja duhet të përpiket të vlerësojë nëse përfitimet e përdorimit të TRV-së, sidomos kur kemi të bëjmë me përdorimin e të dhënave personale, janë në raport të drejtë me vlerën e shtuar që ajo sjell në një proces zgjedhor. Standardet e mbrojtjes së të dhënave kërkojnë që çdo zgjedhës të vihet në dijeni për ekzistencën e përpunimit të automatizuar të të dhënave, llojin e të dhënave që mblidhen dhe identitetin e mbledhësit të tyre, që të dhënat përpunohen vetëm në lidhje me zgjedhjet përkatëse dhe nuk përdoren për qëllime të tjera, dhe se nuk ruhen për një periudhë më të gjatë nga sa është e nevojshme (d.m.th., shkatërrohen pas përfundimit të procesit të ankimeve dhe apelimeve).

Pyetje të mundshme:

- Si përkufizohet dhe rregullohet me ligj përdorimi i TRV-së? A janë ligjet dhe/ose aktet nënligjore për zgjedhjet të detajuara mjaftueshëm për të dhënë udhëzime të qarta për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me TRV-në?
- A është ankimuar më parë në gjykatë përdorimi i TRV-së? Nëse po, mbi ç'baza dhe si u zgjidh çështja?
- A e parashikon plotësisht ligji barazinë dhe fshehtësinë e votës? A përputhen dispozitat ligjore për TRV-në me këto parime? Për shembull, a i krijon ligji mundësinë zgjedhësit që të mbajë një dokument apo të dhënë, që e mundëson atë të vërtetojë për kë ka votuar në rast se i ushtrohet presion? Apo a bën procesi i verifikimit lidhjen mes zgjedhësit dhe votës?
- A e parashikon ligji mundësinë për të verifikuar plotësisht se rezultatet paraqesin zgjedhjen e vërtetë të votuesve?
- A parashikon ligji që sistemi TRV duhet të ruajë një kopje në letër të votës së hedhur? Nëse po, a verifikohet kjo nga zgjedhësi, d.m.th., me VVPAT?
- Cilat janë dispozitat për auditimin e kopjeve në letër të verifikuara nga zgjedhësi? A kryhen këto auditime automatikisht apo në bazë kërkesë? A lejon ligji që kopjet në letër të verifikuara nga zgjedhësi të merren parasysh në kyerjen e rinumërimeve? Cili version i votës, ai elektronik apo në letër, konsiderohet si votë me fuqi detyruese ligjore?
- A e rregullon siç duhet legjislacioni çështjen e llogaridhënies nga ana e administratorëve të zgjedhjeve, organeve rregullatore dhe shitësve të teknologjisë të përfshirë në prokurimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve TRV?
- Deri në ç'masë kërkon ligji që të dokumentohen veprimet e administratës zgjedhore që kanë të bëjnë me sistemin elektronik të votimit?
- A e përcakton ligji se çfarë ndodh nëse TRV-ja nuk funksionon siç duhet?

- ➡ Si e parashikon ligji qasjen e vëzhguesve në TRV? A u sigurohet vëzhguesve qasje në dokumentacionin që ka të bëjë me TRV-në? A ka ndonjë kufizim? A kanë vëzhguesit të drejtë ligjore të marrin kodin e burimit të sistemit si dhe raportet e certifikimit dhe auditimit?
- ➡ A mundësojnë dispozitat ligjore që ankimet dhe apelimet në lidhje me TRV-në të shqyrtohen në mënyrë të efektshme? Kush ka të drejtë të bëjë ankim në lidhje me përdorimin e TRV-së? Çfarë mund të konsiderohet si provë? A parashikon ligji rinumërim manual me përzgjedhje rastësore të votave? Në ç'rrethana?
- ➡ Cilat janë detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave? A i respektojnë procedurat zgjedhore këto detyrime, veçanërisht në rastin e përpunimit të të dhënave me ndjeshmëri të lartë?
- ➡ A parashikon kuadri ligjor sanksione të zbatueshme për rastet e sulmeve ndaj sistemit TRV?
- ➡ A parashikon kuadri ligjor afate kohore të mjaftueshme për marrjen e vendimeve kyçe mbi TRV-në, përfshirë prokurimin dhe testimin?

3.3 TRV-ja dhe Sistemi Zgjedhor

MVZ-ja duhet të analizojë një sërë të dhënash bazë lidhur me shkallën në të cilën do të përdoren TRV-të. Nëse TRV-të përdoren në qendra votimi, është e rëndësishme të dihet sa qendra votimi janë të pajisura me TRV, ku ndodhen, sa zgjedhës ndikohen, dhe nëse këta zgjedhës përfaqësojnë një grup të veçantë (për shembull, një pakicë kombëtare apo persona me aftësi të kufizuara). Gjithashtu, është e rëndësishme të dihet nëse zgjedhësit në zonat e përzgjedhura do të përdorin ekskluzivisht vetëm TRV-në, apo si alternativë do të jenë në gjendje të përdorin edhe fletë votimi letër. Informacion i ngjashëm duhet të mblidhet në rast se bëhet votim me anë të internetit apo me ndonjë tjetër metodë votimi elektronik në distancë.

Një tjetër detyrë fillestare e MVZ-së është të shqyrtojë sistemin zgjedhor dhe ndikimin e tij te zbatimi i mundshëm i TRV-së. Për zgjedhjet parlamentare, një sistem proporcional kombëtar me lista të mbyllura mund të kërkojë vetëm një lloj flete votimi që përdoret nga të gjithë zgjedhësit. Sistemi me listë preferenciale i lejon zgjedhësit të zgjedhin një ose më shumë kandidatë, nga një apo shumë lista. Sistemi në bazë zone zgjedhore, qoftë me shumë mandate apo me një mandat të vetëm, kërkon lloje të ndryshme fletësh votimi për çdo zonë zgjedhore. Zgjedhjet e shumëfishta të organizuara njëkohësisht, si zgjedhjet vendore dhe rajonale, kërkojnë disa tipe flete votimi elektronike për çdo zonë zgjedhore. Të gjitha këto ndikojnë tek lehtësia me të cilën mund të zbatohet TRV-ja.

Pavarësisht nga kompleksiteti relativ i sistemit, është e rëndësishme që çdo zgjedhës i një zone zgjedhore të caktuar të marrë fletën ose fletët e duhura të votimit. Kjo është analoge me zgjedhjet e zhvilluara me fletë votimi letër, me një dallim kyç që TRV-ja duhet të programohet për secilën fletë votimi që më parë. Ngarkimi i fletës së votimit në sistem mund të bëhet me mjete të ndryshme teknike, nga qendra ose në nivelet më

poshtë. Është e rëndësishme të kihet parasysh se ngarkimi i të dhënave përmban disa reziqe sigurie për kompjuterët dhe duhet të bëhet sipas një protokollit të parapërcaktuar, i disponueshëm për vëzhguesit.

Përveç sigurisë së sistemit, lloji i fletës së votimit të nevojitur ndikon në dizajnin e fletës së votimit. Ndryshe nga fletët e votimit në letër, që nuk kufizohen nga përmasa, përmasat e ekranit të kompjuterit e kufizojnë numrin e mundësive që mund të shfaqen në të njëjtën kohë.

Të dyja çështjet trajtohen më me hollësi në seksionin në vijim.

Pyetje të mundshme:

- Cila është shtrirja e përdorimit të TRV-ve në zgjedhje? Nëse TRV-të përdoren në qendrat e votimit, sa përqind e tyre do të përdorin TRV dhe sa përqind fletë votimi letër (ose të dyja format)?
- Në qendrat e votimit që përdorin pajisjet TRV, a do të jenë zgjedhësit në gjendje të votojnë me fletë votimi letër nëse e parapëlqejnë këtë metodë?
- Nëse përdoret votimi me anë të internetit ose teknologji të tjera të votimit elektronik në distancë, sa përqind e zgjedhësve kanë qasje në këtë teknologji? A kufizohet ky përdorim në një zonë gjeografike apo grup zgjedhësish të caktuar (për shembull, një pakicë kombëtare ose persona me aftësi të kufizuara)?
- Cili është ndikimi që sistemi zgjedhor aktual ka mbi TRV-në?

3.4 Partitë Politike, Shoqëria Civile dhe Media

Pikëpamjet e partive politike për futjen e TRV-ve janë një tregues i rëndësishëm i besimit të publikut. MVZ-ja duhet që, idealisht, të kërkojë pikëpamjet e të gjitha partive që garojnë në zgjedhje. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të numrit të madh të partive, MVZ-ja duhet të diskutojë në mënyrë të veçantë çështjet mbi TRV-në me partitë e përfaqësuar në parlament apo me partitë kryesore në qeverisje dhe opozitë. Arsyet e qëndrimit të tyre pro apo kundër votimit elektronik janë të rëndësishme për të kuptuar kontekstin e përgjithshëm. Partitë duhet të pyeten edhe se cilat hapa, nëse ka të tilla, janë marrë nga administrata zgjedhore apo autoritete të tjera për të trajtuar shqetësimet e tyre. Duhet të diskutohet edhe besimi i partive në kapacitetin profesional dhe objektivitetin e administratës zgjedhore, i cili mund të jetë i ndryshëm nga besimi në TRV-në.

Grupet e shoqërisë civile janë një tjetër burim informacioni për MVZ-të. Grupet e vëzhguesve vendorë mund të vëzhgojnë përdorimin e TRV-së dhe të mbajnë qëndrime publike në këtë drejtim. Në disa vende, mund të jenë aktivë për këtë çështje grupe të vogla të akademikëve apo ekspertëve kompjuterikë, dhe MVZ-ja duhet të kërkojë të dëgjojë pikëpamjet e tyre. Nëse nuk është ky rasti, MVZ-ja duhet të kërkojë të flasë me ekspertë përkatës të teknologjisë së informacionit, pasi kjo shpesh ndihmon për

të kuptuar më në brendësi kontekstin për prezantimin e sistemit, firmat që ofrojnë teknologjinë dhe njohuritë kompjuterike të publikut.

MVZ-ja duhet të vlerësojë shkallën në të cilën partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile vëzhgojnë përdorimin e TRV-së. Nëse duket se ata nuk janë aktivë, kjo mund të jetë një shenjë besimi të përgjithshëm, por mund të vijë edhe për shkak të kufizimeve për vëzhgim apo mungesës së ekspertizës. MVZ-ja duhet të pyesë nëse partitë, vëzhguesit vendorë ose palë të tjera kanë kërkuar qasje në ndonjë aspekt të procesit, dhe nëse po, çfarë kontrollesh kanë mundur të bëjnë dhe çfarë informacioni nuk kanë mundur të marrin, nëse ka patur të tilla. MVZ-ja duhet gjithashtu të zbulojë nëse këto grupe janë në gjendje të kenë qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara, përfshirë dokumentacionin e sistemit, raportet e certifikimit dhe kodin e burimit.

Është gjithashtu me vlerë të monitorohet nëse përdorimi i TRV-së është një çështje e trajtuar në fushatë, dhe sa diskutohet në publik mbi këtë temë. Monitorimi i medias nga MVZ-ja mund të prodhojë të dhëna statistikore mbi pasqyrimin e çështjes në media të ndryshme dhe mbi sasinë e materialit për edukimin e zgjedhësve të shfaqur në media, si dhe përhapjen prej saj.

Një tjetër çështje e rëndësishme mund të jetë niveli i përhapjes së internetit dhe përdorimi i tij në vend. Sa i aksesueshëm lirisht është interneti është një çështje e rëndësishme e situatës në vend. Në rast se informacioni politik censurohet apo disa faqe interneti janë bërë të paaksesueshme, kjo mund të ndikojë në perceptimin e publikut për përdorimin e teknologjisë kompjuterike në një proces zgjedhor.

Pyetje të mundshme:

- Cilat janë qëndrimet e partive politike mbi futjen dhe përdorimin e TRV-ve? A e ka kundërshtuar ndonjë parti politike përdorimin e tyre? Nëse po, a mban përsëri të njëjtin qëndrim? Cilat arsye jepen për kundërshtimin? A është TRV-ja një çështje e diskutuar në fushatë?
- Sa e njohin partitë politike dhe kandidatët TRV-në?
- Ç'pikëpamje kanë organizatat e vëzhguesve vendorë?
- A kanë vëzhguar ndonjë aspekt të TRV-së partitë politike, kandidatët dhe grupet e vëzhguesve vendorë?
 - Nëse jo, pse?
 - Nëse po, çfarë kanë konstatuar?
 - A ka patur ndonjë aspekt të procesit apo ndonjë dokument tek i cili nuk kanë mundur të kenë qasje?
- Ç'pikëpamje kanë ekspertët e teknologjisë së informacionit dhe akademikët?
- Në ç'masë janë diskutuar publikisht çështjet e TRV-ve? Sa u mbulua nga media ky diskutim?



OSCE/ROBERT KRUMHOFER

Një komisioner zgjedhor tregon teknologjinë e skanimit të fletës së votimit në Federatën Ruse, 2011.

4

Vlerësimi i Teknologjive të Reja të Votimit: Puna e Analistit të TRV-së

Analisti i TRV-së ka rol parësor brenda MVZ-së për dhënien e vlerësimit për përdorimin e TRV-së në zgjedhje. Përveç bashkëpunimit me anëtarë të tjerë të ekipit bazë për të vlerësuar kontekstin, Analisti i kushton vëmendje të veçantë disa aspekteve të TRV-së që kërkojnë ekspertizë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kompjuterike.

4.1 Prokurimi dhe Blerja e TRV-së

Një prej çështjeve që Analisti i TRV-së duhet të marrë parasysh është mënyra e prokurimit dhe blerjes së teknologjisë. Megjithëse MVZ-ja nuk përcakton nëse është

zgjedhur sistemi “më i mirë”, procesi nëpërmjet të cilit është zgjedhur një sistem i caktuar mund të japë informacion të rëndësishëm mbi situatën.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së i kanë zhvilluar sistemet TRV në mënyra të ndryshme. Në disa raste, autoritetet e kanë zhvilluar vetë teknologjinë, shpeshherë në bashkëpunim me firma private ose publike. Në raste të tjera, autoritetet kanë blerë ose marrë me qira sisteme ekzistuese nga shitës privatë të specializuar të teknologjisë. Pavarësisht burimit, duhet të merret parasysh historiku dhe përvoja e ofruesit të teknologjisë apo zhvilluesit. Nëse ofruesi i teknologjisë ka pak përvojë me TRV-të apo nëse përvojat e kaluara kanë treguar mangësi serioze në teknologjinë e tij apo aplikimin e saj, atëherë ky mund të jetë shkak për shqetësim. Lidhjet mes shitësit të teknologjisë dhe ndonjë partie politike apo zyrtari publik, apo faktorë të tjerë që mund të hedhin dyshime mbi perceptimin e tij si furnizues neutral, mund të jenë gjithashtu tregues të një procesi prokurimi me mangësi.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që duhet marrë parasysh është transparenca e përgjithshme e procesit të përzgjedhjes. Kriteret e përdorura për përzgjedhjen e një lloji të caktuar sistemi duhet të jenë të përcaktuara qartësisht para përzgjedhjes dhe të vihen në dispozicion të publikut. Këtu përfshihen jo vetëm kriteret teknike, por edhe kriteret e blerjes dhe të prokurimit. MVZ-ja duhet të përpiqet të përcaktojë nëse ka qenë proces tenderimi i hapur dhe konkurrues, bazuar në kriteret të paracaktuara e të disponueshme publikisht. Nëse nuk është kështu, ose nëse ka tregues se kriteret janë “përshtatur” për një shitës të caktuar, MVZ-ja duhet ta marrë këtë parasysh.

Pyetje të mundshme:

- ➔ Kush e zhvilloi dhe e prodhoi TRV-në?
- ➔ Kush është pronar i TRV-së? Sa është kohëzgjatja e kontratës mes organit të administrimit të zgjedhjeve dhe ofruesit të teknologjisë? A përmban kontrata tarifa për sigurinë apo mirëmbajtjen, ose kosto për ruajtjen e të dhënave që përbëjnë kosto afatgjata? Kush është përgjegjës për trajtimin e incidenteve në ditën e zgjedhjeve, organi i administrimit të zgjedhjeve apo ofruesi i teknologjisë?
- ➔ Përveç përmbushjes së kërkesave teknike dhe ato të prokurimit, a ka ofruesi i teknologjisë përvojë të mëparshme me sistemet elektronike të përdorura në zgjedhje? Si është vlerësuar përvoja e mëparshme, pozitivisht apo negativisht?
- ➔ A ka ofruesi ose zhvilluesi i teknologjisë ndonjë lidhje me parti të caktuara politike, kandidatë, figura politike apo zyrtarë publikë? Nëse po, a kanë ngritur bashkëbiseduesit shqetësime për këto lidhje?
- ➔ Kur të gjitha hallkat dhe fazat e procesit shikohen si një e tërë, a ishte procesi transparent dhe a iu nënshtrua shqyrtimit publik?
- ➔ A ishte procesi i përzgjedhjes i hapur, në mënyrë që të gjithë ofruesit e teknologjisë të kishin mundësi të merrnin pjesë, apo duket që procesi është “përshtatur” për një ofrues të caktuar të teknologjisë?

4.2 Roli i Administratës Zgjedhore në Përdorimin e TRV-së

Analiza për të parë nëse organi i administrimit të zgjedhjeve ka kontroll të plotë mbi zbatimin dhe administrimin e sistemit TRV është një aspekt shumë i rëndësishëm për MVZ-në. Duke pasur parasysh që TRV-ja ndërlidhet me disa aspekte të procesit zgjedhor, të cilat përfshijnë jo vetëm votimin, por edhe regjistrimin e partive dhe të kandidatëve, nxjerrjen e rezultateve, regjistrimin e zgjedhësve dhe mirëmbajtjen e listave të zgjedhësve dhe të informacionit, administrata zgjedhore duhet ta shohë TRV-në si një pjesë përbërëse të procesit zgjedhor, dhe jo thjesht si një aspekt të veçuar që u duhet deleguar teknikëve apo institucioneve të tjera.

MVZ-ja duhet të evidentojë se cilat organe të administratës zgjedhore janë përgjegjëse për nxjerrjen e rregulloreve për TRV-në, për programimin dhe vënien në punë të sistemit, si dhe për sigurimin e mbikëqyrjes së integritetit zgjedhor.

Në disa administrata zgjedhore, të gjitha detyrat mund të jenë pjesë e një sistemi të vetëm hierarkie ku ka një autoritet parësor, si për shembull një komision qendror të zgjedhjeve. Në disa vende të tjera, këto detyra mund të ndahen në mënyrë të decentralizuar, ku një organ (për shembull, ministri) është përgjegjës për nxjerrjen e rregulloreve, autoritetet vendore janë përgjegjëse për vendosjen dhe funksionimin e sistemit dhe një organ i tretë është përgjegjës për të siguruar që TRV-ja të zbatohet në përputhje me ligjin. Ndonëse kjo strukturë mund të përkojë me atë që përdoret në zgjedhjet që bazohen në fletë votimi letër, mund të ketë dallime të rëndësishme mes tyre dhe kjo duhet vënë në pah kur përdoren sistemet TRV.

MVZ-ja duhet gjithashtu të evidentojë strukturat, si departamente apo njësi, brenda secilit organ të administratës zgjedhore që kanë përgjegjësi parësore për çështjet e TRV-së, si dhe objektin e përgjegjësive të tyre. Gjithashtu, është e dobishme të përcaktohet nëse këto struktura janë të dedikuara vetëm për TRV-në apo merren edhe me çështje të tjera si listat e zgjedhësve, prodhimin e materialeve për edukimin e zgjedhësve, apo administrimin e TI-së për organin e administratës zgjedhore. Nëse ato nuk janë struktura të dedikuara, ekziston mundësia që të mbingarkohen duke marrë edhe rolin shtesë për administrimin e TRV-së.

4.2.1 Ristrukturimi i Procesit të Votimit

Planifikimi i duhur është parakusht për zhvillimin me sukses të zgjedhjeve, në veçanti kur përdoret TRV-ja. Përveç specifikimeve teknike për vetë teknologjinë, administrata zgjedhore duhet të shqyrtojë mundësinë e ristrukturimit të procesit të votimit duke marrë parasysh në mënyrë të qartë përdorimin e TRV-së si një element thelbësor, sidomos kur ajo përdoret për herë të parë. Mund të duhet të bëhen ndryshime në procedurat për votimin e hershëm para ditës së zgjedhjeve, printimin e materialeve zgjedhore, vendosjen e dhomave të fshehta, identifikimin e zgjedhësve, si dhe për elemente të tjera. Nëse administrimi i procesit të votimit nuk rishikohet dhe nuk riformatohet, atëherë mund të ketë pasoja të papritura për procesin zgjedhor. Për shembull, një numër i pamjaftueshëm i pajisjeve TRV apo zgjedhës që vonohen më shumë se sa

mendohej për të votuar duke përdorur pajisjen, mund të shkaktojnë radhë të gjata. Bashkimi i qendrave të votimit me qëllim përdorimin e një numri të kufizuar pajisjesh për votimin elektronik, mund të krijojë probleme me listat e zgjedhësve apo të sjellë hutim të zgjedhësit për vendndodhjen e qendrave të votimit.

4.2.2 Kanale të Shumëfishta Votimi: Integrimi i Proceseve të Votimit Elektronik dhe me Letër

Procesi i votimit në tërësi mund të ndërlikohet më tej kur TRV-të përdoren paralelisht me sistemet e votimit me letër, siç ndodh shpesh. Prokurimi dhe shpërndarja e materialeve zgjedhore, administrimi i listave të zgjedhësve, udhëzimet për komisionerët e qendrës së votimit, trajnimi, edukimi i zgjedhësve dhe nxjerrja e rezultateve, të gjitha ndikohen në një farë mase nga përdorimi i metodave (ose “kanaleve”) të shumëfishta të votimit.

MVZ-së i duhet të kontrollojë se vënia në dispozicion e kanaleve të shumëfishta nuk i privon zgjedhësit nga e drejta e votës, nuk i lejon që të votojnë më shumë se një herë, ose nuk i detyron të përdorin një sistem elektronik kundër vullnetit të tyre. Kjo kërkon komunikim mes kanaleve. Për shembull, duhet të ekzistojë një sistem që e pengon zgjedhësin ta hedhë votën si me anë të internetit edhe me fletë votimi letër. Në sistemet ku votimi me fletë votimi letër ligjërisht anulon dhe zëvendëson votën e hedhur nëpërmjet internetit, MVZ-ja duhet të kontrollojë që anulimi i votave elektronike ose i votave elektronike të shumëfishta të bëhet si duhet dhe para numërimit të votave. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të tillë që përmbajtja e votës të mos lidhet me zgjedhësin. Nëse ky mekanizëm zbatohet ditën e zgjedhjeve, ai duhet të vlerësohet me kujdes nga vëzhguesit.

Për nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve në zgjedhjet që përdorin kanale të shumëfishta votimi, MVZ-ja duhet të evidentojë metodën e përdorur për transmetimin e rezultateve në sistemin e bazuar në letër dhe atë në TRV, dhe se si këto rezultate mblidhen. Nëse të dhënat nga TRV-ja dhe procesi i bazuar në letër transmetohen me metoda të ndryshme, atëherë është e nevojshme që të mblidhen të dhënat në një moment të caktuar.

Për të siguruar transparencë në nxjerrjen e rezultateve, është e rëndësishme që partitë politike, kandidatët dhe vëzhguesit të mundën të verifikojnë që rezultatet e qendrës së votimit janë reflektuar në mënyrë korrekte në mbledhjen e rezultateve që bëhet në nivele më të larta të administratës zgjedhore. Kjo kërkon që sistemi i nxjerrjes së rezultateve të ofrojë informacion të qartë, të hollësishëm, të gatshëm dhe të disponueshëm publikisht. Ndërlikimi i të pasurit sisteme të shumëfishta, apo ndonjë vonesë që lind prej tij në raportim, nuk duhet të përdoren si justifikim për mosdhënie informacioni të mjaftueshëm.

4.2.3 Mbikëqyrja

Pas evidentimit të strukturës për administrimin e përdorimit të TRV-së, MVZ-ja duhet të vëzhgojë se si bëhet në praktikë administrimi dhe mbikëqyrja e teknologjisë. Rolet dhe përgjegjësitë e secilit nivel të administratës zgjedhore duhet të jenë të qarta për

komisionerët zgjedhorë përkatës, dhe MVZ-ja duhet të verifikojë që secili nivel i merr në kohë materialet, udhëzimet, trajnimin dhe burimet e nevojshme financiare. MVZ-ja duhet të verifikojë gjithashtu deri në ç'masë ekzistojnë kapacitetet e brendshme për të administruar TRV-në, dhe/ose që ekzistojnë mekanizma efikasë mbikëqyrës që sigurojnë që çdo organ i administratës zgjedhore i përmbush siç duhet përgjegjësitë e veta.

Po ashtu, duhet vlerësuar se sa e kuptojnë komisionerët zgjedhorë teknologjinë e përdorur dhe rreziqet e mundshme. Nëse zyrtarët besojnë se çështjet e TRV-së janë së pari të natyrës teknike dhe duhet, pra, t'iu lihen ekspertëve teknikë, ata mund të jenë më pak të përgatitur për ta mbikëqyrur siç duhet, apo për të ndërmarrë veprime korrigjuese në rast se lindin probleme. MVZ-ja duhet gjithashtu të përpiqet të evidentojë çdo shqetësim që zyrtarët zgjedhorë kanë për TRV-në apo administrimin e saj.

4.2.4 Administrimi i Rrezikut

Administrata zgjedhore mund të përgatitet t'i paraprijë problemet e papritura apo defektet në sistemin TRV të shkaktuara nga faktorë teknologjikë apo njerëzorë. MVZ-ja duhet të vlerësojë se çfarë planesh emergjence ka përgatitur administrata zgjedhore në rast mosfunksionimi të mundshëm të sistemit ditën e zgjedhjeve. Këtu përfshihet: të siguruarit që të dhënat elektronike do të ruhen dhe rikuperohen në rast mosfunksionimi për arsye fizike, si për shembull për mungesë të energjisë elektrike; evidentimi se kush është përgjegjës për zgjidhjen e problemit dhe koha maksimale e reagimit; shpërndarja e një manuali për ta ndihmuar personelin e qendrës së votimit në trajtimin e problemeve; si dhe dhënia e mundësisë zgjedhësve që ta hedhin votën e tyre edhe nëse sistemi nuk mund të vihet përsëri në funksion. Periudha e votimit për votimin me anë të internetit mund të ndalet disa ditë para ditës së zgjedhjeve për t'u dhënë mundësinë zgjedhësve për të votuar në letër, nëse gjatë asaj periudhe zbulohen probleme të mëdha.

4.2.5 Roli i Ofruesve të Teknologjisë

Është e rëndësishme që MVZ-ja të kuptojë marrëdhëniet mes administratës zgjedhore dhe ofruesve të teknologjisë apo kompanive të tjera të jashtme. Ndërsa ofruesit e teknologjisë shpesh luajnë rol në mirëmbajtjen dhe përditësimin e TRV-së falë njohurive të tyre teknike, komisionerët zgjedhorë janë përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve dhe duhet të ushtrojnë autoritet, të mbikëqyrin dhe t'u kërkojnë llogari të plotë teknikëve. Në rast varësie të konsiderueshme të ofruesit e teknologjisë, qoftë përkohësisht apo për shkak të të drejtave të pronësisë intelektuale për produktet apo *software*-t e përdorura, vëzhguesit duhet të hetojnë më tej për të parë nëse kjo varësi e ka cenuar në mënyrë thelbësore aftësinë e administratës zgjedhore për ta kontrolluar si duhet zhvillimin e procesit të votimit. Çdo tregues se, janë ofruesit e teknologjisë dhe jo komisionerët zgjedhorë, ata që kontrollojnë procesin, përbën shkak për shqetësim, sepse kjo mund të komprometojë paanshmërinë dhe pavarësinë e administrimit të zgjedhjeve.

MVZ-ja duhet të shohë nëse janë lidhur kontrata me shitës të teknologjisë dhe furnitorë për pjesë thelbësore të procesit zgjedhor, si dhe duhet të shohë detyrimet dhe përgjegjësitë e ofruesve të teknologjisë. Ofruesi i teknologjisë duhet të ketë përgjegjësi në vazhdimësi për mirëmbajtjen dhe shërbimet ndaj sistemit. Kjo përfshin trajtimin e gabimeve në projektim, mosfunksionime dhe probleme të tjera me TRV-në. Duhet të jetë e qartë që roli i shitësve dhe furnitorëve të teknologjisë është që të mbështesin zhvillimin e zgjedhjeve të vërteta dhe demokratike. Ata nuk duhet të marrin rolin ose funksione të rëndësishme të administratës zgjedhore, e cila duhet të mbetet në kontroll të plotë të procesit zgjedhor.

4.2.6 Trajnimi i Komisionerëve Zgjedhorë

Si në rastin e sistemeve zgjedhore që bazohen në votimin me letër, trajnimi i administratës zgjedhore është me rëndësi jetike për përdorimin e TRV-së në përputhje me parimet ligjore dhe demokratike. Duke marrë parasysh ndërlikimet dhe sfidat e përdorimit të TRV-së, ka të ngjarë të jetë e nevojshme të ofrohet trajnim i zgjeruar për komisionerët zgjedhorë. Komisionerët duhet të kenë njohuri bazë se si funksionon TRV-ja, në mënyrë që të reagojnë në rast të problemeve të vogla dhe të mëdha teknike, të shpjegojnë teknologjinë dhe t'u përgjigjen pyetjeve për përdorimin e saj, të informojnë zgjedhësit dhe e fundit, por jo më e pak e rëndësishme, të ndihmojnë për ndërtimin e besimit të tyre në sistem.

MVZ-ja duhet të vlerësojë efektshmërinë e përgjithshme të trajnimit, për sa është e mundur. Planet e trajnimit duhet të pasqyrojnë afatet kohore dhe buxhetin e nevojshëm për trajnim të zgjeruar, dhe metodologjia duhet të përqëndrohet jo vetëm te kërkesat ligjore dhe procedurat, por edhe se çfarë duhet bërë në rast problemesh. MVZ-ja duhet të përpiqet të vëzhgojë trajnimin e komisionerëve të qendrës së votimit dhe të analizojë materialet e trajnimit. Kjo mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë procesin e votimit elektronik dhe mund të jetë veçanërisht e vlefshme për udhëzimin e vëzhguesve afatshkurtër. Vëzhgimi i sesioneve të trajnimit dhe analiza e materialeve të trajnimit mund të zbulojnë edhe mangësi në trajnim, që mund të çojnë në probleme të mundshme ditën e zgjedhjeve, për të cilat vëzhguesit duhet të jenë vigjilentë.

4.2.7 Edukimi i Zgjedhësve

Zgjedhësit duhet të jenë përgjithësisht në gjendje të bëjnë zgjedhjet e tyre dhe ta hedhin votën pa i ndihmuar kush. Për këtë arsye, edukimi i zgjedhësve është shumë i rëndësishëm për zbatimin dhe përdorimin e TRV-së. MVZ-ja duhet të vlerësojë shkallën në të cilën informacioni mbi sistemin është vënë në dispozicion të zgjedhësve dhe plotësinë e këtij informacioni, sidomos kur zbatohet një sistem i ri apo kur janë bërë ndryshime domethënëse në sistemin ekzistues. Gjithashtu, edukimi i zgjedhësve duhet të ofrojë një panoramë të balancuar të përparësive dhe sfidave që paraqet votimi me mjete elektronike ose, në rastet kur të dy kanalet e votimit janë të disponueshëm, me fletë votimi letër. Duhet kushtuar vëmendje e posaçme nëse materialet e edukimit të zgjedhësve janë të disponueshme edhe në gjuhët e pakicave.

Informacioni i hollësishëm për procedurat e votimit duhet të jetë i disponueshëm para ditës së zgjedhjeve dhe në forma të ndryshme të medias. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm edhe në qendrat e votimit ditën e zgjedhjeve (nëse është e përshtatshme). Përveç informimit se si të përdorin TRV-në, zgjedhësit duhet të informohen edhe se si funksionon sistemi TRV në përgjithësi, si sigurohet fshehtësia e votës dhe si mund të verifikohen rezultatet në mënyrë kuptimplotë. Meqë vetë zgjedhësit janë shpesh të parët që do të vënë re ndonjë problem në pajisje të caktuara, materialet e edukimit të zgjedhësve duhet të kenë informacion se si të merren me probleme të mundshme (normalisht, veprimi i duhur është të informojnë komisionerët e qendrës së votimit).

Në kushte ideale, dita e zgjedhjeve nuk duhet të jetë rasti i parë kur një zgjedhës përdor sistemin elektronik të votimit. Përveç qasjes graduale për futjen e TRV-së, testimi praktik personal nga publiku para ditës së zgjedhjeve apo zgjedhjet provë, mund të jenë metoda të efektshme për edukimin e publikut.

Pyetje të mundshme:

- Cilat hapa të procesit zgjedhor mbështeten me mjete elektronike? Përveç teknologjive të reja të futura në procesin e votimit dhe numërimit, çfarë sistemesh TIK janë përdorur për të administruar procesin zgjedhor? Në ç'mënyra janë standardizuar dhe testuar ndërfaqet midis këtyre sistemeve?
- Nëse përdoren kanale të shumfishta votimi, a i ka marrë parasysh administrata zgjedhore kërkesat e ndryshme të këtyre kanaleve për shpërndarjen e materialeve, për udhëzimet për komisionerët e qendrës së votimit dhe afatet zgjedhore?
- Si administrohet lista e zgjedhësve? A ekzistojnë masa për të mos i lejuar zgjedhësit të votojnë më shumë se një herë duke përdorur kanale të ndryshme votimi?
- Si do të llogariten rezultatet e votave të hedhura në letër dhe votave elektronike? A kanë qasje partitë, kandidatët dhe vëzhguesit të rezultatet në çdo fazë të procesit të numërimit dhe përlllogaritjes? A bëhet e detajuar dhe e plotë shpallja e rezultateve?
- A është përdorimi i TRV-së në përpjestim me vlerën e shtuar për procesin në tërësi? A është parë kjo nëpërmjet një studimi fizibiliteti para vendimmarrjes?
- Çfarë masash janë marrë për të siguruar fshehtësinë e votës?
- Si e trajton TRV-ja situatën kur një kandidat çregjistrohet apo tërhiqet nga gara?
- Në rastet e votimit me anë të internetit, si mund të marrin pjesë zgjedhësit jashtë vendit (përfshirë regjistrimin, marrjen e kredencialeve të votimit, etj.)?
- Si është strukturuar administrimi i TRV-së brenda administratës zgjedhore? A janë përkufizuar qartë rolet dhe përgjegjësitë? A ka departamente dhe njësi në administratën zgjedhore që i kushtohen TRV-së? Si funksionon në praktikë administrimi i TRV-së?

<p>➤ Sa e kuptojnë komisionerët zgjedhorë TRV-në, si në praktikë edhe në përgjithësi? Sa të përfshirë janë ata në mbikëqyrjen e përdorimit të TRV-së? A kanë ndonjë shqetësim rreth përdorimit të TRV-së në zgjedhje?</p>
<p>➤ Sa i hollësishtëm është planifikimi i administratës zgjedhore për futjen dhe përdorimin e TRV-së? A i kanë marrë komisionerët zgjedhorë informacionet, materialet dhe burimet financiare mjaftueshëm herët për ta administruar siç duhet sistemin? A janë hartuar plane rezervë në rast mosfunksionimi të mundshëm të teknologjisë apo problemesh me instalimin dhe përdorimin e TRV-së?</p>
<p>➤ Sa të përfshirë janë ofruesit e teknologjisë (apo organizma të tjerë të jashtëm) në administrimin dhe funksionimin e TRV-së? A e komprometon kjo përfshirje paanshmërinë dhe pavarësinë e administratës zgjedhore? Çfarë dispozitash ka për llogaridhënien nga ofruesit e teknologjisë?</p>
<p>➤ Çfarë dispozitash ligjore apo kontraktuale ka për mirëmbajtjen dhe përditësimin e TRV-së? Cila është marrëdhënia kontraktuale mes shitësve të teknologjisë, furnitorëve të shërbimit dhe administratës zgjedhore?</p>
<p>➤ A është i efektshëm trajnimi për të siguruar që komisionerët zgjedhorë janë në gjendje t'i administrojnë procedurat e votimit? A e trajton trajnimi mbi funksionimin e TRV-së ndërveprimin e saj me pjesë të tjera të procesit zgjedhor?</p>
<p>➤ Si po edukohen zgjedhësit mbi TRV-në? A e mbulojnë materialet edukuese çdo hap të procesit të votimit? A ka mundësi publiku ta testojë praktikisht teknologjinë? Nëse po, sa duket se e kuptojnë zgjedhësit procesin e votimit? A është vërejtur ndonjë problem?</p>
<p>➤ Në ç'masë është shfaqur në media materiali për edukimin e zgjedhësve? A është ai i disponueshëm nga burime të shumëfishta dhe në të gjithë vendin?</p>
<p>➤ Cili është niveli i njohurive kompjuterike dhe të internetit në vend?</p>
<p>➤ Cili është niveli i depërtimit të internetit në vend?</p>

4.3 Siguria dhe Fshehtësia e Votës dhe Integriteti i Rezultateve

Ruajtja e fshehtësisë së votës dhe sigurimi i integritetit të rezultateve në mënyrë të verifikueshme duhet të jenë pjesë themelore e sistemit TRV. Këto parime kyçe mund të ndikohen negativisht nga mangësitë teknologjike apo të projektimit. Integriteti i procesit dëmtohet kur sistemi nuk e regjistron ose nuk e numëron siç duhet përzgjedhjen e bërë nga votuesi. Kjo mund të ndodhë, për shembull, nëse një pajisje që funksionon me prekje ekrani nuk është kalibruar siç duhet dhe regjistron si përzgjedhje kandidatin A, kur zgjedhësi ka shtypur butonin për kandidatin B, ose nëse pajisjet e skanimit të fletëve të votimit nuk e regjistrojnë si duhet përzgjedhjen e bërë nga votuesi. Problemet me *software*-in që shkaktojnë gabime në numërimin apo nxjerrjen e rezultateve për ndonjë kandidat dëmtojnë po ashtu integritetin e rezultateve.

Megjithatë, edhe kur arkitektura bazë e sistemit është projektuar siç duhet për të ruajtur fshehtësinë dhe integritetin e rezultatit, TRV-ja mundet përsëri të rrezikohet

nga kërcënime të mundshme ndaj sigurisë. Këto kërcënime mund të vijnë nga jashtë sistemit, si për shembull, *hack*-imi, ose nga brenda sistemit, si për shembull manipulimi nga komisionerët zgjedhorë, shitësit e teknologjisë apo teknikë të tjerë. Ndonëse kërcënimet për sigurinë ekzistojnë edhe në proceset tradicionale të votimit me letër, një dallim kyç është se sulmet mbi TRV-në mund të kërkojnë njohuri dhe aftësi teknologjike dhe burime domethënëse për t'u zbuluar apo vëzhguar, që nuk i zotëron një zgjedhës tipik. MVZ-ja duhet të verifikojë se TRV-të dhe administrimi i tyre përfshijnë masa të forta sigurie kundër kërcënimeve të mundshme dhe se kuadri ligjor i parashikon masat që duhet të merren kundër sulmeve të tilla.

Në kontekstin e TRV-së, *hack*-imi është hyrja e paligjshme në sistem nga cilido person jashtë administrimit të procesit. Për sistemin e votimit me regjistrim elektronik të drejtpërdrejtë (DRE) dhe atë të skanimit të fletës së votimit duhet të ketë masa mbrojtëse me qëllim parandalimin e ndërhyrjes fizike te pajisjet. MVZ-ja duhet të kontrollojë, për shembull, që portat USB dhe lidhje të tjera me jashtë nuk janë të aksesueshme lehtësisht. Gjithashtu, magazinimi dhe transportimi i pajisjeve TRV duhet të bëhet në mënyrë të sigurt sipas protokolleve të përcaktuara, duhet të vëzhgohet qasja në këto pajisje kur nuk janë në përdorim, dhe duhet të mbahen procesverbalet e duhura. Pajisjet mund të *hack*-ohen edhe kur janë të lidhura me internetin.

MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse pajisjet TRV kanë kapacitet për qasje në distancë dhe, nëse po, ç'masa janë marrë për të parandaluar qasjen në mënyrë të paligjshme.

Për TRV-të që mbështeten në përdorimin e internetit për transmetimin e të dhënave, mbrojtja fizike dhe funksionimi i sistemeve qendrore të informacionit janë me rëndësi të veçantë për të shmangur mosfunksionime të rënda, të tilla si humbja qoftë edhe e një numri të vogël votash apo rënia e sistemit. Në kushte ideale, kjo realizohet përmes krijimit të një sistemi paralel me sistemin kryesor, ku secili sistem gjendet në një qendër të veçantë përpunimi të dhënash me hyrje të kontrolluar, fizikisht i ndarë nga çdo sistem tjetër informacioni që operohet në të njëjtën qendër.

Përveç ndërhyrjes së paautorizuar fizike, sulmimi i sistemit nga jashtë përbën një kërcënim veçanërisht serioz. MVZ-ja duhet të verifikojë se si e parandalon apo zbulon sistemi qasjen e paligjshme dhe duhet të vlerësojë gjasat e efektshmërisë së këtyre masave. Në sisteme votimi me anë të internetit, MVZ-ja duhet të ketë parasysh mënyrën se si sistemi verifikon identitetin e zgjedhësit dhe çfarë kërcënimesh potenciale mund të krijohen nga kjo. Më tej, duhet të merret parasysh mbrojtja e përgjithshme e sistemeve të informacionit nga qasja e paautorizuar nga jashtë, nëpërmjet përdorimit të linjave të dedikuara të transmetimit, *firewall*-eve, dhe koncepteve të përgjithshme të sigurisë.

Manipulimi i të dhënave nga komisionerët zgjedhorë, shitësit e teknologjisë apo teknikët përbën një tjetër kërcënim të mundshëm në rastin e TRV-ve. MVZ-ja duhet të kontrollojë cilat janë procedurat ekzistuese për të kufizuar mundësinë e çdo individi që të komprometojë sistemin. Për shembull, duhet të ketë një ndarje detyrash brenda administratës zgjedhore për të minimizuar mundësinë për manipulim të brendshëm. Qasja fizike dhe elektronike në sistemin TRV duhet të rregullohet rreptësisht nëpërmjet

procedurave të shkruara. Çdo qasje e tillë duhet të jetë e vëzhgueshme dhe e kufizuar, në mënyrë të tillë që komisionerët zgjedhorë ose shitësit e teknologjisë të kenë qasje vetëm në komponentët që janë brenda përgjegjësisë të tyre. MVZ-ja duhet, gjithashtu, të kontrollojë nëse operacionet sensitive të sistemit kryhen nga më shumë se një person dhe nëse mbahet procesverbal me shkrim për të gjitha operacionet e kryera. Procedurat e sigurisë duhet të jenë të efektshme dhe të zbatohen plotësisht. Vetëm masat mbrojtëse që ofrojnë garanci se mund të verifikohen, si për shembull vula sigurie rezistente ndaj ndërhyrjes së paautorizuar me numra unik, datim i sigurt i dokumenteve, dhe mekanizma të tjera të ngjashëm që vërtetojnë autenticitetin e procedurave, ofrojnë siguri ndaj manipulimeve.

Ndërkohë që këto masa sigurie janë të domosdoshme, ato mund të mos jenë të mjaftueshme për të garantuar integritetin e zgjedhjeve apo për të ruajtur besimin e publikut. Për të garantuar plotësisht integritetin e votës nevojiten masa verifikimi të përshtatshme, veçanërisht auditimet e votave në letër të cilat janë verifikuar më parë nga zgjedhësi.

Votimi me anë të internetit ka kërcënime të tjera. Sulmet e shpërndara për mohimin e shërbimit (dDoS)²⁵ dhe sulme të tjera të ngjashme mundet që, potencialisht, të ndërpresin punën e serverit për votimin me anë të internetit, apo të bëjnë që të jetë e pamundur qasja në sistem nga zgjedhësit. Këto sulme janë të zbulueshme dhe mund të bëjnë të domosdoshme shtyrjen e zgjedhjeve. Prandaj, MVZ-të duhet të kontrollojnë se cilat janë masat ekzistuese të sigurisë për t'i mbrojtur sistemet nga këto sulme.

Në votimin me anë të internetit, edhe vetë zgjedhësit mund të jenë shënjestra të kërcënimeve të ndryshme kompjuterike. Kjo mund të përfshijë *software* dëmtuese, të projektuara për të ndryshuar përzgjedhjen e votuesit apo për të identifikuar zgjedhësin, të instaluar në kompjuterin e zgjedhësit pa dijeninë e tij, ose faqe interneti të rreme të projektuara për ta bërë zgjedhësin që në mënyrë të gabuar të besojë se ai apo ajo e ka hedhur votën. Ndonëse këto kërcënime janë vështirë të trajtohen për shkak të natyrës së votimit në distancë, MVZ-ja duhet, gjithsesi, të kontrollojë se çfarë masash janë marrë për t'u ruajtur prej tyre.

Gjithashtu, procedurat e votimit në distancë - me anë të internetit, por edhe në letër me anë të postës - lejojnë mundësinë që zgjedhësin ta frikësojnë, t'i ushtrojnë presion ose t'i blejnë votën, sepse zgjedhësi nuk mund të mbrohet në të njëjtën masë nga ndikime të parregullta si në një qendër votimi në prani të komisionit zgjedhor. MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse janë marrë masa mbrojtëse që potencialisht mund të reduktojnë shkallën e këtyre ndikimeve. Në rastin e votimit me anë të internetit, disa sisteme krijojnë mundësinë që vota të hidhet më shumë se një herë, apo që të anulohet vota elektronike me një votë në letër para ditës së zgjedhjeve, përfshirë në një qendër votimi.

²⁵ Sulmi dDoS është sulm mbi një sistem ose rrjet kompjuterik, në të cilin një kërkesë e thjeshtë e automatizuar përsëritet me shpeshtësi shumë të madhe, me synim mbingarkimin e linjave të lidhjes së sistemit ose të kapaciteteve të përlogaritjeve të kompjuterizuara.

Pyetje të mundshme:

- A përmban sistemi TRV ndonjë element projektimi që mund të lejojë bërjen e lidhjes mes zgjedhësit dhe votës së tij apo të saj, ose që mund të lejojë që një zgjedhës të frikësohet ose të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë kur voton?
- Çfarë masash mbrojtëse janë marrë për të parandaluar *hack*-imin? Nëse TRV-të përdoren në qendrat e votimit, a janë transportuar dhe magazinuar në mënyrë të sigurt? A ka protokoll për trajtimin e pajisjeve? A ka dokumentacion se kush ka pasur qasje në pajisje që prej përdorimit të fundit? Kur u bë përditësimi i fundit i *software*-it dhe nga kush?
- A kanë pajisjet mundësi për qasje të menjëhershme, të tilla si porta USB? Nëse po, si janë siguruar ato? Çfarë kapaciteti kanë pajisjet për pranimin e të dhënave nga burime të jashtme? A mund të aksesohen me anë të internetit, ose përmes valëve *wireless*? Nëse po, çfarë masash mbrojtëse janë marrë për të siguruar integritetin e të dhënave?
- Nëse TRV-ja mbështetet në transmetimin e të dhënave nëpërmjet internetit, çfarë masash janë marrë për të parandaluar dhe zbuluar *hack*-imin nga jashtë, që synon të marrë ose të ndryshojë të dhënat?
- Çfarë masash janë marrë për të parandaluar manipulimin e paligjshëm të sistemit nga brenda? A ka gjasa që këto të jenë të efektshme?
- Për sistemet e votimit në distancë me anë të internetit, çfarë masash janë marrë për identifikimin, pengimin dhe ndëshkimin e sulmeve *DDoS* dhe sulmeve të tjera të ngjashme? A është marrë ndonjë masë për të trajtuar sigurinë e kompjuterëve të jashtëm të përdorur nga zgjedhësit për të hedhur votën e tyre? Si i identifikon sistemi zgjedhësit? Si sigurohet sistemi që zgjedhësit të mos votojnë më shumë se një herë?
- A janë marrë masa për t'u dhënë zgjedhësve mundësinë që të shmangin ndikimin e parregullt, si për shembull mundësia për ta rihedhur votën elektronikisht apo anulimi i një vote elektronike duke hedhur votë në letër? A janë të efektshme këto masa?

4.4 Lehtësia në Përdorim, Dizajni i Fletës së Votimit, Qasja e Zgjedhësit dhe Besueshmëria

Zgjedhjet duhet t'u ofrojnë votuesve përzgjedhje të qarta dhe duhet të maksimizojnë ushtrimin universal të të drejtës së votës, dhe në të njejtën kohë të ofrojnë garanci thelbësore për mbrojtjen e integritetit të zgjedhjeve. Ndaj, MVZ-ja duhet të shohë me kujdes se sa të kuptueshëm dhe të lehtë për t'u përdorur janë sistemet TRV për zgjedhësit. Aspektet kryesore që duhet të vlerësohen në këtë drejtim janë lehtësia e përdorimit të teknologjisë nga zgjedhësit, dizajni i fletës së votimit, aftësia e TRV-së për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë zgjedhësve dhe qëndrueshmëria e sistemit në rast mosfunksionimi apo në rast gabimesh nga zgjedhësit. Për të vlerësuar këto aspekte, MVZ-ja duhet të marrë pjesë si në testime publike, ashtu edhe në testime të mbyllura

të zhvilluara para zgjedhjeve, të analizojë materialet për edukimin e zgjedhësve, dhe të intervistojë aktorët kryesorë në këtë fushë për të kuptuar se cilat janë përpjekjet e bëra në këtë drejtim.

4.4.1 Lehtësia në Përdorim

Sistemet TRV duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të kuptueshme nga ana e zgjedhësve dhe të jenë relativisht të thjeshta për t'u përdorur. Lehtësia në përdorimin e TRV-së është përgjithësisht e lidhur me nivelin e përgjithshëm të njohurive kompjuterike në një vend të caktuar, me shtrirjen e përpjekjeve për edukimin e zgjedhësve, dhe me mundësinë për testimin publik të pajisjeve para zgjedhjeve. Gjithashtu, janë edhe një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me vetë pajisjet TRV që duhen marrë parasysh.

Konceptimi fizik i TRV-ve duhet të lehtësojë procesin e votimit. Ai nuk duhet t'i mundësojë zgjedhësit ta fikin pajisjen apo të bëjnë ndonjë veprim që do t'i pengonte të hidhnin votën. Duhet të merren parasysh përmasat e ekranit, drita dhe lexueshmëria e informacionit në ekran. Nëse përdoret ekran me prekje, duhet marrë parasysh sa lehtë mund të bëhet përzgjedhja, si dhe çdo mbindjeshmëri e mundshme e sistemit që mund të çojë në regjistrimin e përzgjedhjeve të gabuara.

Një aspekt po aq i rëndësishëm sa konceptimi fizik, që MVZ-ja duhet ta vrojtojë, është mënyra se si zgjedhësit ndërveprojnë me sistemet TRV. Zgjedhësit duhet të marrin informacion dhe përgjigje të qarta nga sistemi kur ndërveprojnë me të. Zgjedhësit duhet të informohen në momentin kur vota elektronike është gati për t'u hedhur dhe, më pas, duhet të marrin konfirmim se vota u hodh dhe procesi i votimit përfundoi. MVZ-ja duhet të kontrollojë që TRV-ja i paraqet qartësisht zgjedhësit, para hedhjes së votës, se çfarë përzgjedhje ka bërë, në mënyrë që të ketë mundësi të korrigojë gabime të mundshme. Nëse regjistrimi apo transmetimi i votës merr kohë, TRV-ja duhet ta informojë zgjedhësin sipas rastit, në mënyrë që ai ose ajo të mos i japë fund procesit pa dashje.

MVZ-ja duhet të kontrollojë se si e trajton TRV-ja nënvotimin e paqëllimshëm pra, kur një zgjedhës nuk bën një përzgjedhje në një garë të caktuar apo bën më pak zgjedhje se sa numri i lejuar i alternativave. Në mënyrë ideale, sistemi e njofton zgjedhësin në rast nënvotimi dhe i jep mundësinë të ndryshojë përzgjedhjen e mëparshme. Është e mundur që zgjedhësi me qëllim vendos të mos votojë në një garë të caktuar. Në disa sisteme parashikohet në mënyrë të qartë mundësia e "votës bosh". Në rast të kundërt, refuzimi për të bërë përzgjedhje për një garë të caktuar nuk duhet ta pengojë zgjedhësin të përfundojë procesin e votimit. Në çdo rast, sistemi TRV duhet ta informojë zgjedhësin në rast mbivotimi, domethënë, kur bën më shumë përzgjedhje nga sa lejohet, çka e bën votën të pavlefshme, dhe duhet ta bëjë këtë në mënyrë që zgjedhësi ta kuptojë dhe ta korrigojë gabimin. MVZ-ja mund gjithashtu të vlerësojë nëse ligji parashikon dispozita për votat elektronike të bëra qëllimisht të pavlefshme dhe të evidentojë arsyet për këto parashikime.

Lehtësia në përdorimin e TRV-së ka të bëjë edhe me sasinë e kohës që i duhet një zgjedhësi për të përfunduar procesin, si dhe me numrin e përgjithshëm të zgjedhësve në qendrën e votimit. Duhet të jetë një numër i mjaftueshëm pajisjesh në dispozicion, në mënyrë që zgjedhësit të mos përballen me kohë të tepruara pritjeje.

Diçka që vërehet relativisht shpesh, veçanërisht kur TRV-të futen për herë të parë, është se disa zgjedhës e përmbyllin procesin para se ta hedhin votën elektronike në mënyrë përfundimtare. Kjo mund të ndodhë në mënyrë të pavullnetshme, sepse zgjedhësi gabimisht beson se vota është hedhur, ose në mënyrë të vullnetshme, shpesh sepse zgjedhësi nuk e kupton sistemin dhe ngurron të kërkojë ndihmë. MVZ-ja duhet të kontrollojë se çfarë ndodh në këto raste: nëse pajisja e tregon si duhet përfundimin e procesit të votimit, rikthehet në gjendjen fillestare pas një kohe të caktuar, ose një komisioner zgjedhor duhet të ndërhyjë. Në rast se kërkohet ndërhyrja e një komisioneri zgjedhor, rregullat duhet të jenë të përkufizuara qartë që më parë, përfshirë mënyrën se si përzgjidhet komisioneri që do të ndërhyjë. MVZ-ja mund të përpiqet të evidentojë se sa shpesh ndodh ndërprerja e parakohshme e procesit të votimit gjatë zgjedhjeve, megjithëse këto të dhëna mund të mos jenë të ditura për komisionerët zgjedhorë.

4.4.2 Dizajni i Fletës së Votimit

Ashtu si në rastin e fletëve të votimit letër, dizajni i fletës ka shpesh rëndësi kyçe në TRV, dhe problemet me dizajnin mund të shkaktojnë hutim të zgjedhësit ose anshmëri në favor të partive apo kandidatëve të caktuar. Dizajni i fletës së votimit varet pjesërisht nga regjistrimi i kandidatëve, i cili mund të përfundojë vetëm pak kohë para zgjedhjeve. Pasi administrata zgjedhore të ketë përcaktuar formatin e fletës elektronike së votimit, MVZ-ja duhet të vlerësojë nëse zgjedhësit përballen me ndonjë vështirësi në votim për shkak të formatit të fletës.

Në përgjithësi, të njëjtat parime që zbatohen për dizajnin e fletës së votimit letër gjejnë zbatim edhe për dizajnin e fletës elektronike të votimit. MVZ-ja duhet të vrojtojë nëse kandidatët apo partitë paraqiten në mënyrë të barabartë në fletë votimi dhe nëse është pasqyruar në të i gjithë informacioni që kërkohet nga ligji. Të gjithë kandidatëve apo partive që garojnë në zgjedhje duhet t'u jepet hapësirë e barabartë në fletën elektronike të votimit dhe duhet të jetë e mundur të shihen të gjitha alternativat për zgjedhje në të njëjtën kohë para se të hidhet vota. Fleta që e tejkalon përmasën e ekranit, pra që kërkon që zgjedhësi të shtypë butonin për të kaluar më poshtë apo të këmbejë ekran për të parë të gjithë gamën e zgjedhjeve, mund ta hutojë zgjedhësin dhe të krijojë anshmëri në favor të garuesve që shfaqen të parët.

4.4.3 Qasja nga Zgjedhësi

Një nga përparësitë e TRV-ve është se ato mund të rrisin qasjen, sidomos për zgjedhësit me nevoja të veçanta. Për aq sa është e mundur, sistemi duhet të projektohet në mënyrë që t'i lejojë zgjedhësit me aftësi të kufizuara ta hedhin votën pa pasur nevojë për ndihmë. Duhet shqyrtuar edhe çështja nëse zgjedhësi mund ta përdorë TRV-në në

një gjuhë të pakicave. Në rastet kur është e mundur të votohet në një gjuhë të pakicave, MVZ-ja duhet të verifikojë që fleta e votimit në gjuhën e pakicës përmban të njëjtin informacion dhe ka të njëjtin format si fleta e votimit në gjuhën e popullsisë shumicë.

Çdo modalitet i posaçëm, si për shembull fletë votimi audio për personat me aftësi të kufizuara shikimi apo përdorimi i fletës së votimit në gjuhën e një pakice, nuk duhet të mundësojnë shkeljen e fshehtësisë së votës. Kjo do të thotë që përmbajtja e votës duhet të regjistrohet elektronikisht, pavarësisht nga metoda e përdorur për të “shënuar” fletën elektronike të votimit.

4.4.4 Besueshmëria

Pajisjet TRV duhet të jenë në gjendje të funksionojnë gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit të votimit. Megjithëse mund të jetë i pritshëm një marzh mosfunksionimi, MVZ-ja duhet të vëzhgojë nëse ka situata në të cilat mosfunksionimet për kohë të zgjatura, mungesa e energjisë elektrike, koha tepër e gjatë për montimin dhe instalimin, apo probleme të tjera teknike të ngjashme i pengojnë zgjedhësit të hedhin votën, i shkurajojnë, ose bëjnë që votat tashmë të hedhura të humbasin.

Për këtë arsye, MVZ-ja duhet të vrojtojë se si mbrohet pajisja e votimit nga keqfunksionime të parashikueshme, nëse problemet e thjeshta mund të riparohen lehtësisht nga komisionerët zgjedhorë, dhe nëse komisionerët janë trajnuar siç duhet për t'u marrë me problemet që mund të dalin.

Për votimin me anë të internetit, ku mosfunksionimi i serverit apo raste të tjera mosdisponueshmërie të serverit mund të pengojnë shumë zgjedhës që të hedhin votën e tyre, MVZ-ja duhet të gjejë se çfarë masash janë marrë për të siguruar që sistemi të jetë i disponueshëm dhe i përdorshëm në këto raste, përfshirë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

Në rastet kur përdoren teknologjitë për votim elektronik, organet e administratës zgjedhore shpesh përdorin sisteme informacioni për të administruar procesin. MVZ-ja duhet të përcaktojë se çfarë lloj sistemesh përdoren dhe për çfarë qëllimi. Një çështje që mund të ketë ndikim negativ mbi funksionimin e proceseve të votimit elektronik është integrimi i sistemeve të shumëfishta të informacionit. Mund të lindin probleme nëse dy sisteme të ndryshme informacioni nuk arrijnë të “shkëmbejnë” me njëri-tjetrin. Për shembull, nëse të dhënat që transferohen nga një *software* për administrimin e zgjedhjeve (ku administrohen të dhënat e kandidatëve dhe përpilohen fletët e votimit) nuk lexohen dot në mënyrë korrekte nga sistemi TRV, fleta elektronike e votimit mund të dalë me gabime.

Në çdo rast, çështjet e TRV-ve trajtohen më mirë herët në kohë nëpërmjet testeve gjithëpërfshirëse (shih pjesën për Testimet më poshtë).

Pyetje të mundshme:

- Sa të lehta janë TRV-të në përgjithësi për përdoruesin? Sa i lehtë për t'u përdorur është sistemi dhe sa e lehtë është për zgjedhësit të mësojnë si ta përdorin sistemin? Nëse janë kryer testime për përdorimin, cilat ishin problemet kryesore që u konstatuan dhe si u trajtuan ato?
- A ndikon konceptimi fizik i TRV-së pozitivisht në votim? Nëse TRV-të përdoren në qendrat e votimit, a është vendosur aty një numër i mjaftueshëm pajisjesh, duke pasur parasysh numrin e zgjedhësve dhe kohëzgjatjen e pritshme të votimit për çdo zgjedhës?
- A jep TRV-ja informacion të qartë dhe udhëzime gjatë ndërveprimit të zgjedhësit me sistemin? A i tregon votuesit se cilën alternativë ka zgjedhur dhe a i jep mundësinë të bëjë ndryshime? A tregon kur është vota gati për t'u hedhur dhe a konfirmon që ajo u hodh?
- Si i trajton TRV-ja rastet e nënvotimit, mbivotimit dhe ndërprerjes së parakohshme të procesit të votimit? A i lejon votat bosh ose të pavlefshme?
- A paraqiten të gjithë garuesit në mënyrë të barabartë në fletën e votimit? A u duhet zgjedhësve të lëvizin poshtë ekranit ose të hapin faqe tjetër ekrani për t'i parë të gjitha alternativat e një gare të caktuar? A e përmban fleta e votimit të gjithë informacionin që kërkohet nga ligji?
- Ç'lehtësi janë krijuar për të rritur qasjen në votim për zgjedhësit me aftësi të kufizuara? A përdoren gjuhët e pakicave? A e siguron TRV-ja fshehtësinë e votës për zgjedhësit që përdorin modalitete të veçanta?
- Si mbrohet TRV-ja nga mosfunksionimet fizike apo probleme të tjera, si për shembull mungesa e energjisë elektrike?
- A mund të riparohen problemet e thjeshta nga komisionerët zgjedhorë? Nëse po, si është planifikuar kjo? A janë trajnuar sa duhet komisionerët zgjedhorë për t'u marrë me problemet?
- Ç'loj sistemesh informacioni përdoren nga administrata zgjedhore? A janë të pajtueshëm me njëri-tjetrin llojet e ndryshme të *software*-ve për administrimin e procesit zgjedhor dhe funksionimin e TRV-së? A janë bërë testime për t'u siguruar që të dhënat transferohen pa probleme aty ku parashikohen shkëmbime mes *software*-ve të ndryshme?

4.5 Testimi Publik

Testimi publik është një proces që shërben për të testuar funksionalitetin e një sistemi TRV dhe nuk kërkon njohuri paraprake mbi mënyrën se si është konceptuar sistemi apo cila është logjika e tij e brendshme. Ai është pjesë e rëndësishme e vënies në punë të TRV-së. Megjithatë, vlera e testimit varet pjesërisht nga lloji i testimit, nga ata që e bëjnë testimin, dhe nga fakti se sa mundësi u jepet partive dhe qytetarëve të marrin pjesë në testim. Vetë teknologjia duhet të testohet imtësisht para ditës së zgjedhjeve,

por testimi duhet të mbulojë edhe ndërveprimin e zgjedhësve, komisionerëve zgjedhorë dhe vëzhguesve me teknologjinë në fjalë.

Duke qenë se pjesa më e madhe e testimit zhvillohet para se MVZ-ja të fillojë punë, MVZ-ja duhet të shqyrtojë dokumentet që kanë të bëjnë me çdo testim që është bërë tashmë. Diskutimet me ata që janë përfshirë në testim janë një tjetër burim informacioni. Këtu mund të përfshihen autoritetet testuese, shitësit e teknologjisë, agjencitë e certifikimit dhe administratorët e zgjedhjeve, si dhe grupet e jashtme, si institucionet akademike, grupet e vëzhguesve vendorë, kandidatët ose partitë politike që janë lejuar të testojnë TRV-në. Së paku, MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse rezultatet e testimit janë vënë në dispozicion të këtyre grupeve dhe cilat janë vlerësimet e tyre për rezultatet.

MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse është bërë testimi laboratorik i *hardware*-it dhe *software*-it për të parë nëse sistemi, apo komponentë të tij, i përmbushin kriteret e kërkuara në projekt, dhe nëse të gjitha pjesët e sistemit funksionojnë së bashku, ashtu siç janë projektuar. Kjo përfshin testimin 'nga fillimi në fund' të të gjithë procesit, si dhe testimin e komponentëve të veçantë. Rëndësia dhe plotësia e kriterëve të përdorura për testimin duhet të shqyrtohen nga MVZ-ja. Administrata zgjedhore duhet gjithashtu të sigurojë se ka dokumentacion të plotë, që dëshmon se sistemi është testuar në mënyrën e duhur. Mund të rrezikojë procesin zgjedhor përdorimi i një sistemi TRV që nuk është testuar plotësisht, apo për testimin e të cilit ka dokumentacion të pamjaftueshëm.

MVZ-ja duhet të shqyrtojë nëse testimi është kryer siç duhet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme përse i përket masave të sigurisë. Për shembull, ndonjëse testimet e *software*-it mund të zhvillohen në një mënyrë të paracaktuar, testimi i *software*-it do të ishte më i fortë nëse përdoren forma të testimit "nga kundërshtarët", ku specialistët përpiqen të evidentojnë dobësi të sigurisë ose mangësi të tjera në mënyrë spontane. Po ashtu, TRV-të që mbështeten në internet duhet t'i nënshtrohen testimit që përfshin mbrojtjen kundër sulmeve dDoS. Testimi duhet zhvilluar gjithmonë pas instalimit të një *software*-i të përditësuar apo të ri.

Gjithashtu, MVZ-ja duhet të vëzhgojë se çfarë planesh ka në rast dështimi të testimit. Këto plane duhet të përfshijnë shqyrtimin nëse është bërë dallim mes gabimeve të vogla dhe të mëdha, si dhe kur është përditësuar *software*-i, nëse dhe kur parashikohet testim i ri, dhe nëse testimi u zhvillua mjaftueshëm kohë para momentit të vënies në punë të TRV-ve.

MVZ-ja duhet të përcaktojë se sa është testuar sistemi i TRV-së me publikun dhe me komisionerët zgjedhorë. Ky testim është i nevojshëm për të kontrolluar sa i përdorshëm dhe i qëndrueshëm është sistemi, për të kontrolluar dizajnin e fletës së votimit, dhe mundësisht sa i mjaftueshëm është trajnimi dhe edukimi i zgjedhësve. Testimet publike duhet të parashikojnë mbledhjen e të dhënave mbi përdorimin, evidentimin e ndonjë problemi dhe propozime për modifikime të nevojshme në përgjigje të problemeve të rëndësishme të evidentuara gjatë testimit. Mungesa e këtyre elementeve është tregues se veprimtaria nuk ka qenë testim në kuptimin e vërtetë të fjalës, por më tepër një ushtrim për edukimin e zgjedhësve apo për publicitet.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se MVZ-ja nuk duhet të përfshihet në testimin e ndonjë sistemi apo pajisjeje. Po ashtu, duhet vënë në dukje se testimi nuk është në asnjë rast garanci se sistemi TRV është plotësisht i sigurt dhe se do të funksionojë si duhet ditën e zgjedhjeve.

Pyetje të mundshme:

- A është siguruar administrata zgjedhore që sistemi TRV është i testuar plotësisht para përdorimit? A është zhvilluar testimi 'nga fillimi në fund' i sistemit, përfshirë transferimin e të dhënave midis sistemeve të shumëfishta të informacionit, apo janë testuar vetëm pjesë të veçanta të sistemit?
- A ka MVZ-ja në dispozicion dokumentacion të plotë mbi testimin? A është ky informacion i disponueshëm për partitë politike, shoqërinë civile dhe të tjerë? Cili është vlerësimi i tyre?
- Sa rigoroz duket se ka qenë testimi? A ka pasur testim në kushte të pafavorshme (nga kundërshtarë) të *software*-it? A u bë testim pas instalimit të komponentëve të rinj apo pas përditësimit të sistemit?
- A u vëzhgua testimi zyrtar nga grupe të jashtme? A kishte mundësi ndonjë grup i jashtëm të kryente testimet e veta? Nëse po, në ç'kushte?
- A u testua TRV-ja nga publiku? Cila ishte shkalla e këtij testimi? A u zhvilluan këto teste në zgjedhje provë apo në zgjedhje normale, rezultatet e të cilave kanë fuqi detyruese? A u konstatuan probleme gjatë testimit? Nëse po, si u trajtuan ato?

4.6 Vlerësimi dhe Certifikimi

Certifikimi është një proces sistematik që vlerëson nëse një sistem i caktuar TRV përmbush standardet dhe kërkesat ligjore të vendosura më parë. Procesi i certifikimit mund të përfshijë *hardware*-t dhe *software*-et, si dhe sistemet e funksionimit, proceset e administrimit dhe personelin. Nuk është funksion i MVZ-së të certifikojë TRV të caktuara. Është përgjegjësi e administratës publike të vendit përkatës të sigurojë që sistemi TRV është certifikuar si duhet para se të përdoret në zgjedhje. Megjithatë, MVZ-ja duhet të vlerësojë procesin e certifikimit të përdorur. Për këtë, MVZ-ja duhet të shqyrtojë dokumentet përkatëse të certifikimit dhe të kuptojë pikëpamjet e palëve të interesuara, vëzhguesve vendorë, trupës akademike dhe ekspertëve të tjerë teknikë.

Kërkesat ose kriteret për certifikimin duhet të ekzistojnë para futjes së TRV-së, dhe jo të përgatiten për t'iu përshtatur sistemit TRV. Këto kërkesa duhet të jenë publike dhe në përputhje me dispozitat ligjore kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. MVZ-ja duhet të përpqet të përcaktojë sa specifike janë standardet dhe deri në ç'masë ka liri organi certifikues për të vlerësuar respektimin e kërkesave. Me kalimin e kohës, kërkesat për certifikim mund të vjetërohen dhe ndryshimet në teknologji mund të krijojnë problematika që nuk ishin mbuluar më parë nga standardet. Për rrjedhojë, duhet të evidentohen mangësi të mundshme në kërkesat e certifikimit.

Meqenëse organi certifikues është pjesë e vetë procesit të certifikimit, informacioni rreth organit certifikues është me interes për MVZ-në. Në mënyrë që certifikimi të jetë kuptimplotë, organi i certifikimit duhet të jetë kompetent dhe i pavarur nga shitësit e teknologjisë, furnizuesit, dhe administratorët e zgjedhjeve. Duhet shqyrtuar pavarësia dhe kompetenca e organit certifikues. Për këtë, MVZ-ja duhet të përpiqet të vlerësojë përvojën e mëparshme të organit certifikues, nëse vetë organi certifikues është i akredituar, burimin e financimit për procesin e certifikimit, dhe pikëpamjet e ekspertëve, vëzhguesve dhe partive politike.

Duhet parë gjithashtu se si e ka zhvilluar procesin e certifikimit organi certifikues. MVZ-ja duhet të vlerësojë me kujdes nëse certifikimi është kuptimplotë apo thjesht një miratim “formal”. Hapat e ndërmarrë, personeli i përfshirë, dhe sasia e kohës kushtuar procesit të certifikimit, janë të gjithë tregues potencialë. Një tjetër tregues është nëse pagesa ndaj këtij organi është e mjaftueshme për të siguruar një proces certifikimi serioz. MVZ-ja duhet gjithashtu të përpiqet të vlerësojë nëse organi i certifikimit mori informacion të plotë mbi sistemin, dhe se nuk pati informacion që nuk iu dha për çështje sigurie apo pronësie. MVZ-ja duhet të kontrollojë gjithashtu nëse organi i certifikimit u kërkoi shitësve apo prodhuesve të teknologjisë të modifikojnë ndonjë *hardware* apo *software*, me qëllim përmbushjen e standardeve të certifikimit.

Nëse sistemi TRV u modifikua pas certifikimit, MVZ-ja duhet të evidentojë nëse edhe këto ndryshime janë certifikuar. Rregullat për heqjen e certifikimit, për ricertifikimin, apo mungesa e tyre, mund të jenë gjithashtu të rëndësishme.

Në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së ku ka vetëm një lloj sistemi TRV në përdorim ose ku shteti ka zhvilluar sistemin e vet, shpesh nuk ekziston një organ certifikimi dhe, për rrjedhojë, nuk zhvillohet asnjë certifikim i pavarur dhe kompetent. Kjo duhet të vihet në dukje nga MVZ-ja, e cila duhet të pyesë administratorët e zgjedhjeve se si mund të jenë të sigurt që TRV-ja do të funksionojë në mënyrë korrekte.

Në mënyrë të ngjashme me rezultatet e testimit publik, MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse vlerësimi përfundimtar dhe raportet e certifikimit janë të disponueshme për institucionet akademike, grupet e vëzhguesve vendorë, kandidatët apo partitë politike, dhe se cilat janë pikëpamjet e tyre për to.

Pyetje të mundshme:

- Cilat janë pikëpamjet e administratorëve të zgjedhjeve, konkurrentëve politikë, grupeve të shoqërisë civile, akademikëve dhe aktorëve të tjerë për procesin e certifikimit?
- A ishin standardet e certifikimit të përcaktuara para blerjes së TRV-së, apo duket se janë përshtatur për një sistem ekzistues?
- A janë kërkesat e certifikimit të disponueshme publikisht? A përputhen plotësisht me dispozitat ligjore për përdorimin e TRV-ve dhe me dispozitat ligjore zgjedhore në tërësi? A janë kriteret të detajuara sa duhet?

↻ A ka ndonjë boshllëk të rëndësishëm në kërkesat për certifikim?
↻ A është dokumentacioni i plotë për vlerësimin dhe certifikimin i disponueshëm për MVZ-në? A është ky informacion në dispozicion të partive politike, shoqërisë civile dhe të tjerëve? Cili është vlerësimi i tyre?
↻ Sa i pavarur është organi i certifikimit në të vërtetë? A është ai i akredituar? Si financohet? Si perceptohet nga bashkëbiseduesit vendas?
↻ Sa kuptimplotë ishte procesi i certifikimit? A kishte organi i certifikimit burime të mjaftueshme në dispozicion, përfshirë kohën? A kishte qasje të plotë në dokumentacion? Çfarë shume iu pagua organit të certifikimit? A ishte kjo shumë e mjaftueshme për të siguruar një proces kuptimplotë certifikimi?
↻ A kërkoi organi i certifikimit ndonjë modifikim të TRV-së me qëllim që të përmbusheshin kriteret e certifikimit?
↻ A u bënë modifikime në <i>hardware</i> apo <i>software</i> pas certifikimit fillestar? Nëse po, a u certifikuan këto ndryshime?
↻ Nëse nuk ekziston një proces formal certifikimi, a ka mjete të tjera të disponueshme për administratorët e zgjedhjeve, partitë politike dhe bashkëbiseduesit e tjerë vendas, për t'u siguruar që sistemi TRV do të funksionojë siç duhet?
↻ Si mund ta verifikojnë vëzhguesit se sistemi i përdorur në zgjedhje është në të vërtetë i njëjtë me sistemin e vlerësuar dhe të certifikuar në mënyrë të pavarur, për shembull me nënshkrime dixhitale? ²⁶

4.7 Metodat e Verifikimit

Një aspekt kyç i sistemit TRV është aftësia për të verifikuar që teknologjia ka funksionuar sipas parashikimit gjatë zgjedhjeve. Në veçanti, duhet të jetë e mundur të verifikohet që fshehtësia e votës është respektuar dhe se rezultatet janë një pasqyrim i ndershëm i të gjitha përzgjedhjeve të votuesve. Ndonëse nuk është roli i MVZ-së të bëjë verifikim, MVZ-ja duhet të jetë në gjendje të vlerësojë nëse është i mundur verifikimi i plotë, si dhe të vëzhgojë procesin e verifikimit.

Ka mënyra të ndryshme për ta bërë verifikimin dhe kombinime të ndryshme mënyrash, në varësi të teknologjisë së përdorur. Vëzhguesit duhet të jenë të vetëdijshëm për kufijtë e metodave të verifikimit, dhe MVZ-ja duhet të shohë me kujdes se si është bërë verifikimi dhe nëse ka mungesa në procesin e verifikimit, që mund të bëjnë që shkeljet ose gabimet të mos zbulohen. Procedurat e votimit dhe të numërimit, që mbështeten vetëm në besimin te ndershmëria e komisionerëve zgjedhorë dhe shitësve të teknologjisë, nuk mund të vlerësohen se i përmbushin angazhimet e OSBE-së për zgjedhje demokratike.

²⁶ Nënshkrimi dixhital është një funksion matematikor që e lejon këdo të verifikojë autenticitetin dhe integritetin e një mesazhi të caktuar, një skedari apo *software*-i. Ai provon se është nënshkruar nga një nënshkrues i njohur (autenticiteti) dhe nuk është ndryshuar që nga momenti i nënshkrimit (integriteti).

Verifikimi mund të jetë universal ose individual. Verifikueshmëria universale nënkupton që, çdo person ose grup me ekspertizë të mjaftueshme mund të konfirmojë që rezultatet e zgjedhjeve përkojnë me votat e hedhura, dhe se procesi është zhvilluar me saktësi. Verifikueshmëria individuale i referohet aftësisë së një zgjedhësi të caktuar për të konfirmuar që vota specifike e tij ose e saj është regjistruar në mënyrë korrekte dhe përkon me zgjedhjen që ka bërë. Nëse të gjitha aspektet e zgjedhjeve, përfshirë saktësinë e rezultateve të përgjithshme, mund të verifikohen plotësisht dhe në mënyrë të pavarur, TRV-ja mund të thuhet se është e verifikueshme 'nga fillimi në fund'.

4.7.1 Auditimet

Verifikimi i proceseve të TRV-së mund të bëhet nëpërmjet auditimeve të llojeve të ndryshme, përfshirë auditimet e funksionimit të teknologjisë, auditimet e procedurave të ndjekura për administrimin dhe sigurimin e sistemit, dhe auditimet e rezultateve. MVZ-ja duhet të përcaktojë cilat auditime kërkohen nga ligji dhe nëse auditimet janë zhvilluar nga organe të pavarura. MVZ-ja duhet të vëzhgojë zhvillimin e auditimeve, aty ku është e mundur.

MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse kriteret dhe mekanizmat e auditimit japin informacionin përkatës për të gjitha nivelet e sistemit TRV, që nga pajisja specifike e votimit deri tek nxjerrja e rezultateve. Mekanizmat e auditimit duhet të ruajnë fshehtësinë e votës, por duhet edhe të zbulojnë nëse ka ndodhur ndonjë shkelje e fshehtësisë së votës. MVZ-ja duhet të vëzhgojë nëse përfaqësuesit e partive politike, kandidatët, vëzhguesit vendorë dhe palë të tjera të interesuara janë lejuar të jenë të pranishëm gjatë auditimeve.

Një tjetër element që MVZ-ja duhet të marrë parasysh është nëse ligji kërkon veprime shtesë që duhen ndërmarrë në rastet kur auditimi zbulon mospërputhje dhe çfarë ndikimi, nëse ka ndonjë, ka kjo te rezultatet. Kërkesa për auditim ka pak vlerë, nëse nuk sjell si domosdoshmëri ndonjë formë korrigjimi në rast mospërputhjeje.

4.7.2 Gjurmë Kontrolli e Votës në Letër e Verifikuar nga Zgjedhësi dhe Fletët e Votimit të Skanuara

Në rastet kur përdoren pajisjet DRE, verifikueshmëria universale, në parim, mund të arrihet nëpërmjet përdorimit të "gjurmës së kontrollit të votës në letër të verifikuar nga zgjedhësi" (VVPAT). Me fjalë të tjera, versioni në letër i votave për ndonjë ose të gjitha pajisjet mund të krahasohet me rezultatet elektronike nëpërmjet rinumërimit të pjesshëm ose të plotë. Ndonëse përdorimi i VVPAT siguron kontroll të kryqëzuar të rezultateve elektronike, ky mekanizëm duhet të zbatohet si duhet në mënyrë që të arrihen qëllimet e transparencës dhe të sigurohet besimi i publikut.

Nëse sistemi TRV në zgjedhjet që po vëzhgohen prodhon kopje të votave në letër, MVZ-ja duhet të marrë parasysh disa aspekte. Së pari, MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse kopja në letër mund të verifikohet nga zgjedhësi para se vota elektronike të hidhet përfundimisht. Përzgjedhja e votuesit duhet të tregohet qartësisht dhe të jetë lehtësisht e dukshme për zgjedhësin, dhe nuk duhet të jetë në formën e një *barcode*-i apo shenjave

të tjera, të cilat zgjedhësi nuk mund t'i interpretojë. MVZ-ja duhet të shohë nëse ka mekanizma për votuesit e verbër, që të verifikojnë votën e tyre. Zgjedhësi duhet të ketë mundësinë ta anulojë votën, nëse versioni në letër nuk përputhet me alternativën që ai beson se ka përzgjedhur. MVZ-ja duhet, gjithashtu, të vlerësojë nëse zgjedhësit janë të informuar për funksionin VVPAT dhe, për rrjedhojë, e dinë çfarë duhet të verifikojnë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u vëzhguar është mënyra se si VVPAT-ja siguron fshehtësinë e votës. Për shembull, kopjet e votave në letër, që ruhen në një shirit letre, mundësojnë lidhjen e votës me zgjedhësin.

Së treti, çështje teknike si, lloji i letrës, printimi, prerja dhe depozitimi i letrës në kutinë e votimit, mund të kenë ndikim domethënës në efektshmërinë e VVPAT-së. Për shembull, printerët mund të mos funksionojnë ose t'u mbarojë boja dhe letra. Nëse problemet nuk zbulohen dhe nuk korrigjohen me shpejtësi, kufizohet dobja e VVPAT-së. Kopja e votës në letër duhet të jetë gjithashtu e një cilësie të mjaftueshme për të lejuar rinumërim.

Së katërti, disa sisteme TRV i printojnë gjurmët VVPAT dhe, më pas, zgjedhësit e marrin votën letër që nxjerr aparati, dhe e hedhin në një kuti votimi fizike. Ndonjëherë, zgjedhësit në mënyrë aksidentale ose të qëllimshme i marrin këto gjurmë VVPAT me vete. MVZ-ja duhet të vlerësojë se si mund të ndikojë kjo në administrimin që i bëhet më pas kopjes në letër të votës (VVPAT) dhe në saktësinë e rinumërimit.

Së pesti, një element i rëndësishëm për VVPAT është nëse këto gjurmë përdoren praktikisht në rinumërimet pas zgjedhjeve. MVZ-ja duhet të vëzhgojë çdo auditim ose rinumërim paszgjedhor për të vlerësuar nëse procesi i përmbush kërkesat ligjore. Për auditimet, ka të ngjarë që vetëm një përqindje e caktuar e gjurmëve në letër të kontrollohet. Përzgjedhja e gjurmëve në letër që do të auditohen duhet të përcaktohet në mënyrë rastësore. Përqindja që do të kontrollohet duhet të jetë e mjaftueshme për të dhënë një kampion statistikisht të vlefshëm.

Skanimi i votave mund të ofrojë, gjithashtu, verifikueshmëri universale, nëse zbatohet si duhet. Në këtë rast, janë edhe disa aspekte teknike që duhen vlerësuar nga MVZ-ja. Fleta e votimit që përdoret duhet të jetë e kuptueshme menjëherë për zgjedhësin dhe vendosja e shenjës përkatëse duhet të jetë e qartë dhe e lehtë. Kur fletët e votimit skanohen në qendrat e votimit, zgjedhësit duhet të jenë në gjendje ta vendosin vetë fletën e votimit në pajisjen e skanimit, pa ndihmë dhe pa shkelje të parimit të fshehtësisë së votës. Në disa zgjedhje, zgjedhësit i vihen në dispozicion "mëngë" të posaçme për ruajtjen e privatësisë, të cilat mund t'i përdorë për të parandaluar çdokënd, përfshirë personin që e "ndihmon", që të mos shohë përmbajtjen e fletës së votimit ndërsa e vendos atë në skaner. Nëse fleta e votimit nuk është shenjuar në mënyrë të vlefshme, pajisja duhet t'ia tregojë këtë zgjedhësit në mënyrë të qartë, dhe zgjedhësi duhet të ketë mundësi të hedhë një fletë votimi korrekte.

Meqë skanerat mund të jenë objekt gabimesh dhe mashtrimesh, është e rëndësishme që të paktën disa fletë votimi të numërohen më pas manualisht gjatë auditimeve dhe, nëse kërkohet, të bëhen rinumërimet. Auditimet e gjurmëve në letër duhet të jenë

rastësore dhe në masë statistikisht domethënëse. MVZ-ja duhet të evidentojë edhe marzhin e përgjithshëm të gabimit të pajisjeve të skanimit, si dhe nëse ka ndonjë dispozitë për rinumërimet automatike në rast se diferenca midis dy garuesve zgjedhorë është brenda marzhit të gabimit.

4.7.3 Verifikimi dhe Votimi me Anë të Internetit

Për sistemet e votimit me anë të internetit, është e vështirë të mundësohet verifikueshmëria universale pa vënë në rrezik fshehtësinë e votës, në veçanti në rastet kur fletët e votimit janë shumë të ndërlikuara. MVZ-ja duhet të shqyrtojë me kujdes proceset e verifikimit që synojnë të sigurojnë verifikueshmëri universale për votimin me anë të internetit.

Disa sisteme votimi me anë të internetit ofrojnë mekanizma për verifikueshmëri individuale. Në parim, kjo do të thotë se zgjedhësi është në gjendje të kontrollojë, duke kombinuar disa pjesë informacioni, nëse vota e hedhur është regjistruar në mënyrë korrekte, sipas vullnetit të saj apo të tij. Asnjë pjesë e vetme informacioni nuk duhet të zbulojë përmbajtjen e votës. Do të dhunonte fshehtësinë e votës po t'i jepte zgjedhësit mundësinë që, në ndonjë mënyrë, t'i provonte palëve të treta si ka votuar. Aty ku përdoren mekanizma të tilla, legjisllacioni duhet gjithmonë të parashikojë që të bëhet verifikim për të përcaktuar nëse ka ndodhur ose jo ndonjë falsifikim, dhe se çfarë masash duhet të merren në rast se ka ndodhur.

Pyetje të mundshme:

- Ç'metoda verifikimi janë përdorur për të vërtetuar integritetin e rezultateve? A ka mundësi që këto metoda të çojnë në verifikim 'nga fillimi në fund' të rezultateve, apo ekzistojnë boshllëqe në procesin e verifikimit?
- Sa i thellë është bërë procesi i verifikimit nga organizata dhe zgjedhësit në praktikë?
- A kanë pasur grupet e vëzhguesve, përfaqësuesit e partive politike dhe persona të tjerë qasje të plotë në vëzhgimin e procesit të verifikimit? A kanë bërë përpjekje këta individë apo grupe të vëzhgojnë procesin e verifikimit? Nëse jo, cilat janë arsyet për mosvëzhgimin e rezultatit?
- Çfarë auditimesh janë bërë dhe nga kush? Çfarë ndodh në rast se një auditim nxjerr në pah gabime ose mospërputhje?

- Nëse në qendrat e votimit përdoren sisteme votimi DRE, a kanë këto pajisje gjurmë të votës në letër? Nëse po, a mund të verifikohet ajo nga zgjedhësi para se ta hedhë votën përfundimisht?
 - A e ruan VVPAT-ja fshehtësinë e votës?
 - A mundet të shërbejë VVPAT-ja si një metodë e vlefshme verifikimi, apo ka dobësi teknike apo konceptimi që e reduktojnë vlerën e saj në këtë drejtim?
 - A kryhen auditime me përzgjedhje rastësore të VVPAT-së?
 - A janë kërkuar dhe zhvilluar rinumërime manuale?
 - A janë gjetur probleme me vetë VVPAT-në (printimi, magazinimi)?
 - A janë gjetur mospërputhje apo probleme si rrjedhojë e rinumërimeve të pjesshme apo të plota të VVPAT-së? Nëse po, si u trajtuan?
- Nëse janë instaluar pajisje për skanimin e fletëve të votimit, a e ruan përdorimi i tyre fshehtësinë e votës? A auditohen ose rinumërohen manualisht fletët e votimit në mënyrë që të verifikohen rezultatet elektronike? A bëhet verifikimi para ose pas shpalljes së rezultateve? Si janë trajtuar mospërputhjet?
- Në rast se përdoret votimi me anë të internetit, si e sigurojnë metodat e verifikimit verifikimin 'nga fillimi në fund'?
 - A i jepet zgjedhësit ndonjë e dhënë gjatë procesit të votimit për qëllime verifikimi, që njëkohësisht mund të dhunonte fshehtësinë e votës?
 - Çfarë auditimesh të sistemit bëhen dhe kush i kryen ato?
 - Çfarë lloj verifikimesh ofron metoda (votë e hedhur në përputhje me vullnetin e votuesit, e regjistruar siç është hedhur, apo e numëruar siç është regjistruar)?
- Pavarësisht nga metoda e përdorur e verifikimit, cili është vlerësimi i partive politike, kandidatëve dhe grupeve të vëzhguesve vendorë për procesin e verifikimit?

4.8 Qasja e Vëzhguesve, Dokumentacioni dhe Masa të Tjera për Transparencën

Ashtu si për çdo proces zgjedhor, një pjesë përbërëse e vlerësimit të përdorimit të TRV-ve është transparenca e sistemit. Transparenca me anë të vëzhgimit të zgjedhjeve është element kyç për verifikimin e një procesi zgjedhor dhe për të ndërtuar besimin e publikut. Në të njëjtën kohë, transparenca është e rëndësishme për ata që kanë për detyrë të sigurojnë integritetin e procesit zgjedhor. Përdorimi i TRV-së duhet të jetë plotësisht transparent për administratorët e zgjedhjeve dhe institucionet e gjyqësorit.

Në përgjithësi, transparenca mund të cenohet nga faktorë të ndryshëm. Nëse një përbërës apo proces i sistemit është sekret ose i mbrojtur me ligj për të mos u bërë publik, transparenca e përgjithshme reduktohet. Duke qenë se zgjedhjet janë një proces publik i ushtruar në mënyrë kolektive nga dhe për zgjedhësit, për të realizuar të drejtat bazë të njeriut, sistemi elektronik i votimit nuk duhet të bëhet sekret me anë të një marrëveshjeje private mes ofruesit të teknologjisë dhe autoriteteve shtetërore. Ndaj, MVZ-ja duhet të shqyrtojë me kujdes se si vëzhguesit e pavarur, përfaqësuesit

e partive dhe zgjedhësit mund të vëzhgojnë një proces votimi elektronik, dhe se si zyrtarët e zgjedhjeve dhe gjyqësori mund të përmbushin siç duhet detyrimet e tyre për mbikëqyrje.

Ndonëse jo të gjitha aspektet e TRV-së mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, janë disa aktivitete që mund të vëzhgohen dhe që duhet të jenë të hapura për vëzhguesit. Ato përfshijnë jo vetëm aktivitetet e administratorëve të zgjedhjeve dhe të ofruesve të teknologjisë që kanë të bëjnë me montimin, instalimin dhe modifikimin e sistemit, por edhe aktivitete të autoriteteve të certifikimit, testimit dhe auditimit. Në këtë drejtim, MVZ-ja duhet të vrojtojë se cilat aspekte të procesit mund të vëzhgohen në parim, dhe nëse vëzhguesve u lejohet qasje e mjaftueshme për ta bërë këtë.

MVZ-ja duhet të vejë në dukje nëse vëzhguesit i përdorin mundësitë në dispozicion të tyre. Arsyet për mosvëzhgim mund të jenë me interes. Për shembull, partitë politike ose grupet e shoqërisë civile mund të shprehen se nuk kanë kapacitetet për vëzhgim në mënyrë të efektshme, ose mund të raportojnë se qasja që u lejohet nuk siguron vëzhgim kuptimplotë në brendësi të operacioneve të sistemit. Nga ana tjetër, ata mund të shprehen se i besojnë përdorimit të TRV-së.

Po ashtu, i duhet kushtuar vëmendje çdo përpjekjeje të bërë nga administrata zgjedhore ose shitësit e teknologjisë për të maksimizuar transparencën. Kjo mund të përfshijë ofrimin e mundësisë grupeve të vëzhguesve vendorë dhe partive politike për testimin e sistemit TRV në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, duhet vëzhguar fakti nëse administrata zgjedhore ka bërë përpjekje për të identifikuar mjete shtesë për lehtësimin e qasjes për vëzhguesit.

Përgjithësisht, testimi duhet të jetë i mundur të vëzhgohet nga partitë politike, kandidatët dhe grupet e vëzhguesve vendorë. Së paku, MVZ-ja duhet të kontrollojë nëse rezultatet e testimit u janë vënë në dispozicion këtyre grupeve. MVZ-ja duhet të marrë parasysh edhe shkallën në të cilën partitë politike, kandidatët, grupet e vëzhguesve vendorë, akademikët dhe grupe të tjera lejohen ta testojnë vetë teknologjinë. Ndonëse mundësitë për testim të jashtëm mund të jenë të kufizuara për arsye sigurie, kufizime logjistike dhe kohore, ekzistenca e këtij testimi është tregues i transparencës.

Një element i rëndësishëm në analizën e situatës është evidentimi i dokumenteve që nuk janë të disponueshme. Ekzistenca e dokumentacionit përkatës nuk provon në mënyrë përfundimtare besueshmërinë e TRV-së. Megjithatë, mungesa e dokumentacionit përkatës mund të jetë tregues për ekzistencën e problemeve. Mungesa e dokumentacionit për trajtimin e problemeve të njohura teknologjike mund të jetë më treguese sesa dokumentacioni i disponueshëm për shqyrtim.

Një tjetër faktor që ndikon te transparenca e përgjithshme është çështja e kodit të burimit të *software*-it që vë në funksion TRV-në. Transparenca forcohet nëse kodi i burimit është informacion publik. MVZ-ja duhet të përcaktojë nëse kodi i burimit për të gjithë *software*-in e përdorur në sistemin TRV është i disponueshëm publikisht, ose të paktën për vëzhguesit e regjistruar ose grupe të tjera përkatëse. Por, edhe nëse kodi i


burimit është i hapur, mund të ketë vlerë të kufizuar nëse publiku i gjerë, përfshirë partitë politike, kandidatët dhe grupet e vëzhguesve vendorë, nuk kanë mundësi të kontrollojnë që ky kod burimi dhe *software*-i hartuar si rezultat i tij është në të vërtetë ai i përdorur në sistemin elektronik të votimit. Ndërsa nuk ka të ngjarë që MVZ-të të kenë kohë apo kapacitete për të vlerësuar kodin e burimit, gjithsesi mbetet një element i rëndësishëm për MVZ-në që të përcaktojë nëse është bërë ndonjë vlerësim kuptimplotë nga të tjerë, si dhe të vlerësojë përfundimet e tij. Nëse MVZ-ja ka qasje në kodin e burimit, duhet të bëhet e qartë për autoritetet se shqyrtimi i kodit të burimit nuk barazohet me certifikimin e sistemit ose të zbatimit të tij.

Edhe në rastin e TRV-së, një nga masat kryesore për transparencën është që qendrat e votimit dhe organet zgjedhore të niveleve më të larta të prodhojnë procesverbale në letër të nxjerrjes të rezultateve, në mënyrë që partitë politike, kandidatët dhe grupet e vëzhguesve vendorë të mund t'i krahasojnë rezultatet në nivelet e ulëta me rezultatet e regjistruara elektronikisht në nivel qendror. MVZ-ja duhet të sigurohet nëse ky është një detyrim.

Disa metoda vëzhgimi, veçanërisht shqyrtimi i dokumentacionit, mund të kenë nevojë për përgatitje paraprake që të jenë të efektshme. Në rastet kur përdoren TRV-të në zgjedhje, MVZ-të duhet të përpiqen ta kërkojnë dokumentacionin përkatës që më parë, që të sigurohen se dokumentet mund të përkthehen në kohë. MVZ-të nuk duhet të nënshkruajnë ndonjë marrëveshje konfidencialiteti me qëllim që të jenë në gjendje të shohin dokumentet ose të vëzhgojnë proceset që kanë të bëjnë me TRV-në, pasi kjo do të komprometonte aftësinë e MVZ-së për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Pyetje të mundshme:

- A janë të gjitha proceset mbi përdorimin e TRV-së të hapura për vëzhgim nga MVZ-ja dhe vëzhguesit vendorë?
- A ka bërë përpjekje administrata zgjedhore për të lehtësuar qasjen për vëzhguesit?
- Çfarë dokumentesh janë të disponueshme për MVZ-në dhe publikun? Si mund të aksesohen këto dokumente (vetëm fizikisht në letër apo publikisht në internet)? A ka ndonjë raport apo dokumente të tjera që nuk janë të disponueshme (nuk ekzistojnë ose konsiderohen sekrete)? A ka ndonjë informacion ose dokument në të cilin vetë administrata zgjedhore nuk ka qasje?
- A është publikisht i disponueshëm kodi i burimit për *software*-in TRV? Nëse po, a është kontrolluar nga ndonjë grup? A ka ndonjë mekanizëm që të verifikojë se kodi i burimit është ai i përdorur faktikisht ditën e zgjedhjeve?
- A janë procesverbalet e rezultateve të printuara dhe të vëna në dispozicion të vëzhguesve dhe partive politike në çdo nivel, përfshirë qendrat e votimit?



KOMISIONI KOMBËTAR I ZGJEDHJEVE I ESTONISËPËRIT VINKEL

Votimi me anë të internetit në Estoni, 2013.

5

Këndvështrimi Rajonal: Roli i Vëzhguesve Afatgjatë dhe i Analistëve Rajonalë

Kur në një shtet që përdor TRV-në në një proces zgjedhor, dërgohet një MVZ e plotë apo e kufizuar, kontributet e Vëzhguesve Afatgjatë (VAGJ)²⁷ dhe Vëzhguesve Afatshkurtër (VASH) do të jenë të rëndësishme për të vlerësuar përgatitjet dhe zhvillimin e votimit, numërimit dhe nxjerrjen e rezultateve në mënyrë elektronike. Detyrat e tyre do të ndryshojnë në varësi të llojit të teknologjisë, shkallës dhe formës së TRV-së së përdorur, nëse TRV-ja është përdorur në të gjithë vendin, si dhe të mënyrës në të cilën TRV-ja është e integruar në procesin zgjedhor në tërësi.

27 Përgjatë gjithë tekstit, përveçse kur shënohet ndryshe, termi “Vëzhgues Afatgjatë” do të nënkuptojë edhe rolin e Analistit Rajonal në Misionet e ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve.

Ekipi bazë i MVZ-së duhet t'i përgatisë siç duhet VAGJ-të për detyrat e tyre, duke u dhënë informacion të qartë dhe të përmbledhur mbi sistemin TRV, dhe duke ua përcaktuar në mënyrë të saktë informacionin dhe të dhënat që duhet të mbledhin. Nuk duhet të pritet që VAGJ-të të jenë ekspertë për çështjet e TRV-së. Analisti i TRV-së duhet të ketë parasysh se vëzhgimi i përdorimit të TRV-së do të jetë një prej detyrave të VAGJ-ve, dhe se vëzhguesit nuk duhet të përqendrohen tek një aspekt i procesit zgjedhor në dëm të të tjerëve.

VAGJ-të përgjithësisht fokusohen në katër aspekte kryesore të përdorimit të TRV-së: përgatitjet teknike dhe operacionale nga organet rajonale ose lokale të administratës zgjedhore, trajnimi i komisionerëve zgjedhorë, fushata për edukimin e zgjedhësve dhe pikëpamjet e partive politike, kandidatëve dhe grupeve të shoqërisë civile në nivel lokal. VAGJ-të do të jenë gjithashtu në gjendje t'i japin informacion ekipit bazë mbi çështje dhe shqetësime të ngritura nga zyrtarët vendorë të zgjedhjeve dhe zgjedhësit.

Në rastet kur TRV-ja përdoret në qendrat e votimit, VAGJ-të duhet të vëzhgojnë se si dhe nga kush janë shpërndarë pajisjet, si janë ruajtur para instalimit, kush ka qasje në to, dhe çfarë masash sigurie janë marrë për të parandaluar qasjen e paautorizuar. VAGJ-të duhet të pyesin nëse pajisjet janë dërguar plotësisht të përgatitura për ditën e zgjedhjeve apo nëse nevojitet të bëhen përditësime të *software*-it, përfshirë informacionin për fletën elektronike të votimit dhe sigurinë, ose përditësime të tjera të *software*-it, si dhe si është verifikuar autenticiteti i *software*-it apo përditësimit. Nëse fletët e votimit ngarkohen lokalisht, VAGJ-të duhet të përipiqen të vëzhgojnë se si zhvillohet procesi, kush është përgjegjës për ta kryer këtë veprim, dhe çfarë masash sigurie janë marrë. Këto vëzhgime duhet të përfshijnë edhe testimin e mundshëm të TRV-së para përdorimit zyrtar të saj.

Në vendet ku përdoren lloje të ndryshme TRV-je ose ku TRV-të furnizohen nga ofrues të ndryshëm, VAGJ-të duhet të identifikojnë llojin e TRV-së që do të përdoret në rajonet që ata vëzhgojnë dhe t'i komunikojnë këtë informacion ekipit bazë.

VAGJ-të duhet të diskutojnë mbi çështje që kanë të bëjnë me TRV-të me zyrtarët lokalë dhe rajonalë të zgjedhjeve. Kjo do ta ndihmojë MVZ-në të kuptojë më mirë se si e shohin këta zyrtarë rolin e tyre për administrimin e TRV-së dhe sa të mirëpërgatitur ndihen për përgjegjësitë e tyre dhe për ndonjë problem apo mosfunksionim që mund të lindë. VAGJ-të duhet të përcaktojnë gjithashtu se cili është roli i teknikëve të jashtëm në përgatitjet për votimin elektronik dhe sa janë në gjendje zyrtarët e zgjedhjeve të mbikëqyrin punën e tyre. Kur është e mundur, VAGJ-të duhet të marrin pjesë në trajnimet për komisionerët e qendrës së votimit.

Duhen vëzhguar edhe përpjekjet për edukimin e zgjedhësve. Për shembull, VAGJ-të mund të përipiqen të vëzhgojnë llojet e fushatave informative që mbulohen në mediat lokale dhe të përcaktojnë efektshmërinë e këtyre përpjekjeve, ndonëse kjo mund të jetë e vështirë të vlerësohet. VAGJ-të duhet gjithashtu të pyesin rreth testimeve të teknologjisë të kryera me publikun, si dhe t'i vëzhgojnë ato. Vëzhgimi i këtyre testimeve mund të sigurojë informacion jo vetëm për faktin se sa të familjarizuar ndihen zgjedhësit me pajisjet, por edhe për çështje të mundshme që mund të lindin në lidhje me lehtësinë e përdorimit dhe funksionimin e duhur të pajisjeve.

VAGJ-të mund të bëjnë pyetje edhe për TRV-në gjatë takimeve të zakonshme me përfaqësues lokalë të partive politike dhe shoqërisë civile. Në veçanti, ata duhet të marrin informacion se si partitë dhe vëzhguesit planifikojnë ta vëzhgojnë TRV-në dhe nëse do ta vëzhgojnë që më parë apo ditën e zgjedhjeve. VAGJ-të duhet të hulumtojnë mbi qasjen që kanë pasur partitë dhe vëzhguesit vendorë në sistemin TRV, nëse ka ndonjë dokument që nuk kanë mundur ta marrin (përfshirë kodet e burimit), dhe nëse kanë pasur mundësi ta testojnë pajisjen në ndonjë mënyrë.

Nëse TRV-ja është në formën e votimit me anë të internetit, roli i VAGJ-ve do të jetë më i kufizuar. Megjithatë, ata përsëri do të duhet të mbledhin informacion mbi edukimin e publikut, si dhe mbi ndonjë ndërveprim të TRV-së me procesin tradicional të votimit, për shembull, se si sistemi parandalon që zgjedhësit të hedhin disa vota të vlefshme përmes kanaleve të ndryshme të votimit.

Pyetje të mundshme:

- Sa e njohin dhe sa të familjarizuar janë zyrtarët e zgjedhjeve me rolin e tyre në organizimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të TRV-së?
- Cilat janë planet për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë të niveleve më të ulëta? Sa i dobishëm duket të jetë ky trajnim në praktikë?
- Si do të ofrohet ekspertiza teknike ditën e zgjedhjeve, sidomos në rast se lindin probleme?
- A është marrë një numër i mjaftueshëm pajisjesh TRV, a u morën dhe instaluan ato në kohë?
- Si është magazinuar pajisja elektronike e votimit? Çfarë masash sigurie janë marrë për të parandaluar ndërhyrjet manipuluese? Kush ka qasje në pajisjet TRV dhe a është regjistruar kjo qasje në ndonjë procesverbal?
- A janë të lidhura me internetin sistemet TRV? Nëse po, çfarë masash sigurie janë marrë për t'u ruajtur nga ndonjë *hack*-erim i mundshëm?
- A do të ngarkohen fletët elektronike të votimit dhe a do të instalohen përditësime të tjera të *software*-it para ditës së zgjedhjeve?
- A disponohen materiale për edukimin e zgjedhësve? Sa përpjekje janë bërë për edukimin e zgjedhësve nga komisioni apo nëpërmjet medias lokale?
- A është planifikuar ndonjë testim apo provë votimi me zgjedhësit para ditës së zgjedhjeve? Nëse po, cilat janë reagimet e zgjedhësve ndaj pajisjeve? A janë identifikuar probleme si rrjedhojë?
- Cilat janë pikëpamjet e përfaqësuesve të partive politike dhe vëzhguesve vendorë lidhur me përdorimin e TRV-së në zonën e tyre? Sa qasje kanë në të? A kanë pasur mundësi t'i testojnë pajisjet apo të shohin dokumentacionin për procesin? Nëse partitë ose grupet e vëzhguesve nuk duket se po bëjnë përpjekje për të vëzhguar përdorimin e TRV-së, cilat janë arsyet që japin?



OSCE/ODIHR/ESKA/REIMBOWSKA

Një komisioner zgjedhor verifikon identitetin e zgjedhësit duke përdorur teknologji të reja votimi në Mongoli, 2013.

6

Roli i Vëzhguesve Afatshkurtër

Në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, VASH-të mund të luajnë një rol kyç në mbledhjen e të dhënave statistikisht të analizueshme mbi përdorimin e teknologjive elektronike të votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Ndonëse detyra e përgjithshme e VASH-ve që vëzhgojnë votimin elektronik nuk duhet

të jetë e ndryshme nga vëzhgimi i votimit me fletë votimi letër, informacioni që VASH-të synojnë të mbledhin ndryshon në varësi të sistemit që përdoret në vend, dhe shkallës së zbatimit të tij. Për këtë qëllim, është i rëndësishëm informimi i duhur nga ana e Analistit TRV të ekipit bazë. Analisti TRV duhet t'i informojë VASH-të mbi elementet kryesore të sistemit dhe t'u japë udhëzime specifike për t'i ndihmuar në vlerësimin e ecurisë, sigurisë dhe lehtësisë së përdorimit të sistemit. Në këtë informim duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur dizajnit të fletës së votimit dhe elementeve të tjera të ndërveprimit të zgjedhësit me teknologjinë, përveç përshkrimeve të nevojshme të *hardware*-it dhe *software*-it të vetë sistemit TRV. Në ngjasim me VAGJ-të, VASH-të nuk pritet apo nuk kërkohet që të kenë përgatitje dhe njohuri mbi teknologjinë. Trajnimi i tyre duhet të përqendrohet se si të vëzhgojnë funksionimin e saktë dhe të sigurt të sistemeve TRV ditën e zgjedhjeve, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë ndonjë ndryshim në praktikë në qendrat e votimit.

Në paketën informuese të VASH-ve duhet të përfshihet një seksion i posaçëm për votimin elektronik. Kjo do t'i ndihmonte VASH-të të vlerësonin nivelin e përgatitjes së zyrtarëve të qendrës së votimit për përdorimin e pajisjeve nga ana e tyre, si dhe nivelin e besimit të zgjedhësve dhe të kuptuarit e procedurave. Në formularët e vëzhgimit që plotësohen nga VASH-të duhet të përfshihen pyetje se si e kryejnë punën sistemet elektronike të votimit. Meqenëse VASH-të mund të mos i njohin TRV-të në përgjithësi, formularët e vëzhgimit që përdoren nga VASH-të duhet të formulohen me kujdes dhe me qartësi, në mënyrë që të mund të merret informacion i rëndësishëm dhe i përdorshëm, si dhe të shmangët çdo anshmëri e mundshme. Në rastet kur TRV-të përdoren bashkë me procese tradicionale votimi me letër, ekipi bazë dhe VAGJ-të duhet të tregojnë kujdes të sigurohen se VASH-të janë trajnuar dhe u janë caktuar detyra në mënyrë të tillë që të mos u japin vëmendje të pabalancuar çështjeve që kanë të bëjnë me votimin elektronik.

Janë disa aspekte të votimit elektronik që VASH-ve mund t'u kërkohet t'i vëzhgojnë gjatë procesit të votimit. Çështjet kyçe përfshijnë fshehtësinë e votës, vendin ku mbahen pajisjet TRV, lehtësinë e përdorimit të tyre, sigurinë, respektimin e procedurave nga komisionerët e qendrës së votimit, dhe si i trajtojnë ata problemet që lindin.

Instalimi në qendrat e votimit do të jetë një prej proceseve të para që VASH-të do të vëzhgojnë (megjithëse kjo mund të bëhet nga VAGJ-të, nëse pajisjet TRV instalohen në qendrat e votimit para ditës së zgjedhjeve). VASH-të duhet të raportojnë nëse procesi i instalimit është bërë sipas protokolleve të paracaktuara, përfshirë hapat që janë marrë për t'u siguruar që memoria elektronike nuk ka vota të regjistruara para fillimit të votimit. VASH-të duhet të vëzhgojnë edhe testimet që mund të bëhen gjatë instalimit, qoftë për pajisjen e votimit apo për transmetimin e të dhënave në një server qendror.

VASH-të duhet të vëzhgojnë vendin ku janë instaluar pajisjet dhe se si sigurohet që zgjedhësit e shënojnë votën në fshehtësi. Probleme të mundshme për t'u parë me kujdes në këtë drejtim janë lënia pa mbikëqyrje e pajisjeve, mungesa e dhomave të fshehta apo ndarëseve të tjera që ruajnë fshehtësinë e votës, apo përdorimi i ekraneve kompjuterike me shumë ndriçim, çka e bën përzgjedhjen e votuesit të dukshme për të

tjerët. Një tjetër faktor i rëndësishëm është fakti se si i asistojnë zgjedhësit komisionerët zgjedhorë dhe nëse kjo asistencë ka të ngjarë të shkelë fshehtësinë e votës.

VASH-të duhet të vlerësojnë se sa rehat duket se ndihen zgjedhësit me përdorimin e pajisjeve. VASH-të duhet të vëzhgojnë nëse një numër domethënës zgjedhësish ka nevojë për asistencën e komisionerëve zgjedhorë apo të zgjedhësve të tjerë, ose nëse ka zgjedhës që shpenzojnë kohë më shumë se zakonisht për të hedhur votën. Duhet të merret në konsideratë edhe lehtësia në përdorim dhe funksionimi i pajisjeve VVPAT, aty ku ato përdoren. VASH-të mund edhe të bëjnë intervista të shkurtra me zgjedhësit jashtë qendrës së votimit, për të dëgjuar rreth përvojës dhe pikëpamjeve të tyre mbi procesin e votimit me TRV. Mundësia për qasje në TRV për personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, dhe ata që flasin gjuhën e pakicave, është një tjetër aspekt i rëndësishëm i përdorimit të sistemit.

Një çështje e tretë për t'u pasur parasysh është siguria fizike e pajisjeve TRV në qendrat e votimit. Këtu përfshihet se kush ka qasje në pajisjet e votimit dhe elementë të tjerë të sistemit në qendrën e votimit, dhe nëse ndonjë punonjës shërbimi i ofruesit të teknologjisë u qaset pajisjeve pa praninë e një anëtarit të organit të administrimit të zgjedhjeve. VASH-të duhet të vëzhgojnë edhe nëse masat e sigurisë që duhet të zbatohen, për shembull vulat e sigurisë në ndërfaqet e jashtme, janë zbatuar vërtet. Po ashtu, VASH-të duhet të verifikojnë (duke përdorur numrat në seri apo kritere të tjera unike identifikimi) nëse pajisjet TRV në qendrat e votimit janë në të vërtetë ato që duhej të ishin instaluar aty (në rastet kur ky informacion është i disponueshëm).

Për sa i takon zhvillimit të procesit të votimit, VASH-të duhet të vëzhgojnë nëse komisionerët zgjedhorë i respektojnë procedurat e përcaktuara apo i shmangin ato, çka mund të vinte në rrezik integritetin e procesit. Këtu përfshihen situata ku TRV-të përdoren si mjet alternativ votimi, çka kërkon vëmendje të veçantë ndaj listës së zgjedhësve, me qëllim shmangien e votimit të shumëfishtë. VASH-të duhet të përqipen gjithashtu të vlerësojnë se sa njohuri kanë komisionerët e qendrës së votimit mbi TRV-në. Ata duhet të shohin se sa të trajnuar janë komisionerët e qendrës së votimit dhe të vëzhgojnë nëse në qendrën e votimit ndodhen manuale mbi TRV-në, si dhe nëse komisionerët zgjedhorë u referohen atyre. VASH-të duhet të pyesin vëzhguesit vendorë apo përfaqësuesit e partive politike për pikëpamjet e tyre mbi procesin e zhvilluar në qendrat e votimit, dhe se deri në ç'masë munden ta vëzhgojnë procesin.

Nëse zbatimi i votimit elektronik i lejon zgjedhësit në një qendër votimi të zgjedhin mes votimit elektronik dhe votimit me letër, VASH-të duhet të shohin se si administrohet ky proces, përfshirë faktin nëse zgjedhësit mund ta zgjedhin lirisht metodën e votimit, apo komisionerët zgjedhorë apo individë të tjerë u rekomandojnë një metodë të caktuar votimi. Është gjithashtu e rëndësishme të vërehet nëse emrat e zgjedhësve shënohen në listat e zgjedhësve sipas metodës së votimit, dhe nëse bashkërendohet numri i zgjedhësve që përdor secilën metodë gjatë procesit të mbylljes.

VASH-të duhet të vëzhgojnë, kur është rasti, se si i trajtojnë komisionerët problemet që lindin me sistemin. Ata duhet të vërejnë se cilat duket se janë problemet dhe se sa kohë

duhet për t'i zgjidhur ato, dhe nëse zgjidhja duket të jetë e efektshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore apo nënligjore. Këtu përfshihen vonesat në hapjen e qendrave të votimit për shkak të kohës më të gjatë seç pritej për instalimin e pajisjeve. VASH-të duhet të vlerësojnë ndikimin te procesi i votimit në qendrat e votimit të vëzhguara, për shembull, nëse sistemi elektronik nuk funksionon, a u jepet zgjedhësve mundësia të votojnë me fletë votimi letër apo kthehen mbrapsht? Në rastet kur sistemi dështon, funksionon me anomali, ose kur procedurat për përdorimin e sistemit nuk respektohen siç duhet, VASH-të duhet të vëzhgojnë nëse mbahen shënime me shkrim për këto raste në procesverbalin e qendrës së votimit që duhet t'i dorëzohet komisionit zgjedhor të nivelit më lart, dhe nëse ndodh në të vërtetë ky dorëzim.

VASH-të duhet të vëzhgojnë mbylljen e qendrave të votimit dhe nëse kjo bëhet në përputhje me procedurat. Këto procedura duhet të përfshijnë dokumentimin e duhur të veprimeve, përfundimin e procesit të votimit, fillimin e numërimit, përdorimin e mekanizmave të testimit dhe verifikimit, dhe çdo procedurë që nevojitet për të kontrolluar integritetin e rezultateve. Ata duhet të vëzhgojnë nëse procesverbali i rezultateve përfundimtare printohet dhe u vihet në dispozicion vëzhguesve, përfaqësuesve të partive politike dhe kandidatëve, dhe nëse afishohet në një vend publik në qendrën e votimit. VASH-të duhet të vëzhgojnë se si përcillen rezultatet te komisionet e niveleve më të larta, nëse kjo bëhet me anë të komunikimit elektronik të rezultateve apo me anë të dërgimit të elementeve *hardware* (si për shembull USB apo CD-ROM).

Nëse ka një auditim të menjëhershëm të të dhënave në letër për të verifikuar rezultatet, VASH-të duhet të vëzhgojnë dhe raportojnë mbi mekanizmat e verifikimit dhe procedurat e auditimit të kopjeve në letër të prodhuara gjatë përdorimit të TRV-së. Vëzhgimi i tyre është me rëndësi kyçe për vlerësimin e TRV-së dhe duhet të përfshijë nëse rinumërimet manuale të kopjeve në letër bëhen në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme. VASH-të duhet të vëzhgojnë edhe nëse janë gjetur mospërputhje në të dhënat që vijnë nga procesi i nxjerrjes së rezultateve në mënyrë elektronike. Ata duhet të raportojnë edhe se çfarë është bërë në këto raste dhe çfarë shpjegimi kanë dhënë autoritetet për këto mospërputhje.

Pyetje të mundshme:

- A krijohen probleme gjatë instalimit të pajisjeve TRV në qendrat e votimit? Nëse po, a janë në gjendje komisionerët zgjedhorë t'i zgjidhin ato? A hapen dot në kohë qendrat e votimit?
- Çfarë hapash janë marrë për t'u siguruar që memoria elektronike nuk përmban vota para fillimit të votimit? A është kjo e verifikueshme?
- A e siguron fshehtësinë e votës mënyra si janë instaluar pajisjet TRV në qendrën e votimit? A sigurohen komisionerët zgjedhorë që zgjedhësit e hedhin votën në fshehtësi, edhe në rastet kur ata kanë nevojë për ndihmë për përdorimin e pajisjeve?

<p>➤ A duket që zgjedhësit e kuptojnë se si funksionojnë pajisjet TRV? Sa zgjedhës kërkojnë ndihmë për të përfunduar votimin? A ka zgjedhës që e ndërpresin procesin e votimit pasi e kanë filluar atë, por pa e hedhur votën?</p>
<p>➤ A i afrohen zgjedhësit pajisjes TRV vetëm? A marrin masa komisionerët zgjedhorë që të mos përdoren pajisjet TRV në të njëjtën kohë nga dy ose më shumë zgjedhës?</p>
<p>➤ A ka radhë? Sa kohë u duhet zgjedhësve të presin për të votuar? A ka mjaftueshëm pajisje në mënyrë që koha e pritjes të mbahet brenda kufijve të arsyeshëm?</p>
<p>➤ A janë në gjendje të votojnë pa ndihmë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar? Nëse në procesin e votimit përdoren gjuhët e pakicave, a mundet të kenë zgjedhësit përdorim të këtyre gjuhëve pa vështirësi në pajisje?</p>
<p>➤ Nëse mendohet se vulosen portat e jashtme apo elemente të tjera të pajisjes TRV gjatë procesit të votimit, a mundet VASH-të të verifikojnë që vulat janë vendosur?</p>
<p>➤ A i përdorin apo kryejnë veprime me pajisjet TRV komisionerët zgjedhorë apo teknikët gjatë pranisë së vëzhguesve? Nëse po, çfarë arsyesh japin?</p>
<p>➤ A i respektojnë komisionerët zgjedhorë procedurat apo i shmangin ato? Për ç'arsye?</p>
<p>➤ Sa mirë duket se e kuptojnë procesin komisionerët e qendrës së votimit? A janë në gjendje të zgjidhin probleme nëse lind nevoja? Nëse jo, a ka teknikë të pranishëm, përgjegjës për ndreqjen e tyre? Në rast se ka probleme me pajisjet, ndërkohë që VASH-të janë të pranishëm, a shënohen këto raste në procesverbalin e qendrës së votimit dhe a përcillen më pas siç duhet?</p>
<p>➤ Në rast se TRV-të nuk funksionojnë për më shumë se disa minuta, a votojnë zgjedhësit me fletë votimi letër apo u duhet të presin deri sa të zëvendësohet pajisja? Në rastin e skanuesve të fletëve të votimit, a depozitohen votat në një kuti votimi të përkohshme? A largohet ndonjë nga zgjedhësit pa votuar?</p>
<p>➤ Ç'qëndrime kanë vëzhguesit vendorë dhe përfaqësuesit e partive politike apo kandidatët mbi procesin e votimit në qendrën e votimit?</p>
<p>➤ A respektohen procedurat e mbylljes? A printohet një kopje letër e rezultateve për çdo pajisje dhe qendër votimi, dhe a u vihen ato në dispozicion vëzhguesve dhe përfaqësuesve të partive politike? A afishohen këto kopje edhe për publikun?</p>
<p>➤ Si përcillen rezultatet e qendrave të votimit në nivelet më të larta të administratës zgjedhore? A ndiqen procedurat për këtë? Nëse jo, pse?</p>
<p>➤ A bëhet ndonjë auditim aty për aty i rezultateve në qendrat e votimit?</p>
<p>➤ A kanë votuesit mundësi zgjedhjeje mes votimit elektronik dhe atij me letër? A detyrohen të përdorin ndonjërin prej alternativave?</p>
<p>➤ Çfarë ndodh me votat e regjistruara pas ditës së zgjedhjeve? A pastrohen njësitë e ruajtjes së memories së sistemeve TRV dhe nëse po, nga kush?</p>



OSCE/ROBERT KRUMHOFER

Vëzhgues që monitorojnë nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve në Federatën Ruse, 2006.

7

Raportimi: Përgatitja e Vlerësimeve dhe Rekomandimeve

Është shumë e rëndësishme që raportimi i MVZ-së për të gjitha aspektet e procesit zgjedhor të jetë faktik, i saktë dhe i ekuilibruar. Në rastet kur përdoren TRV-të, vlerësimi i këtyre teknologjive duhet të ndihmojë në vlerësimin e përgjithshëm të procesit zgjedhor. Ky vlerësim duhet të formojë edhe bazën për ndonjë rekomandim që MVZ-ja mund të bëjë në këtë fushë, për t'i ndihmuar shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së t'i përmirësojnë proceset zgjedhore në përputhje me angazhimet e tyre.

Në rastet kur zgjedhjet përfshijnë përdorimin e TRV-ve, përgjithësisht raportet e MVZ-së do të kenë një seksion dedikuar këtij aspekti të zgjedhjeve. Megjithëse çdo anëtar i ekipit bazë do të ketë përgjegjësi për mbledhjen e informacionit rreth përdorimit

të TRV-së, Analisti i TRV-së do të jetë më së pari përgjegjës për konsolidimin dhe analizimin e këtij informacioni, dhe hartimin e tekstit përkatës.

Synimi i këtij seksioni është të bëjë një shpjegim dhe vlerësim të funksioneve të sistemit TRV. Raportimi duhet të jetë sa më i përmbledhur dhe i kuptueshëm për një lexues që nuk është i fushës, por mjaftueshëm i hollësishëm për të dhënë një kuptim me nuanca. Ndonëse mund të jetë e nevojshme të përfshihen disa detaje teknike mbi sistemin, këto duhet të shpjegohen përgjithësisht në shënimet në fund të faqes ose në shtojca. Raportimi i MVZ-së mbi përdorimin e TRV-së duhet të identifikojë elementet pozitive të procesit, si dhe dobësitë e tij. MVZ-ja duhet të ketë parasysh se përdorimi i TRV-së nuk mund të shihet i veçuar, por si pjesë e një procesi më të gjerë zgjedhor. Në bërjen e vlerësimeve duhet marrë në konsideratë mënyra se si zbatimi i TRV-ve ndikon mbi aspekte të tjera të procesit.

Shumë prej vlerësimeve që duhen bërë për përdorimin e TRV-ve kanë të bëjnë me rolet e pjesëtarëve të ndryshëm të ekipit bazë. Analisti Ligjor duhet të punojë së bashku me Analistin e TRV-së, për të vlerësuar nëse kuadri ligjor e rregullon siç duhet përdorimin e TRV-së dhe nëse ka patur ankime dhe apelime që prekin TRV-në. Së bashku me Analistin Politik dhe Analistin e Medias, Analisti i TRV-së vlerëson diskutimin politik dhe publik që cek përdorimin e TRV-së. Së bashku me VAGJ-të, Analisti i TRV-së vlerëson ndryshimet në nivel lokal në përdorimin e TRV-së, si dhe çështje që kanë të bëjnë me lehtësinë e përdorimit dhe testimin. Në të njëjtën kohë, Analisti Politik dhe VAGJ-të, së bashku me Analistin e TRV-së, vlerësojnë opinionet që kanë mbi sistemin partitë politike, garuesit dhe aktorët e tjerë zgjedhorë, dhe Analisti i Zgjedhjeve vlerëson informacionin mbi TRV-në të marrë nga administrata zgjedhore.

Baza për përgatitjen e vlerësimeve dhe rekomandimeve për TRV-në janë angazhimet e OSBE-së. Aty ku është e përshtatshme, duhet të merren në konsideratë edhe praktikatat e mira ndërkombëtare, veçanërisht kur kanë të bëjnë me aspekte të hollësishme të funksionimit të TRV-së. Këto vlerësime duhet të përfshijnë edhe legjislacionin vendas në fuqi.

Angazhimet dhe standardet mund të përmbledhen në shtatë parimet e trajtuara në seksionin Informacion shpjegues të këtij manuali. Vlerësimet, përfundimet dhe rekomandimet e MVZ-së për përdorimin e TRV-së në zgjedhje duhet të lidhen me këto parime. Të gjitha këto duhet të merren në konsideratë në vlerësimin që misioni i bën shkallës së përputhjes së TRV-së me angazhimet e OSBE-së.

MVZ-ja duhet të bëjë rekomandimet përkatëse se si mund të përmirësohet TRV-ja, nëpërmjet ndryshimeve në sistem, në administrimin apo zbatimin e saj, apo ndryshimeve në legjislacion.

Është shumë e rëndësishme që këto rekomandime të jenë të mirëmenduara, të mirëhartuara dhe në përputhje me parimet e sipërpërmendura. Rekomandimet e raportit përfundimtar për zgjedhjet janë standarde udhërrëfyese për çdo proces zgjedhor dhe zhvillimet në vijim para zgjedhjeve të radhës.

Ndërsa është e rëndësishme që rekomandimet të jenë të bazuara dhe të zbatueshme, është po aq thelbësore që rekomandimet për TRV-në të jenë të kuptueshme për ata që nuk janë specialistë të fushës.

Rekomandimet duhet të bazohen mbi gjetjet konkrete të mangësive dhe mundësitë për përmirësimin e praktikës ekzistuese, që ajo të jetë më në përputhje me praktikat e mira. Është gjithashtu e rëndësishme që rekomandimet të mos bien ndesh me njëra-tjetrën dhe që ato të jenë në harmoni.

Në përgjithësi, nga tërësia e rekomandimeve të bëra, disa janë rekomandime me përparësi për të trajtuar ndryshime thelbësore me urgjencë ose rëndësi më të madhe. Duhet të bëhet një vlerësim i baraspeshuar nëse rekomandimet për TRV-në mund të cilësohen si rekomandime me përparësi.

Kur mangësitë janë më serioze dhe verifikueshmëria e rezultateve nuk është e mundshme, ose kur përdorimi në vazhdim i TRV-së duket se dëmton besimin e publikut te procesi zgjedhor, MVZ-ja mund të vendosë të rekomandojë që të rishqyrtohet përdorimi i TRV-së, derisa të kapërcehen këto çështje.



OSCE/ROBERT KRUMHOFER

Një zyrtar zgjedhor trajnon administratën zgjedhore për përdorimin e një pajisjeje për votim elektronik me regjistrim të drejtpërdrejtë në Shtetet e Bashkuara, 2006.

8

Ndjekja në Vazhdim

Ndjekja në vazhdim e rekomandimeve në mënyrë të suksesshme varet në shkallë të madhe nga vullneti politik për të përmirësuar procesin zgjedhor para zgjedhjeve të radhës. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar vazhdimisht të ndjekin në vijim rekomandimet dhe kanë theksuar rolin e ODIHR-it për t'i ndihmuar ato.²⁸ Shtetet pjesëmarrëse kanë raportuar gjithmonë e më shumë pranë organeve të OSBE-së mbi përvojën e tyre për ndjekjen e rekomandimeve zgjedhore të ODIHR-it. Organizatat ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve palë nënshkruese të Deklaratës së Parimeve

28 Deklarata e Samitit të OSBE-së, para. 26, "Zgjedhjet", Stamboll, 19 nëntor 1999; Këshilli i Ministrave të OSBE-së, Vendimi Nr. 5/03, "Zgjedhjet", Mاستriht, 1-2 dhjetor 2003; Këshilli i Ministrave të OSBE-së, Vendimi Nr. 19/06, "Forcimi i efektshmërisë së OSBE-së", Bruksel, 4-5 dhjetor 2006. Të gjitha mund t'i shihni te <<http://www.osce.org/mc/66113>>.

për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve kanë theksuar gjithmonë e më shumë rëndësinë e ndjekjes në vazhdim të rekomandimeve, si nga ana e qeverive, ashtu edhe nga komuniteti ndërkombëtar, çka ka potencialin t'i japë një shtytësë këtij procesi, idealisht duke koordinuar veprimtaritë për ndjekjen e rekomandimeve.²⁹

Sipas Manualit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, vëzhgimi i zgjedhjeve nuk është një qëllim në vetvete, por synon t'i ndihmojë shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në zbatimin e angazhimeve të tyre për zgjedhjet. Dobia e vëzhgimit të zgjedhjeve mund vetëm të shtohet nëse, rekomandimet që jepen në bazë të tij, merren në shqyrtim në mënyrë të plotë dhe serioze, dhe zbatohen në mënyrë të efektshme. Një ndjekje e efektshme në vazhdim e rekomandimeve mund të përmirësojë ndikimin dhe dobinë e veprimtarive për vëzhgimin e zgjedhjeve. Ndjekja është pjesë përbërëse e ciklit zgjedhor dhe duhet të nisë menjëherë sapo të jetë publikuar raporti përfundimtar me rekomandimet e tij.



Figura 1: Cikli i Vëzhgimit të Zgjedhjeve

Pas publikimit të raportit përfundimtar me rekomandimet, ODIHR-i zakonisht ndërmerr një vizitë në vijim për t'ia paraqitur raportin përfundimtar dhe rekomandimet e tij aktorëve zgjedhorë. Këto vizita përbëjnë hapin e parë në procesin e ndjekjes në vazhdim të rekomandimeve dhe shërbejnë si kujtesë për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, në periudhën midis zgjedhjeve, për detyrimin që kanë për t'i përmirësuar proceset zgjedhore në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Ato gjithashtu ndihmojnë për të

29 "Deklarata e Parimeve për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve dhe Kodi i Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve", Kombet e Bashkuara, et.al., New York, 27 tetor 2005, <<http://www.osce.org/odihr/elections/16935>>.

kuptuar më mirë gatishmërinë dhe aftësinë e shteteve për të trajtuar rekomandime të veçanta në të ardhmen. Vizitat për të paraqitur raportin përfundimtar shërbejnë edhe si një kujtesë për ekspertizën dhe aftësinë e ODIHR-it për të ndihmuar me komente mbi projektligje që përfshijnë elementet TRV, apo për të dhënë ekspertizë në aspekte të veçanta teknike të TRV-së në procesin zgjedhor.

Pas paraqitjes së raportit përfundimtar të MVZ-së, vizitat pasuese krijojnë mundësinë që të shqyrtohen më me detaje dhe hollësi aspekte të ndryshme të asistencës së ODIHR-it. Këto vizita përqendrohen tek mbështetja teknike për shtetin pjesëmarrës, me një vlerësim teknik më në thellësi, ku përfshihen rekomandimet për fusha që përbëjnë shqetësim të veçantë. Shembujt përfshijnë dhënien e këshillave teknike për rritjen e transparencës, sigurisë dhe verifikueshmërisë së TRV-së së përdorur në një proces zgjedhor. Vizitat pasuese përshtaten sipas vlerësimit të ODIHR-it dhe janë mënyra më efikase për të trajtuar rekomandimet e kaluara.

Asistenca për ndjekjen në vazhdim të rekomandimeve mbi TRV-në mund të marrë për një shtet pjesëmarrës trajtën e këshillave se si t'i qaset më mirë çështjes së TRV-së. Këshilla mund ta vlerësojë kontekstin para ose menjëherë pas një vendimi të politikave për përdorimin e sistemeve TRV, dhe mund të ndihmojë për të vlerësuar në mënyrë të përgjithshme sa e arritshme është një përpjekje e tillë. Ky vlerësim duhet të përfshijë gjithmonë një vlerësim të plotë të alternativave me votim elektronik dhe jo elektronik. Opinione ligjore janë fusha e dytë ku mund të jepet ndihmë, shpesh me anë të komenteve mbi projektligjet për zgjedhjet që kanë të bëjnë me TRV-në. Së treti, mund të bëhen vizita nga ekspertët për të vlerësuar një instalim pilot të TRV-së ose votimit me anë të internetit. Si gjithmonë, ODIHR-i mbetet i gatshëm t'i ndihmojë shtetet pjesëmarrëse në këto përpjekje, me kërkesë të tyre.

Pyetje të mundshme:

- A ka ndryshime të planifikuara apo në vazhdim që përfshijnë TRV-në, dhe nëse po, cilat janë ato dhe a janë në përputhje me rekomandime të mëparshme dhe praktika të mira ndërkombëtare?
- A ka ndonjë hapësirë për asistencë nga ODIHR-i për ndjekjen në vazhdim të rekomandimeve për TRV-në?
- Ç'formë asistence do të ishte më e përshtatshme për të mbështetur shtetin pjesëmarrës dhe institucionet e tij në përmbushjen e rekomandimeve të mëparshme, dhe për ta sjellë procesin e tij zgjedhor më pranë me angazhimet e OSBE-së për përdorimin e TRV-së?

Shtojcat

Shtojca A: Terma të dobishëm

Sa herë që bëhet fjalë për përdorimin e TIK-së në procesin zgjedhor, është e rëndësishme të kuptohet qartë terminologjia dhe procedurat që lidhen me TRV-në, sidomos duke pasur parasysh që është një proces teknik dhe kompleks. Në përkufizimet e mëposhtme shpjegohen terma të përdorur shpesh në lidhje me TRV-në. Anëtarët e ekipit bazë duhet ta përdorin terminologjinë në mënyrë të rregullt në raportimet e tyre, për të shmangur konfuzionin në lidhje me çfarë është vëzhguar.

- ❑ **Auditimi** është vlerësimi nëse një sistem i plotëson ose jo kriteret e përcaktuara. Rezultat i këtij vlerësimi mund të jetë një raport auditimi ose një certifikatë.
- ❑ **Kriptografia** është teknikë për ruajtjen e sigurisë së (të dhënave të) komunikimit nga palët e treta.
- ❑ **Shkatërrimi i të dhënave** është metodë për t'i bërë të dhënat të papërdorshme në mënyrë të parikuperueshme, kur nuk nevojiten më. Kjo mund të realizohet në mënyra të ndryshme, ku më e zakonshme është shkatërrimi i mjetit të ruajtjes së të dhënave nëpërmjet metodës magnetike, fizike apo termale.
- ❑ **Nënshkrimi dixhital** është një funksion matematikor që e lejon këdo të verifikojë autenticitetin dhe integritetin e një mesazhi të caktuar, një skedari apo *software*-i. Ai provon se është nënshkruar nga një nënshkrues i njohur (autenticiteti) dhe nuk është ndryshuar që nga momenti i nënshkrimit (integriteti).
- ❑ **Një sulm i shpërndarë për mohimin e shërbimit (dDoS)** është një sulm mbi një sistem ose rrjet kompjuterik, në të cilin një kërkesë e thjeshtë e automatizuar përsëritet me shpeshtësi shumë të madhe, me synim mbingarkimin e linjave të lidhjes së sistemit ose të kapaciteteve të përlogaritjeve të kompjuterizuara.
- ❑ **Verifikueshmëria sipas parimit 'nga fillimi në fund'** është një funksionalitet i sistemeve TRV që mundëson përcaktimin e vlefshmërisë së rezultateve në bazë universale dhe/ose individuale. Sistemet me verifikueshmëri universale ofrojnë mjete që i mundësojnë një pale të tretë të pavarur të përcaktojë nëse rezultati i zgjedhjeve është raportuar në mënyrë të ndershme dhe pa manipulim, nëpërmjet kontrolleve manuale ose matematikore. Në nivel individual, zgjedhësve u jepet mundësia të verifikojnë që vota e tyre është hedhur ashtu siç ata synonin, që është ruajtur siç është hedhur, dhe (idealisht) numëruar siç është regjistruar.
- ❑ **Hack-erimi** është një veprim, i cili synon të gjejë dhe të shfrytëzojë dobësitë e një *hardware*-i, *software*-i, apo rrjeti kompjuterik, që mund të lejojë përdorimin e paautorizuar të sistemit.

- **Takimi për krijimin (nënshkrimin) e çelësave** është një takim (kryesisht për votimin me anë të internetit), në të cilin anëtarë kryesorë të organit të administrimit të zgjedhjeve krijojnë një “çelës” elektronik të fshehtë, i cili përdoret për të mbrojtur integritetin e votimit elektronik. Ky çelës ndahet shpesh në disa pjesë, të ruajtura në karta të veçanta *smart*, të cilat më pas mbahen nga anëtarë të caktuar të organit të administrimit të zgjedhjeve deri pas mbarimit të zgjedhjeve. Më pas, anëtarët mbliohen për t'i bashkuar pjesët e çelësit, hapin kutinë elektronike të votimit dhe fillojnë dekriptimin e votave elektronike, në mënyrë të ngjashme me procesin e mbylljes dhe numërimit të fletëve të votimit.
- **Ndarje e detyrave** do të thotë se kërkohen të paktën dy persona për të ndërhurë në sistem në të njëjtën kohë, duke siguruar në këtë mënyrë kontrolle dhe balancë për sjelljen e njëri-tjetrit, në përpjekje për të frenuar abuzimet në detyrë.
- **Kodi i burimit** është tekst i lexueshëm nga njeriu, i shkruar në një gjuhë të posaçme kompjuterike, që mund të përkthehet menjëherë në një sërë udhëzimesh kompjuterike, domethënë në një program të zbatueshëm.
- **Përdorueshmëria** përkufizohet si një analizë e lehtësisë së përdorimit dhe të mësuarit të një teknologjie.
- **Kredencialet e zgjedhësit** mund të jenë karta e identitetit të zgjedhësit, fjalëkalime unike të përdorshme një herë, karta *smart*, ose mjete të tjera për ta identifikuar me saktësi përdoruesin si zgjedhës që gëzon të drejtën e votimit.
- **Gjurmë kontrolli e votës në letër, që verifikohet nga zgjedhësi (VVPAT)** janë gjurmë në letër që ruhen nga sistemi elektronik i votimit dhe e mundësojnë zgjedhësin të verifikojë votën e regjistruar, në mënyrë ideale, para se vota të hidhet. Sistemet me VVPAT ofrojnë mundësinë e rinumërimit manual.

Shtojca B: Listë Kontrolli e Përgjithshme

- Në çfarë kuadri u paraqit TRV-ja? A pati debat publik mbi domosdoshmërinë dhe modalitetet e TRV-së? A pati një dakordësi të përgjithshme politike apo pati ndasi mbi këtë çështje? A kishte në tërësi besim publik te procesi zgjedhor dhe administrata zgjedhore, para futjes së votimit elektronik?
- A u fut TRV-ja gradualisht, duke lejuar kohë që problemet e mundshme të zbuloheshin dhe korrigjoheshin, si dhe që zgjedhësit të njiheshin me sistemin?
- Si është procesi zgjedhor që përdor një sistem TRV, krahasuar me një proces që bazohet në letër, për sa i takon përmbushjes së parimeve themelore për zgjedhje të mirëfillta dhe demokratike? Cila është vlera e shtuar e përdorimit të TRV-së në një vend? A ekzistojnë plane për raste urgjente, kur dështon teknologjia?
- Nëse përdoret së bashku me një sistem që përdor fletë votimi letër, si ndikon përdorimi i TRV-së në zhvillimin e pjesës tjetër të procesit zgjedhor?
- A është certifikuar sistemi TRV në një proces transparent, nga një organ i pavarur dhe i kualifikuar, sipas legjislacionit kombëtar dhe praktikave të mira ndërkombëtare?
- A janë testuar në mënyrë përfshirëse sistemi TRV dhe përbërësit e tij para prezantimit dhe periodikisht më pas?
- Deri në çfarë mase janë në gjendje ta kuptojnë dhe përdorin sistemin zgjedhësit, administratorët e zgjedhjeve dhe vëzhguesit? Çfarë aftësish nevojiten që të bëhen përdorues të ditur? Çfarë lloj trajnimi apo edukimi për zgjedhësit mund t'i krijonin këto aftësi?
- A u lejohet me ligj individëve apo grupeve, përfshirë partitë politike dhe vëzhguesit vendorë, të kryejnë testimet, vlerësimet apo shqyrtimet e tyre të dokumentacionit?
- A kanë qasje të plotë vëzhguesit ndërkombëtarë në proces dhe dokumentacion, përfshirë raportet e certifikimit, testimit, verifikimit dhe auditimit?
- Në ç'masë beson publiku që përdorimi i TRV-së në zgjedhjet në fjalë bëhet në përputhje me parimet demokratike?
- A garantohet fshehtësia e votës?
- A ka procedura dhe kërkesa për sigurinë në çdo nivel të sistemit? A sigurojnë ato në praktikë mbrojtje kundër ndërhyrjes nga jashtë, manipulimit të brendshëm dhe dështimit të teknologjisë?
- A prodhohet një gjurmë e votës në letër, e verifikueshme nga zgjedhësi, për t'u siguruar që përzgjedhja e zgjedhësit është regjistruar saktë dhe për të krijuar

mundësinë që vëzhguesit pa ekspertizë teknike të vëzhgojnë rinumërimin?

Nëse jo, cilat masa sigurojnë verifikueshmëri universale, 'nga fillimi në fund' të rezultateve?

- A i merr kuadri ligjor plotësisht parasysh pasojat e futjes së teknologjive të reja, përfshirë qasje të mjaftueshme për vëzhguesit, auditime të sistemit dhe masa të tjera për transparencën, si dhe mundësinë për rinumërim, auditime të detyrueshme të rezultateve dhe ankime ligjore ndaj rezultateve të zgjedhjeve?
- A u bënë ndryshime në ligj apo në praktikë në lidhje me TRV-në, që do të përmirësonin zhvillimin e zgjedhjeve dhe plotësimin e angazhimeve të OSBE-së? Nëse po, cilat janë ato?
- A ka një ndarje të qartë të përgjegjësisë mes shitësve të teknologjisë, organeve rregullatore dhe zyrtarëve zgjedhorë, për të siguruar plotësisht llogaridhënie dhe një reagim të efektshëm në rast se lindin probleme?

Shtojca C: Kodi i Sjelljes së Vëzhguesve Zgjedhorë të OSBE/ODIHR-it

- ❑ Vëzhguesit do të jenë rreptësisht të paanshëm në kryerjen e detyrave të tyre dhe në asnjë rast nuk do të shprehin apo shfaqin publikisht paragjytime apo preferenca në lidhje me autoritetet kombëtare, partitë ose kandidatët, ose në lidhje me ndonjë çështje të kontestuar në procesin zgjedhor.
- ❑ Vëzhguesit do t'i kryejnë detyrat me kujdes dhe pa ndërhyrë në procesin zgjedhor. Vëzhguesit mund të ngrenë çështje me komisionerët zgjedhorë dhe të sjellin parregullsi në vëmendjen e tyre, por ata nuk duhet të japin udhëzime apo të kundërshtojnë vendimet e tyre.
- ❑ Vëzhguesit do të mbeten në detyrë gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve, përfshirë vëzhgimin e numërimit të votave dhe, nëse udhëzohen, edhe në fazën tjetër të nxjerrjes së rezultatit.
- ❑ Vëzhguesit do t'i mbështesin të gjitha përfundimet në vëzhgimet e tyre personale ose në fakte apo prova të qarta dhe bindëse.
- ❑ Vëzhguesit nuk do të komentojnë në media mbi procesin zgjedhor apo mbi përmbajtjen e vëzhgimeve të tyre, dhe çdo koment i paautorizuar për mediat do të kufizohet në informacione të përgjithshme rreth misionit të vëzhgimit dhe rolit të vëzhguesve.
- ❑ Vëzhguesit nuk do të ndërmarrin asnjë rrezik të panevojshëm apo të tepruar. Siguria personale e çdo vëzhguesi është më e rëndësishme se çdo gjë tjetër.
- ❑ Vëzhguesit do t'i mbajnë me vete dokumentet e identifikimit të lëshuara nga shteti pritës apo nga komisioni i zgjedhjeve, dhe do të identifikohen para autoriteteve nëse u kërkohet.
- ❑ Vëzhguesit do të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe normat e vendit.
- ❑ Vëzhguesit do të shfaqin nivel të lartë të gjykitimit personal dhe sjelljes profesionale gjatë gjithë kohës.
- ❑ Vëzhguesit do të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e nevojshme të misionit për dhënie udhëzimesh dhe informacioni dhe do të respektojnë planin e veprimit dhe të gjitha udhëzimet e tjera të parashikuara nga MVZ-ja e ODIHR-it.

Shtojca D: Përzgjedhje të Angazhimeve të OSBE-së, Dokumenteve të Praktikave të Mira, dhe Rasteve Gjyqësore Përkatëse

Angazhimet e OSBE-së për Zgjedhjet

Dokumenti i Kopenhagenit i vitit 1990 (angazhime specifike për zgjedhjet)

- (6) Shtetet pjesëmarrëse deklarojnë se vullneti i njerëzve, i shprehur në mënyrë të lirë dhe të ndershme nëpërmjet zgjedhjeve periodike dhe të mirëfillta, është baza e autoritetit dhe ligjshmërisë së të gjitha qeverive. Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre përmes proceseve të ndershme zgjedhore. Ato njohin përgjegjësinë e tyre për të mbrojtur në përputhje me ligjet e tyre, detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe angazhimet ndërkombëtare, rendin demokratik të vendosur me anë të vullnetit të popullit kundër veprimtarive të personave, grupeve apo organizatave që përfshihen ose refuzojnë të heqin dorë nga terrorizmi apo dhuna, me synim rrëzimin e këtij rendi ose atij të një shteti tjetër pjesëmarrës.
- ((7) Për t'u siguruar që vullneti i popullit shërben si bazë për autoritetin e qeverisë, shtetet pjesëmarrëse do të:
- (7.1) organizojnë zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme kohore, sipas përcaktimeve ligjore;
 - (7.2) lejojnë që të gjitha vendet në të paktën një dhomë të legjislaturës kombëtare do t'i nënshtrohen votës së popullit;
 - (7.3) garantojnë të drejtë vote universale dhe të barabartë për shtetasit në moshë madhore;
 - (7.4) sigurojnë që votat hidhen me votim të fshehtë apo me një procedurë të barasvlershme votimi të lirë, dhe se numërohen dhe raportohen me ndershmëri dhe që rezultatet zyrtare bëhen publike;
 - (7.5) respektojnë të drejtën e shtetasve për të kërkuar një post politik apo publik, në mënyrë individuale ose si përfaqësues të partive politike ose organizatave, pa diskriminim;

- (7.6) respektojnë të drejtën e individëve dhe grupeve për të krijuar me liri të plotë parti politike ose organizata të tjera politike, dhe do t'u sigurojnë këtyre partive dhe organizatave politike garancitë e nevojshme ligjore për t'u dhënë mundësi që të garojnë me njëra-tjetrën në mënyrë të barabartë para ligjit dhe nga autoritetet;
- (7.7) sigurojnë që ligji dhe politikat publike të bëjnë të mundur që fushatat politike të organizohen në një atmosferë të lirë dhe të ndershme, në të cilat as veprimet e administratës, as dhuna dhe presioni nuk i pengojnë partitë dhe kandidatët t'i paraqesin lirisht pikëpamjet dhe vlerat e tyre, apo nuk i pengojnë zgjedhësit për të mësuar dhe diskutuar rreth tyre ose për ta hedhur votën pa pasur frikën e ndëshkimit;
- (7.8) sigurojnë që të mos ketë asnjë pengesë ligjore apo administrative për qasje pa pengesë dhe mbi baza jodiskriminuese në media për të gjitha grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor;
- (7.9) sigurojnë që, kandidatët që marrin numrin e nevojshëm të votave të kërkuara me ligj, marrin postin që u takon dhe lejohen të qëndrojnë në detyrë deri në mbarim të mandatit ose derisa t'u përfundojë mandati në një mënyrë të përcaktuar me ligj, në përputhje me procedurat demokratike parlamentare dhe kushtetuese.
- (8) Shtetet pjesëmarrëse gjykojnë që prania e vëzhguesve të huaj dhe vendas mund të përmirësojë procesin zgjedhor për shtetet në të cilat po zhvillohen zgjedhje. Ndaj ata ftojnë vëzhgues nga shtete të tjera pjesëmarrëse të KSBE-së dhe çdo institucion apo organizatë tjetër private e përshtatshme që mund të dëshirojë të vëzhgojë zgjedhjet e tyre kombëtare, në masën që e lejon ligji. Ata do të përipiqen gjithashtu të mundësojnë qasje të ngjashme për proceset zgjedhore që zhvillohen nën nivelin kombëtar. Vëzhguesit angazhohen të mos ndërhyjnë në proceset zgjedhore.

Dokumenti i Moskës i Vitit 1991

- (24) Shtetet pjesëmarrëse rikonfirmojnë të drejtën për mbrojtjen e jetës private dhe familjare, të banesës, korrespondencës dhe komunikimeve elektronike. Me qëllim shmangien e çdo ndërhyrjeje të papërshtatshme dhe arbitrare nga ana e shtetit në jetën e individit, çka do të ishte e dëmshme për çdo shoqëri demokratike, ushtrimi i kësaj të drejte do t'i nënshtrohet vetëm kufizimeve që përcaktohen me ligj dhe janë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut. Shtetet pjesëmarrëse do të sigurojnë veçanërisht që, kontrolli i personave dhe ambienteve, dhe konfiskimi i pronave private, do të kryhet vetëm në përputhje me standarde të zbatueshme në rrugë gjyqësore.

Dokumente të Praktikave të Mira

Aldana, Gustavo, Observing the Use of Electoral Technologies: A Manual for OAS Electoral Observation Missions, (Washington DC: General Secretariat of the Organization of American States, 2010), <<http://www.oas.org/es/sap/docs/Technology%20English-FINAL-4-27-10.pdf>>.

Caarls, Susanne, E-voting handbook, Key steps in the implementation of e-enable elections (Strasbourg: Council of Europe , 2011), < http://www.coe.int/t/dgap/democracy/activities/GGIS/E-voting/E-voting%202010/Biennial_Nov_meeting/ID10322%20GBR%206948%20Evoting%20handbook%20A5%20HD.pdf >.

Council of Europe, Rec (2004) 11 “Recommendation Rec (2004) 11 of the Committee of Ministers to member states on legal, operational and technical standards for e-voting”, Brussels, 30 September 2004, <<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=778189>>.

Goldsmith, Ben, Electronic Voting & Counting Technologies: A Guide to Conducting Feasibility Studies (Washington DC: International Foundation for Electoral Systems, May 2011), <http://www.ifes.org/~media/Files/Publications/Books/2011/Electronic_Voting_and_Counting_Tech_Goldsmith.pdf>.

“Guide lines on Certification of E-voting Systems”, Council of Europe, November 2011, < http://www.coe.int/t/dgap/democracy/activities/GGIS/E-voting/E-voting%202010/Biennial_Nov_meeting/Guidelines_certification_EN.pdf>.

“Guidelines on Transparency of E-enabled Elections”, Council of Europe, November 2011, < http://www.coe.int/t/dgap/democracy/activities/GGIS/E-voting/E-voting%202010/Biennial_Nov_meeting/Guidelines_transparency_EN.pdf>.

Handbook on Observing Electronic Voting, 2nd Edition, (Atlanta: The CarterCenter, January 2012), <http://www.cartercenter.org/resources/pdfs/peace/democracy/des/Carter-Center-E_voting-Handbook.pdf>.

“Report on the Compatibility of Remote Voting and Electronic Voting with the Standards of the Council of Europe”, European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), 12-13 March 2004, <<http://www.venice.coe.int/WebForms/documents/?pdf=CDL-AD%282004%29012-e>>.

Goldsmith, Ben and Holly Ruthrauff. Implementing and Overseeing Electronic Voting and Counting Technologies. Washington, DC: IFES and National Democratic Institute. 2013.

Çështje Gjyqësore

Austri: Vendim i Gjykatës Kushtetuese i 13 dhjetorit 2011, në lidhje me Zgjedhjet Federale Studentore të vitit 2009 (V86-96/11), <http://www.vfgh.gv.at/cms/vfgh-site/attachments/7/6/7/CH0006/CMS1327398738575/e-voting_v85-11.pdf>.

Estoni: Vendim i Dhomës së Shqyrtimit Kushtetues (Constitutional Review Chamber) i 1 shtatorit 2005, në lidhje me Kërkesën e Presidentit të Republikës (3-4-1-13-05), <<http://www.nc.ee/?id=381>>.

Finlandë: Vendim i Gjykatës së Lartë Administrative i 4 shtatorit 2009, në lidhje me Zgjedhjet Bashkiake të vitit 2008 në Finlandë (FinnishMunicipalElections) (687/1/09), <<http://www.kho.fi/paatokset/46372.htm>>.

Gjermani: Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale i 3 marsit 2009, në lidhje me Zgjedhjet Federale për Bundestag-un të vitit 2005 (2 BvC 3/07, 2 BvC 4/07), <<http://www.bundesverfassungsgericht.de/en/press/bvg09-019en.html>>.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

OSBE. Prezenca në Shqipëri

Manual për vëzhgimin e teknologjive të reja të
votimit / OSBE. Prezenca në Shqipëri. – Tiranë :

Graphic line-01, 2017

80 f. ; 16X23 cm.

Tit. origj.: Handbook for the observation of new
voting technologies

ISBN 978-9928-4472-0-3

1.Zgjedhje 2.Teknologjia e informacionit 3.Përpunimi
elektronik i të dhënave 4.Manuale

004 :324(496.5) (035)